

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 376 • VITI 35 • MARS 2022 • SHA'BAN 1443 • ÇMIMI 1 €

- Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan
- Komentimi i kaptinës “Muhamed”
- Kurani u jep lexuesve informacion të veçantë që nuk është ditur më herët



MIRË SE VJEN MUAJI
I MADHËRISHËM RAMAZAN

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan

Të nderuar besimtarë!

Vëllezër dhe motra!

Të nderuar qytetarë të Kosovës!

Kam kënaqësinë që sot, para kohës së xhumasë, në natën e madhe të Ramazanit, t'ju drejtohem me këtë mesazh urimi, duke ju përgëzuar me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan, gjatë të cilit, besimtarët myslimanë, anekënd globit kryejnë me bindje e përkushtim një ndër kushtet e besimit islam - agjërimin.

Për muajin e agjërimin, Allahu xh.sh., në Kuranin fisnik ka thënë: "Muaji Ramazan është muaji në të cilin zbriti Kurani, ai është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria). Prandaj, kush e arrin prej jush këtë muaj, le të agjërojë..."

Agjërimi i muajit Ramazan për çdo besimtar është një ibadet që kryhet vetëm për hir të Krijuesit, me shpresën se për këtë do të ketë shpërblim vetëm nga Allahu xh.sh..

Përmes agjërimin, besimtari mysliman synon që të jetë më i devotshëm, më i përkushtuar, më i ndjeshëm, më racional, më human dhe më tolerant në raport me vetveten, me familjen, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Përveç kësaj, agjërimi i Ramazanit, ky ibadet i veçantë, e fisnikëron besimtarin, e bën atë më të durueshëm, më të afërt e më të çiltër.

Gjatë këtij muaji, ndër besimtarët agjëruer shtohet edhe ndjenja e përkrahjes dhe solidaritetit shoqëror, sepse në këtë muaj ne jemi shumë më pranë familjeve, faqesit, miqve dhe komunitetit tonë. Këto ndjenja afrimi e dashurie shfaqen sidomos kur gjendemi rreth sofrës së Ramazanit në kohën e iftarit e të syfyrit, në vaktin e faljes së namazeve në shtëpitë dhe në xhamitë tona, si dhe në kohët e bashkëbisedimeve me të dashurit tanë.

Andaj, Ramazani përveç se një ibadet dhe farz i fesë sonë, ai është një muaj i bekuar që na i freskon dhe na i ujtit zemrat me begatitë e tij të shumta dhe na bënë që të bashkohemi me familjarët tanë, dhe kështu na mundëson që ta ruajmë e ta kultivojmë dashurinë dhe kujdesin për familjen dhe misionin e saj. Gjatë këtij muaji, duhet gjendemi edhe më pranë prindërve tanë të cilët kanë shumë nevojë për dashurinë dhe kujdesin tonë, jemi më afër fëmijëve tanë, të cilëve u duhet mbështetja dhe ngrohtësia prindërore, gjendemi në ballë dhe ua japim dorën e

ndihmës vëllezërove dhe motrave tona, të cilët kërkojnë mirëkuptimin, pëlqimin dhe mbështetjen tonë. Të gjitha këto vlera e virtyte, në saje të agjërimin, shumëfishohen, shprehen më fortë dhe jetësohen përgjatë gjithë muajit Ramazan.

Kur jemi te familja, më lejoni që në këtë natë të madhe, në vigjilje të muajit të bekuar të Ramazanit, të apeloj tek të gjithë ne, që të angazhohemi në ruajtjen dhe në edukimin e drejtë të saj, ashtu siç na ka krijuar e na ka porositur Krijuesi i Gjithësisë, Krijuesi ynë - Zoti i Madhëruar. Ai llojin njerëzor e ka krijuar të tillë, me dy gjini e me mision të caktuar, aq sa asnjë akt a vendim nuk mund ta zëvendësojë rolin e nënës me të babait dhe as të babait me të nënës. Prandaj, në këtë muaj të mëshirës, të ibadetit e të solidaritetit, në këtë muaj Ramazani, ju ftoj të gjithëve që të jemi pranë familjes, ta ruajmë familjen dhe atë ta mbajmë në pedestal. Sepse, kur familja është e shëndoshë, edhe shoqëria është e shëndoshë dhe kështu e ardhmja jonë është e sigurt.

Të nderuar vëllezër dhe motra!

Në këtë muaj të bekuar Ramazan, po hyjmë më të lehtësuar nga sfida e pandemisë COVID-19, e cila ditaditës po e humb forcën e saj, ndaj dhe lus të Madhin Zot që kjo të përfundojë sa më parë. Mirëpo, në këtë Ramazan, fatkeqësisht, po hyjmë me atmosferë luftërash e konfliktesh nëpër botë, nga të cilat po e pësojnë qytetarët e pafajshëm. Prandaj, në këtë muaj të rahmetit lutemi për paqe, qetësi, dashuri e mirëkuptim!

Të dashur vëllezër dhe motra!

Gjatë muajit Ramazan, të bëjmë më të mirën e mundshme me ibadete, lutje, namaz, sadaka e solidaritet, që ta meritojmë dhe të na arrij kënaqësia e Krijuesit.

Duke ju uruar mbarësi e shëndet, të gjithëve ju dëshiroj që muajin e madhëruar Ramazan ta përjetoni me të gjitha mirësitë e begatitë e tij, ju dhe familjet e juaja, kudo që gjendeni!

E lus të Madhin Zoti që të na lehtësojë agjërimin dhe të na fisnikërojë me moralin dhe etikën e Ramazanit.


Urime të gjithëve muaji Ramazan!

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnavë

Në këtë numër:

Editoriali	4
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës “Muhamed”	5
Dr. Ajni Sinani Kurani u jep lexuesve informacion të veçantë që nuk është ditur më herët	8
Mr. Muhidin Ahmeti Mirë se vjen muaji i madhërishtëm Ramazan	10
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi Ta presim Ramazanin sikur të jetë i fundit	13
Husein Gjozo Takimi me Ramazanin	14
Abdulhamid Mahmud Tuhmaz Agjërimi	16
Nexhmi Hoxha Agjërimi i të Dërguarit a.s.	20
Bajram Zeqiri Agjërimi, shpresë për Rejjanin	24
Blerim Musliu Po të presim me mall	27
Isa Tërshani Ramazani dhe agjërimi	28
Mihana Goga-Bekteshi Ramazani, ilaçi i trupit dhe shpirtit	31
Msc. Abdullah Klinaku Ramazani në shkrimet e hafëz Ali Korçës	34
Agron M. Rexhepi, MD, MSc, PhD Agjërimi nga aspekti mjekësor	37
Prof. ass. dr. Musa Vila Monopoli dhe spekulimi në çmime	39
Mr. Driton Arifi Pasuritë vakëfnore, një aset i çmueshëm investitor	41
Prof. ass. dr. Rexhep Suma Ligjërata si formë e diskursit në dave (2)	44
Harun Shabanaj Pagëzim a vdekje (3)	46
PhD (C) Melihate Zeqiri Bilinguizmi gjuhësor në Ballkan (2)	49
Aktivitete	51

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Ramazani i bekuar, sezoni i shumëfishimit të shpërblimeve



“Thuaj: “Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.”

(Junus, 58)

Ramazani është muaji më i veçantë i vitit. Myslimanët në çdo vend e presin me ngazëllim ardhjen e tij. Ai është dhuratë e madhe e Allahut për ata që agjërojnë. Në këtë muaj të bekuar hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit, prangosen shejtanët dhe në të është nata e Kadrit, më e mirë se një mijë muaj. Muhamedi a.s. i përgëzoi shokët e tij duke iu thënë: “Ju erdhi muaji i Ramazanit, muaji i bekuar. Allahu ju ka urdhëruar të agjëroni në të. Në këtë muaj hapen dyert e xhenetit, kurse mbyllen dyert e xhehenemit. Në këtë muaj shejtanët mbyllen. Në këtë muaj është nata e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet nga kjo e mirë, ai është vërtet i privuar.” (En-Neasiu).

Agjërimi i muajit të Ramazanit është sa ushtrim mendor, po aq edhe fizik që fisnikëron zemrën dhe forcon vullnetin. Ai e kalit agjëruetin për t’u ballafaquar me sprovat e jetës. Ai është ibadet me të cilin fitohet kënaqësia e Allahut. Agjërimi është vepër e cila nuk mund të barazohet me asgjë. Ebu Umame El-Bahili r.a., tregon: “I thashë: - O i Dërguar i Allahut, më urdhëro për një vepër që më shpie në xhenet. Më tha: - Agjëro, sepse me agjërimin nuk ka të barabartë.” (En-Nesaiu).

Muaji i bekuar i Ramazanit është muaji i agjërimin, i bindjes, i adhurimeve dhe i bekimeve, i veprave të mira dhe i mirësive, i qëndrimit në këmbë dhe i leximit të Kuranit. Është muaji i dhikrit, i kërkimit të faljes, i delirësisë, i lutjes dhe i pendimit, muaji i bujarisë, i sakrificës dhe i solidaritetit.

Ai është muaji i dashurisë së zemrave dhe i përafrimit të myslihanëve, që siguron shpëtim dhe lumturi në botën e pasosur. Në të shpirtat gjejnë prehje, zemrat gëzohen, gjokset hapen dhe veprat e drejta dhe të mira shtohen, duke u larguar nga ligësia dhe e keqja. Dhe nëse shpirtat nuk pendohen dhe nuk kërkojnë falje te Zoti për mëkatet gjatë këtij sezoni të shenjtë dhe të bekuar, atëherë kur do të pendohen? Prandaj, ardhja e Ramazanit është një mundësi e dhuruar për të fisnikëruar shpirtat, për të pastruar zemrat dhe për të bashkuar besimtarët për t’iu bindur Zotit të Lartësuar.

Është detyra jonë të gëzohemi dhe të jemi jashtëzakonisht të lumtur për ardhjen e këtij muaji të shenjtë, për mirësitë dhe bekimet e shumta që Zoti na ka dhuruar në të: “Thuaj: “Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.” (Junus, 58)

Agjërueti, duke mos ngrënë e mos pirë nga mëngjesi në mbrëmje, duke zotëruar epslin e duke u shmangur nga mëkatimi dhe padrejtësia ndaj të tjerëve, mund të ngrihet mbi engjëjt. Agjërimi është gjysma e durimit. Te agjërimi një aspekt është ndërprerja e epsheve duke duruar kundrejt tundimit, kurse aspekti tjetër i tij është përballimi i urisë dhe i etjes duke duruar në adhurim. Agjërimi është braktisje e përkohshme e të mirave materiale dhe shprehje e afrimit ndaj Allahut. Besimtari tregon besnikërinë e tij ndaj fesë duke zbatuar urdhrat dhe duke iu shmangur veprave të ndalura.

Vlera e Ramazanit e kapërcen vlerën e muajve të tjerë. Bereqeti i këtij muaji është i pamatshëm dhe i papërshkrueshëm. Ibadetet në të janë më të vlefshme se në muajt e tjerë. Ai është muaji i mirësive dhe i begatave, muaji i shpërblimeve dhe i dhuratave të pamasa: “Kush e kalon muajin e Ramazanit duke u falur gjatë natës, duke besuar fort dhe duke shpresuar shpërblim të mirë (vetëm nga Allahu), atij do t’i falen mëkatet e mëhershme.” (trans. Buhariu dhe Muslimi)

Ramazani është pranvera e zemrës. Është muaj i madhësisë dhe i bekimit të Zotit. Ditët dhe netët mbushen me aromën e adhurimit. Jeta merr një atmosferë dhe ngjyrë tjetër. Mëshira hyjnore zgjon zemrat e zhytura në gjumin e pakujdesisë.

Gjatë Ramazanit kalitet shpirti dhe trupi prandaj ai konsiderohet një shkollë hyjnore ku individit dhe shoqëria pajisen me mësimet e tij të vlefshme sikurse janë: bindja, vullneti, këmbëngulja, qëllimi fisnik, pastrimi i vetes dhe sinqeriteti. Agjërimi mënjanon brengat e zemrës dhe ndikon në shpirtin dhe psikikën e njeriut.

Ramazani është muaji i ditëve dhe i netëve përplot adhurim dhe lutje. Ai është një gosti hyjnore. Agjërueti i përzgjedhur në rrethin e të nderuarve të Zotit është i ftuar për t’u ulur në sofrën e faljes dhe të mëshirës.

Dr. Ajni Sinani

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës “Muhamed”

Kaptina “Muhamed” ka gjithsej 38 ajete, 539 fjalë dhe 2349 shkronja. Ka zbritur pas sures “El-Hadid” dhe para sures “Er-Rra’d”. Në radhitjen e Mus’hafit mban numrin 47, kurse në radhitjen e zbritjes është e 96-ta.

Kaptina “Muhamed” sipas mendimit unanimit të dijetarëve është kaptinë medinase. Transmeton Ibn Durejsi nga Ibn Abbasi të ketë thënë: Ka zbritur surja “El-Kital” në Medinë. Transmetojnë Nehasi, Ibn Merdevejhi dhe Bejhekiu po ashtu nga Ibn Abasi të ketë thënë se surja “Muhamed” ka zbritur në Medinë. Ibn Merdevejhi po ashtu transmeton nga Ibn Zubejri të ketë thënë: Ka zbritur surja “El-ledhine keferu...” në Medinë.¹

Nëpër disa libra të tefsirit mund të haset edhe një mendim që është përcjellë nga Katadeja dhe Ibn Abasi se kjo sure është medinase, por e kanë përmendur se ajeti 13: “Sa e sa qytete, që ishin shumë më të fortë se qyteti që të dëboi ty, Ne i shkatërruam dhe askush nuk u ndihmoi”, ka zbritur në Mekë, pas haxhit lamtumirës. Ky mendim i tyre, ka qenë shkak që disa dijetarë si Dahhaku, Seid ibn Xhubejri, Tha’lebiu etj., të hamendësojnë se kjo sure është mekase, mendim i cili megjithatë nuk ka asnjë mbështetje, meqë fjalët e Ibn Abasit dhe të Katades janë keq-kuptuar dhe nxjerrë nga konteksti, sepse nëse ky ajet ka zbritur në Mekë, në haxhin lamtumirës, kjo në asnjë mënyrë nuk e vë në dyshim zbritjen medinase të kësaj sureje, sepse çdo ajet që ka zbritur pas hixhretit, llogaritet zbritje medinase, pavarësisht se ku ka zbritur. Madje, as Imam Sujutiu në “El-Itkan”, nuk përmend ndonjë mospajtim të dijetarëve lidhur me zbritjen

Kjo sure në mesin e shumicës dërmuese të dijetarëve njihet me tre emra, por emri më të cilin është njohur që nga koha e sahabëve, e me të cilin është radhitur edhe në Mus’hafe, në librat e tefsirit dhe të Sunetit, është: “Muhamed”.

medinase të kësaj sureje, e as që e përmend ajetin 13 se mund të jetë zbritje mekase.²

Kaptina “Muhamed” ka gjithsej 38 ajete, 539 fjalë dhe 2349 shkronja.³ Ka zbritur pas sures “El-Hadid” dhe para sures “Er-Rra’d”. Në radhitjen e Mus’hafit mban numrin 47, kurse në radhitjen e zbritjes është e 96-ta.⁴

Emërtimi i kësaj kaptine

Kjo sure në mesin e shumicës dërmuese të dijetarëve njihet me tre emra, por emri më të cilin është njohur që nga koha e sahabëve, e me të cilin është radhitur edhe në Mus’hafe, në librat e tefsirit dhe të Sunetit, është: “Muhamed”. Me këtë emër e ka radhitur edhe Buhariu⁵ në koleksionin e tij në materien rreth



tefsirit. Ky emërtim bazohet në ajetin e 2-të të kësaj sureje: “Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e Vërteta prej Zotit të tyre, Ai atyre do t’ua mbulojë të këqijat e tyre dhe do t’ua përmirësojë gjendjen.” Arsyeja e këtij emërtimi është edhe fakti se kjo sure është e para në të cilën është përmendur emri i Muhamedit a.s., në mënyrë të drejt-përdrejtë.⁶

- Emërtimi i dytë i kësaj sureje është “Suretu-l-Kital”, për shkak se në ajetin e 4-të, të kësaj sureje gjejmë ligjësimin e luftës: “Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditni në qafë derisa t’i mposhtni (rraskapitni)! Më pas, lidhini mirë, e pastaj, ose lironi falas ose kërkonin dëmshpërbim për ta, derisa të përfundojë lufta...”

Emërtimi i kësaj sureje me “Suretu-l-Kital-Kaptina e Luftës” ka mbështetje të fuqishme edhe në ajetin 20 të kësaj sureje: “Besimtarët thonë: “Sikur të ishte shpallur një sure (për luftën)!” E kur u shpall një sure e qartë dhe në të u përmend lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikim si të agonisë së vdekjes! Ndërkohë, më parësore për ta do të ishte...” dhe ky emërtim, në fakt është një emërtim i vërtetë kuranor, sepse “lufta” e ligjshme është një ndër tematikat qendrore të saj.⁷

- Ndërsa emërtimi i tretë i kësaj sureje është: “Suretu-l-ledhine keferu”, i cili është një emërtim më pak i njohur dhe më pak i përdorur nga komentatorët. Arsyeja e këtij emërtimi është ajeti i parë i kësaj sureje: “Allahu do t’ua asgjësojë veprat atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij.”

Në lidhje me këtë emërtim, si argument kemi transmetimin nga Ibn Zubejri, të cilin e përmendëm në fillim kur thotë: “Ka zbritur surja “El-ledhine keferu...” në Medinë,⁸ si dhe fjalët e Ibn Omerit i cili thotë: “I Dërguari i Allahut e këndonte në namazin e akshamit: Allahu do t’ua asgjësojë veprat atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij” – (Muhamed, 1).⁹

Vlera e kësaj kaptine

- Surja “Muhamed” bën pjesë në grupin e sureve “El-Methani”. Në lidhje me këtë, transmetohet nga Vathilete ibnul Eska’ë el-Lejthi, të ketë thënë: “Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: “Më është dhënë në vend të Tevratit, shtatëshja, (suret nga El-Bekare e deri tek El-Enfal ose Et-Tevbe); më janë dhënë në vend të Zeburit, “El-Mi’ine” - njëqindëshet, (suret që kanë mbi 100 ajete); më janë dhënë në vend të Inxhilit “El-Methani” - (suret që kanë më pak se 100 ajete), ndërsa jam mbi-nderuar (ndaj të dërguarve të tjerë) me suret “El-Mufassal” (nga surja Kaf, e është thënë nga El-Huxhurat, deri tek En-Nas).”¹⁰

- Transmetohet nga Ibn Omeri r.a. të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut në namazin e akshamit lexonte prej ajetit: “Allahu do t’ua asgjësojë veprat

Kjo sure përmban dispozita ligjore-sheriatike sidomos për çështjen e luftës, të robërve të luftës, përshkrimin e cilësive të jobesimtarëve dhe të besimtarëve, ndëshkimin dhe shpërblimin e tyre në Ahiret dhe po ashtu flet edhe për një grup të tretë, atë të mynafikëve-hipokritëve dhe intrigat e tyre karshi myslimanëve.

atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij” – (Muhamed, 1).¹¹

Shkaku i zbritjes

Rreth shkaqeve të zbritjes së kësaj sureje si tërësi, nuk kemi ndonjë shkak specifik të zbritjes, por kemi shkaqe të veçanta për ajetet: 1, 5, 11, 13, 16, 32 dhe 33, për të cilat do të flasim gjatë komentimit të këtyre ajeteve, veç e veç.

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake “El-Ahkaf”

Përderisa surja “El-Ahkaf”, përmbodhi argumentet rreth Njëshmërisë së Allahut, argumentet rreth vërtetësisë së Shpalljes që i zbritën Muhamedit a.s., dhe rreth ringjalljes, duke kritikuar e qortuar idhujtarët dhe jobesimtarët për shirkun dhe kufrin e tyre, pastaj ua shfaqti haptazi animet e tyre të sëmura, pasojë e të cilave ishin shkatërrimi në këtë botë dhe ndëshkimi i dhimbshëm që i pret në Ahiret, për të përfunduar me nxitjen e besimtarëve që të bënin durim derisa Allahu ta përmbushte premtimin e Tij ndaj tyre, tash në suren Muhamed, na paraqitet një tablo krejtësisht e kundërt. Në këtë sure sqarohen qëndrimet dhe cilësitë e jobesimtarëve, të cilët jo vetëm se nuk besonin, por madje ishin pozicionuar haptazi në pengimin e njerëzve në rrugën e Allahut. Madje në këtë sure besimtarët motivohen haptazi që të mbrojnë e t’i realizojnë të drejtat e tyre, qoftë edhe me luftë, konform përgjegjësisë që kanë në sendërtimin e asaj që i urdhëron Allahu, e që është vënia e drejtësisë në Tokë.

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake El-Ahkaf, sidomos fundi i saj me fillimin e sures Muhamed, është aq e fuqishme, saqë po të hiqej “besmeleja” nga fillimi i sures

Muhamed, ajetet do të dukeshin sikur janë krejtësisht të lidhura në mes vete nga aspekti kuptimor, sepse surja paraprake El-Ahkaf, përfundoi me fjalët: "...E kush tjetër do të shkatërrohet, përveç popullit të pabindur!?", ndërkohë që kjo sure, Muhamed fillon me përmendjen e jobesimtarëve: "Allahu do t'ua asgjësojë veprat atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij."

Përmbajtje e shkurtër e kësaj kaptine

Kjo sure e bekuar, shtjellon tematika shumë të ndjeshme, me ndikim të madh në jetën e myslimanëve në çdo vend dhe kohë. Kjo sure përmban dispozita ligjore-shariatike sidomos për çështjen e luftës, të robërve të luftës, përshkrimin e cilësive të jobesimtarëve dhe të besimtarëve, ndëshkimin dhe shpërblimin e tyre në Ahiret dhe po ashtu flet edhe për një grup të tretë, atë të mynafikëve-hipokritëve dhe intrigat e tyre karshi myslimanëve.

Tërë suren, që nga fillimi e deri në fund të saj, e përshkon fryma e një beteje të vazhdueshme e të pa kompromis ndërmjet imanit në njërën anë dhe kufrit e hipokrizisë në anën tjetër, me të gjitha dritë-hijet e saj.

- Ajetet (1-3), të kësaj sureje fillojnë me përmendjen e jobesimtarëve, veprat e të cilëve do të jenë të zhvlerësuara, për shkak të armiqësisë së tyre dhe pengimit të besimtarëve në adhurimin e Allahut, për të vazhduar me përmendjen e besimtarëve të cilët i besuan Allahut dhe asaj që i zbriti Muhamedit a.s. dhe si shpërblim për këtë Allahu do t'ua shlyejë mëkatet. Ata që ndoqën të pavërtetën do të jenë në ndëshkim, kurse ata që ndoqën rrugën e drejtë dhe të vërtetën, do të jenë në kopshtet e Xhenetit.

- Në vijim të sures, hasim në dispozita shariatike rreth luftës, robërve të luftës dhe të vlarëve në rrugën e Allahut. (Shih ajetet: (4-6).

- Ajetet (7-15), nisin përsëri me përmendjen e besimtarëve dhe mohuesve për të vazhduar me përmendjen e popujve të kaluar dhe ndëshkimit të tyre për shkak të kufrit dhe arrogancës së treguar ndaj argumenteve të Allahut, dhe përfundojnë me meditim rreth gjendjes së besimtarëve në Xhenet, teksa shijojnë kënaqësitë e dhuruara nga Krijuesi Fuqiplotë, dhe rreth ndëshkimit të mohuesve e keqbërësve në greminat e zjarrta të Xhehenemit.

- Çështja e hipokritëve zë vend të konsiderueshëm në ajetet e kësaj sureje, duke filluar me ajetin e 16-të, por sërish, mbizotëron përmendja e besimtarëve, sa për të sqaruar se çfarë pozite të lartë nderi do të kenë ata që u udhëzuan në rrugën e drejtë, ndërkohë që ky grup ajetesh përfundon me përmendjen e faktit se Allahu është Një, prandaj i Madhërishmi i drejtohet Muhamedit a.s. që të kërkonte falje për vete dhe për besimtarët e besimtare, sepse vetëm këtë grup të të sinqertëve në besim, do ta përshkojë mëshira e Allahut. (Shih ajetet: (16-19).

- Edhe ajetet (20-24), flasin vetëm për hipokritët duke përshkruar sëmundjen që kanë në zemra, dhe përtacia e tyre në kohën kur duhet t'i përgjigjen urdhrat të Allahut dhe të Pejgamberit a.s.. Të tillët janë të mallkuar nga Allahu, për shkak të hipokrizisë së tyre dhe i ngjasojnë të shurdhrit e të verbrit, që as dëgjon e as sheh të vërtetën.

- Çështja e hipokritëve dhe gjendja e tyre në momentin kur engjëlli i vdekjes ua merr shpirtat, duke i goditur me ashpërsi fytyrat dhe shpinat e tyre, është përmendur gjerësisht në ajetet (25-30), sa për të na rikujtuar se ky është fati i atyre që në vete fshihnin "nifakun" – dyfytërsinë, e haptazi hiqen si besimtarë të devotshëm.

- Ajetet (31-34) flasin për jobesimtarët nga radhët e Ehli

Kitabit, të cilët ndonëse e dinin se i Dërguari a.s. erdhi me të vërtetën, ata prapëseprapë nuk e besuan, por madje u munduan edhe t'ia vështirësonin misionin e tij pejgamberik, duke e penguar me metoda më perfide dhe më armiqësore. E, në këto ajete kemi edhe këshillën për besimtarët, që t'i binden vetëm Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sepse ata që veprojnë ndryshe, dhe vdesin si jobesimtarë, Allahu kurrë nuk do t'ua falë kufirin dhe ligësinë e tyre.

- Kjo sure e bekuar përfundon me thirrjen që myslimanët kurrsesi të mos shfaqin dobësi e të pranojnë armëpushim sa kohë që janë më të fuqishëm, për t'ua bërë me dije se jeta e kësaj bote është e shkurtër, dhe është një zbavitje e argëtimit i shkurtër dhe shpejt kalon. Prandaj, vetëm ato vepra të mira që bëhen për hir të Allahut mbesin të përjetshme, sidomos dhënia në rrugën e Allahut. E ai besimtar që tregohet koprrac dhe dorështrënguar e nuk jep, ai e ka dëmtuar vetëm veten, sepse Allahu nuk ka nevojë për pasurinë e tij, dhe Ai është i Plotfuqishëm që t'i zëvendësojë këta koprracë me një popull tjetër të cilët nuk do ta ndjekin shembullin e tyre por do të japin në lartësimin e rrugës së Allahut. (Shih ajetet: (35-38). - vijon -

1. Imam Shevkani, *Fet'hul Kadir, Mensure-Egjypt, 1994, vëll.V, f. 38*. 2. Imam Sujuti, *El-Itkan, Bejrut, 2008, (1/34-36)*, (redaktuar nga Shejh Shuajb el Arnauti). 3. Fejrزابادي, *Besairu dhevi-t-Temjizi, Kajro, 1996, vëll. I, f. 430*. 4. Ibn Ashur, *Et-Tahriru ve-t-Tenviru, Tunis, 1984, vëll. XXVI, f. 71*. 5. Sahihul Buhari (4/1828) 6. Dr. Munire ed-Devserij, *Esmau suveri-I Kuran ve fedailuha, Demmam, 1426 h., f. 386*. 7. Sejjid Kutb, *Fi Dhilalil Kuran, (6/3278)*. 8. Esmau suveri-I Kuran ve fedailuha, f. 388. 9. Dr. Muhamed bin Abdurrahman esh-Shaj'i, *Esmau suveri-I Kurani-I kerim, Rijad, 2011, f. 142*. 10. Transmeton Imam Ahmedi (4/107); *Bejhekiu në Shuabi-I Iman (2/465)*. 11. Ky është ajeti i parë i sures Muhamed, që nënkupton se i Dërguari a.s. e ka lexuar tërë suren ose një pjesë të konsiderueshme të saj. E transmeton Taberaniu në *El-Mu'xhemul Kebir, Kajro, 1983, vëll. 12, f. 372, nr. (13380)*; në *El-Mu'xhemul Evsat, Kajro, 1995, vëll. II, f. 57, nr. (1239) dhe vëll. II, f. 206, nr. (1742)*. Transmetimi është i kategorisë "sahih".

Dr. Ajni Sinani

Kurani u jep lexuesve informacion të veçantë që nuk është ditur më herët

Rrëfimet kuranore përfshijnë të kaluarën, të tashmen, si dhe çështjet e së ardhmes. Çështjet e padukshme janë ndër çështjet që Zoti i Madhërishëm i ka veçuar për vete: “Çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij...” (El-En'am, 59).

Pejgamberi a.s., si pjesa tjetër e njerëzve nuk dinte asgjë për të padukshmen. Kur ai na informon për të shkuarën, atëherë kjo është dëshmi e vërtetësisë së peygamberisë dhe mesazhit të tij, sikurse që thotë i Lartësuar: “Ai është që e di të fshehtën, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt, me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do...” (El-Xhinn, 26-27).

Rrëfimet e panjohura në Kuranin fisnik erdhën për të vërtetuar se Kurani fisnik është libri i Zotit.¹

Kurani fisnik flet herë pas here për popujt dhe shoqëritë e mëparshme që deri në atë kohë, në historinë e njerëzimit nuk kishte asnjë informacion për ta. Nëse kthehemi dhe shqyrtojmë atë që trajtuan poetët dhe historianët arabë do ta shohim se nuk ka asnjë informacion për ato ndodhi të trajtuara në Kuranin famëlartë. Në këtë shkrim do të fokusohemi te rrëfimet mbi ndodhitë e panjohura në të shkuarën që na informojnë për tregimet e peygamberëve të mëparshëm.

Kurani e ka grisur velin e së kaluarës. Kjo grisje ishte për ta informuar Muhamedin a.s. për lajmet e sakta për të dërguarit që i kishin paraprirë: “Dhe ti nuk banove në mesin e popullit të Medjenit e t’iu lexosh këtyre argumentet Tona (lajmin për Musain, për Shuajbin, për

Dëshmitë për vërtetësinë e Kuranit janë të shumta dhe pothuajse të panumërueshme. Ato prova janë të mjaftueshme për të bindur çdo njeri të drejtë e të arsyeshëm që e kërkon të vërtetën me paanshmëri dhe objektivitet.

vajzat e tij), por Ne të dërguam (dhe të njoftuam).” (El-Kasas, 45);

“Dhe ti nuk ke qenë pranë Kodrës Tur, kur Ne e thirrëm (Musain), por (tregimi ynë) është mëshirë nga Zoti yt, për t’ia tërhequr vërejtjen një populli, që para teje nuk iu kishte ardhur ndonjë peygamber, dhe ashtu ata të marrin mësim.” (El-Kasas, 46).

Kurani korrigjoi në librat qiellorë që Zoti i shpalli, atë që ishte ndryshuar e shtrembëruar nga rabinët dhe murgjit: “Kjo është (fjalë) e vërtetë, rreth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata shkaktojnë dyshime.” (Merjem, 34)

Dëshmitë për vërtetësinë e Kuranit janë të shumta dhe pothuajse të panumërueshme. Ato prova janë të mjaftueshme për të bindur çdo njeri të drejtë e të arsyeshëm



që e kërkon të vërtetën me paanshmëri dhe objektivitet. Prej dëshmimeve shumë interesante janë edhe rrëfimet e panjohura përmes së cilave Kurani fisnik sjell informacione që ai thotë se ato janë diçka e re. Ai tregon se ato rrëfime nuk i kishin ditur më herët Muhamedi a.s. dhe as populli i tij: “Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura (për ty), që po t’i shpallim ty, e që para këtij (Kurani) nuk i ke ditur, as ti, as populli yt...” (Hud, 49).

Zoti i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij se këto rrëfime që po t’i shpallim ty për Nuhun dhe popullin e tij ti dhe as populli yt nuk dije për to para shpalljes së tyre.²

Kurani i sfidoi njerëzit me lajme historike të cilat askush nuk ka mundur t’i mohojë. Realisht, sikurse thotë edhe dr. Miller: “Nuk ka libër tjetër të shenjtë që e përdor këtë stil. Të gjithë librat e tjerë përbëhen nga informacioni që iu tregon se ky informacion ka ardhur nga... Për shembull, kur Bibla flet në lidhje me tregimet e popujve të lashtë, ajo tregon se ky mbret jetonte në këtë vend, se ai udhëheqës luftonte në atë betejë dhe se një person i caktuar ka një numër të caktuar fëmijësh dhe se emrat e tyre janë ... Por Bibla gjithmonë tregon se nëse doni të dini më shumë, ju mund të lexoni një libër të caktuar, ngase informacioni vjen nga ai libër. Krejt ndryshe është me Kurani, i cili jep informacionin dhe tregon se ai informacion është i ri!”³: “Këto janë nga lajmet e fshehta (të hershme), që po t’i shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur i hidhnin shortet, se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Mejremes, nuk ishe pranë tyre, as kur ata ziheshin mes vete.” (Ali Imran, 44).

Dhe lajmet "e fshehta" do të thotë se janë nga ato lajme të panjohura të njerëzve që as ti, Muhamed, as populli yt nuk i dinit, dhe vetëm një numër i vogël rabinësh çifut e murgjish të krishterë dinin për to.⁴

“Këto janë nga ato lajme të panjohura, e Ne po t’i shpallim ty

Natyrisht gjithnjë është e vazhdueshme thirrja për të hulumtuar për informacionin që gjendet në Kuran dhe të tentohet të sfidohet vërtetësia e tij. Kjo nuk ndodhi kurrë!

(Muhamed), se ti nuk ke qenë pranë tyre kur ata vendosën çështjen e tyre (hedhjen e Jusufit në bunar etj.) dhe kur bënin dredhi.” (Jusuf, 102).

Zoti i thotë Muhamedit a.s. në këtë ajet se këto lajme që të informova për Jusufin, babanë e tij Jakubin, vëllezërit e tij dhe të tjera që janë në këtë sure, janë të panjohura ngase ti as nuk dije për to dhe as ishe dëshmitar i tyre.⁵

Ato ishin të vërteta që Zoti ia shpalli Muhamedit a.s.. Prandaj, idhujtarët e Mekës që i urrenin myslimanët dhe që vazhdimisht i dëgjonin ato ajete kuranore që thoshin se sillnin lajme dhe informacione të reja, asnjëherë nuk e ngritën zërin dhe të thoshin: “Ky nuk është lajm i ri. Ne e dimë ku e ka marrë Muhamedi këtë informacion. Ne e kemi mësuar këtë në shkollë.”⁶

Ata nuk mundën të sfidonin vërtetësinë e Kurani, sepse me të vërtetë ato ishin lajme të reja dhe të panjohura më parë: “Ti as nuk ke shpresuar, se do të shpallet ty libri, por kjo është mëshirë e Zotit tënd, prandaj ti kurrsesi të mos jesh ndihmëtar i jobesimtarëve.” (El-Kasas, 86).

Natyrisht gjithnjë është e vazhdueshme thirrja për të hulumtuar për informacionin që gjendet në Kuran dhe të tentohet të sfidohet vërtetësia e tij. Kjo nuk ndodhi kurrë! Por ajo që ndodhi ishte se askush nuk guxoi

të thoshte se ato rrëfime ishin të pasakta sepse ato ishin me të vërtetë informacione të reja, që nuk vinin nga mendja e njeriut, por prej Zotit që e di të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen: “Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se i Adhuruari juaj i vërtetë është vetëm Një (Allahu), e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askënd.” (El-Kehf, 110)

Në përputhje me këshillat e dhëna në Kuran, për të hulumtuar informacionin kur ai është i ri, kur Omeri u bë halif, ai zgjodhi një grup burrash dhe i dërgoi ata të gjejnë murin e Dhulkarnejnit. Përpara shpalljes së Kurani, arabët nuk kishin dëgjuar kurrë për këtë mur, por për shkak se Kurani e përshkroi atë, ata qenë në gjendje ta zbulonin atë. Në fakt ai tani gjendet në Durbend,⁷ në ish-republikat e Bashkimit Sovjetik: “Këto janë disa nga lajmet e vendeve që po t’i rrëfejmë ty; disa prej tyre ekzistojnë ende, e disa janë shkatërruar.” (Hud, 100).

Padyshim këto rrëfime në Kuran janë diçka unike dhe të mahnitshme, që nuk janë të pranishme në ndonjë libër tjetër.

1. <https://sotor.com.2> Shih: <http://www.quran7m.com/searchResults/003044.html?fbclid=IwAR1BKbkkbtS4dOV3Fs1zjo1OdFUsJ2kWI0XFDjEjPg4GQjxwu22k-sGnTcY3> Gary Miller, Kurani i mrekullueshëm (2), Dituria Islame, Revishtë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht Prishtinë, 2021, Dhul Hixhxe-Muharrem, 1442/1443, f. 21. 4. Shih: <https://quran.ksu.edu.sa/tafseer/tabary/sura3-aya44.html> 5. Shih: <http://quran.ksu.edu.sa/tafseer/tabary/sura12-aya102.html> 6. Gary Miller, Kurani i mrekullueshëm (2), Dituria Islame, Revishtë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht, Prishtinë, 2021, Dhul Hixhxe-Muharrem, 1442/1443, f. 21. 7. Gary Miller, Kurani i mrekullueshëm (2), Dituria Islame, Revishtë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht Prishtinë 2021, Dhul Hixhxe-Muharrem, 1442/1443, f. 21.

Mr. Muhidin Ahmeti

Mirë se vjen muaji i madhërishëm Ramazan

“O ju që keni besuar, agjërimi është bërë obligim për ju, sikurse ishte obligim edhe për ata para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare, 183-185)

Këto ditë kemi hyrë në një periudhë të re të ndryshimeve kalendarike në gjithësi. Jemi në ditët e para të muajit të madhërishëm të Ramazanit. Qoftë i lavdëruar Krijuesi i gjithësisë që na e bëri të mundur ta presim edhe këtë herë Ramazanin e bekuar. Po e presim muajin, ku për herë të parë, në shpellën Hira, shndriti shkëndija e dritës së All-llahut në zemrën dhe shpirtin e të dërguarit të Tij - Muhammedit (a.s.). Të nderuar besimtarë, po fillon muaji i ditëve të bekuara dhe netëve të mëdha, muaji i zgjimit të muslimanëve dhe ndër-gjegjësimit të rinisë muslimane, muaji i përparimit, i ngritjes shpirtërore dhe i afrimit të muslimanëve tek Burimi i udhëzimit, fuqisë dhe mirësisë.

Çdokush lind i pastër në shpirt. Edhe ne, pra, kemi lindur pa gjynahe. Lum për atë që nuk e përlyen shpirtin dhe nuk bie në gjynah.

Që në fillim të këtij muaji, të nderuar besimtarë, po japim mesazhin e Allahut xh.sh. për këtë Ramazan: “O ju që besuat, agjërimi iu është bërë obligim, sikurse ishte

obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë) janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo po qe se e dini agjërimi është më i mirë për Ju. (Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim,



le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë, që iu udhëzoi dhe që të falënderoni.” (El-Bekare, 183-185).

Çdokush lind i pastër në shpirt. Edhe ne, pra, kemi lindur pa gjynah. Lum për atë që nuk e përlyen shpirtin dhe nuk bie në gjynah. Ky është sekret i suksesit në këtë botë dhe ky është sekret i shpëtimit në botën tjetër – që të kthehet shpirti atje prej nga ka ardhur sa më i pastër dhe sa më i pamëkatë që është e mundur. Kjo botë është një kurth i madh në të cilin mund të bie shpirti, nëse nuk di ta kalojë. Kjo botë është një labirint i madh në të cilin ka shumë rrugë, por vetëm njëra prej tyre ka dalje, sepse: “Të gjitha rrugët, disa prej të cilave janë edhe të gabuara, përfundojnë tek Allahu i Lartësuar.

Ramazani është koha dhe agjërimi është mënyra që të kapërcehet kurthi, i cili përgjon shpirtin në çdo hap të dunjasë. Ramazani është koha kur Krijuesi na ofron rastin që të pushojmë shpirtin nga kërkesat e tepruara të trupit dhe që ta pastrojmë nga mbeturinat e dunjallëkut, të cilat e ndotin dhe e helmojnë atë.

Ramazani është një periudhë në të cilën shpirti zgjohet dhe e pastron veten nga papastërtitë e kohës dhe vetëdijësohet deri në atë shkallë sa të jetë në gjendje ta dallojë të mirën nga e keqja, dhe të ngrihet në mbrojtje të së vërtetës dhe të drejtësisë.

Ramazani është koha e takimit më të dashur të Qiellit dhe Tokës, sepse aty filloi të rrjedhë lumi i urtësisë nga Burimi qiellor dhe duke rrjedhur arriti të derdhet në zemrën tokësore. Në këtë muaj melaqet zbresin në Tokë si asnjëherë më parë dhe bashkë me ne e presin atë natën e madhe që është më e mirë se një mijë muaj.

Që në fillim, muaji i ramazanit i ka ofruar dhe i ofron njeriut përmirësim të veçantë shpirtëror. I mundëson të shikojë më mirë zanafillën e mëshirës së Zotit dhe të ndjejë më fuqishëm

Ramazani është koha e takimit më të dashur të Qiellit dhe Tokës, sepse aty filloi të rrjedhë lumi i urtësisë nga Burimi qiellor dhe duke rrjedhur arriti të derdhet në zemrën tokësore.

aromën e shpresës njerëzore, i ofron Faljen e përjetshme të Zotit që ta çlirojë nga frika e vetmisë dhe ta shpjerë në botën dhe historinë e besimit e të shpresës së vërtetë.

Ramazani, të nderuar besimtarë, është miku ynë më i dashur që na viziton çdo vit dhe na sjell dhuratat më të mira, na sjell dhurata shpirtërore, dhuratat e Zotit të Lartësuar. Ramazani është pranverë qiellore që i viziton njerëzit e Tokës në çdo stinë të vitit tokësor. Ndonëse në Tokë ndërrohen stinët e vitit, stina e Ramazanit është gjithmonë pranverë e shpirttrave tanë.

Çdo musliman kudo në botë i gëzohet muajit të Ramazanit dhe e pret me padurim ardhjen e tij. Muslimanët e presin me padurim Ramazanin, sepse në të qëndron fuqia e besimtarit, forca pushtuese e atyre që i janë dorëzuar Allahut (xh. sh.), qetësia e të devotshmëve, shpresa e gjynahqarëve, çlirimi i të nënshtruarve.

Kur afrohej muaji i Ramazanit Pejgamberi (a. s.) thoshte: “O njerëz, u afrua muaji i Ramazanit, muaji i bekimeve e i bereqetit, muaji i lumturisë e përparimit, muaji në të cilin gjendet nata e Kadrit, që është më e

mirë dhe më e vlefshme se një mijë muaj! Allahu ju ka urdhëruar të agjëroni çdo ditë të Ramazanit, kurse netët e tij t’i kaloni në ibadete vullnetare (nafile). Kush fal nafile në Ramazan, është sikur të falë farz në ndonjë muaj tjetër, ndërsa kush fal një farz në Ramazan është sikur t’i falë 70 farze jashtë Ramazanit. Ramazani është muaji i durimit, e shpërblimi për durim është xhenneti. Ky është muaji i ndihmës së ndërsjellë të muslimanëve, muaji në të cilin besimtarit i shtohet furnizimi (risku), kush e ushqen (jep iftar) një njeri që është agjërueshëm, kjo për të është falje e gjynaheve të tij dhe shpëtim nga dënimi me zjarr të xhennemit.” (Ibni Huzejme)

Ramazani, të nderuar besimtarë, është rasti më i mirë për ne që ta pastrojmë zemrën dhe ta përtërijmë shpirtin, të forcojmë trupin dhe t’i bëjmë më të spikatura kualitetet tona. Ky muaj është i mirëseardhur për ata që janë të sëmurë fizikisht dhe shpirtërisht. Agjërimi, gjatë një muaji të tërë, i mjekon ata duke ua shëruar edhe trupin, edhe shpirtin atyre. Ai bën kurban kënaqësitë e trupit për t’ia bërë dhuratë shpirtit. Për ata që e kanë harruar Zotin, Ramazani do t’ua përkujtojë marrëveshjen që shpirtat e tyre e kanë bërë në Ezel me Krijuesin e tyre. Kush e ka humbur durimin, do ta gjejë në këtë muaj, të forcuar e të shumëfishuar. Ata që kanë filluar të tërhiqen nga rruga e drejtësisë, Ramazani do t’ua kthejë qëndrueshmërinë. Në qoftë se në shoqëri është futur virusi i përçarjes, në Ramazan do të fitojë rëndësia e mirëkuptimit dhe e bashkëpunimit, e solidaritetit dhe e ndihmës reciproke të njerëzve, pavarësisht nga dallimet dhe diversiteti i tyre.

Në kopshtin e Allahut nuk ka asnjë pemë tjetër që i afrohet dhe që mund të krahasohet me pemën e jetës ramazanore, sepse, ndonëse është një pemë, frytet e saj nuk janë të njëllota, por pafundësisht të ndryshme dhe të shumëllojshme.



Ramazani është epiqendër për forcimin e fuqisë shpirtërore, psikike e morale në jetën e popullit e të individit. Ky na rikujton të vërtetën e qiejve dhe të tokës, na armatos me fuqi ngadhënjyese, na nxit ta duam lirinë, prej së cilës varet nderi dhe dinjiteti i njerëzimit. Ramazani, pra, na dhuron “të vërtetën”, “fuqinë” dhe “lirinë” gjatë ditëve të urisë dhe etjes... Kushdo që e kupton urtësinë dhe filozofinë e agjërimit, lufton me bindje të plotë për të vërtetën, ngadhënjën dhe arrin qëllimin më fisnik të lirisë, përkatësisht refuzon nënshtrimin dhe robërinë.

Vetëm në pranverën e Ramazanit shpirti musliman kalitet dhe mpreh shkëlqimin e fisnikërisë vetjake në dritën e pastër të Fjalës së Allahut, të asaj Fjale që kaloi nëpër të gjitha periudhat e historisë së shenjtë dhe erdhi te i Dërguari i fundit, tek Muhammedi (a.s.) në Ramazan, në natën e Kadrit.

Vetëm në natën e Ramazanit është nata e 27. Nata e dritës mbi dritat. Nata më e shndritshme se çdo ditë, më e vlefshme se një mijë muaj, më e gjatë se çdo jetë njerëzore. Nata që bëri pajtimin e Qiellit me tokën, Nata e fatit të botës dhe Nata e shkëlqimit të diturisë.

Vetëm në Ramazan ndodh Bedri. Bedri i shpirtit tonë dhe i trupit tonë, Bedri i së mirës dhe i së keqes, Bedri i së vërtetës dhe gënjeshtërisë, Bedri i jetës dhe i vdekjes, Bedri i lirisë dhe i robërisë.

Muaji i Ramazanit, krijon një atmosferë shpirtërore kolektive. Të gjithë agjëruesit e ndiejnë se në këtë muaj po lind një jetë e re, një mënyrë krejt ndryshe e jetës, një frymë e re ripërtëritëse ramazanore, një botë-kuptim dhe një botë e re e pa parë më herët. Ai është kriteri më i mirë i kohës, në vitin ku shpirti mund të disiplinojë trupin që të pushojë nga lakmia e tij e keqe. Këtë, padyshim, e mundëson elementi i parë dhe më i rëndësishëm i Ramazanit, e ai është agjërimi. Agjërimi është faktor i pazëvendësueshëm në edukimin e brezit të ri dhe në formimin e personalitetit të njeriut.

Pejgamberi (a.s.) thotë: “Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e Xhehennemit dhe pengohen shejtanët”.

Ramazani është edhe muaji i zekatit e zekatit fitrit, muaji i filjimit të pasurisë në rrugën e All-llahut për të mirën e përgjithshme.

“Ata të cilët pasurinë e vet e shpenzojnë në rrugë të Allahut i ngajjnë shembullit të një kokrrë prej së cilës

mbijnë shtatë kallinj, e në secilin kalli nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon kujt do Ai. Allahu ka horizont të gjerë të dijes.” (El-Bekare, 261).

Ramazani është muaji i namazeve të teravisë, ligjëratave e vazeve, i qëndrueshmërisë, i gatishmërisë dhe i forcës. Muaji i dashurisë, vëllazërimit, unitetit e solidaritetit: “O agjërues, mos e shuaj vetëm urinë dhe etjen tënde, por shuaje urinë dhe etjen edhe të tjerëve!” Ai është muaji i ibadeteve të shumta, muaji i Kuranit, Lejletu’l-Bedrit e Lejletu’l-Kadrit. Muaji i ngjarjeve të rëndësishme nga historia islame, i datave të shënuara e përkujtimeve të paharruara.

O Allah i Gjithëdijshtëm, e dëgjuam urdhrin Tënd të agjërimit në muajin e Ramazanit. Ne i përgjigjemi me sinqeritet dhe modesti dhe të lutemi që t’u ndihmosh të paaftëve, t’ua falësh gjynahet gabimtarëve dhe t’ua pranosh pendimin të penduarve.

O Allah i Gjithëmëshirshëm, afroji zemrat tona në ibadet dhe na ndihmo të jemi mirënjohës ndaj begative hallall dhe të largohemi nga rreziku i haramit. Amin!

Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

Ta presim Ramazanin sikur të jetë i fundit

Allahu i Madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron e thotë: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po që se e dini, agjërimi është më i mirë për ju. (Ato ditë të numëruara janë) Muaji Ramazan, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmure ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.” (El-Bekare, 183-185).

Kur njeriu kryen një punë, ose viziton një vend të caktuar, apo takohet me një person të dashur dhe me këtë rast mendon që nuk do të ketë rastin tjetër, kjo i fuqizon ndjenjat që këtë rast ta shfrytëzojë sa më mirë, ngase nuk përsëritet më. Kur sahabët dëgjonin këshillat e Pejgamberit a.s., sytë u lotonin, zemrat u dridheshin, dhe thoshin: “Sikur kjo është këshilla e fundit, e lamtumirës që nuk kthehet më!” (Tirmidhiu)

Në haxhin lamtumirës, Pejgamberi a.s., para turmës së mbledhur u drejtoi fjalët e udhëzimit dhe këshillat që ishin përmbledhje e pejgamberisë shumëvjeçare. Një fshehtësi e këshillës së tij drejtuar një sahabiu ishte: “Kur ngrihesh



për të falur namazin, fale sikur me qenë i fundit në jetë!” (Ibën Maxheh)

Imagjinoni njeriun i cili falet me sinqeritet duke ditur se është namazi i fundit i tij, sa do të mendohej ta kryejë me përkushtim, me përlulësi, i sinqertë në lutjet e tij? Pejgamberi a.s., na udhëzon dhe këshillon si të lirohemi nga kurthet e transformimit të ibadetit në adet - imitim.

Përse edhe ne nuk përpiqemi që ibadetet tona t'i bëjmë me përkushtim, sikur me qenë të fundit?! Gjithsesi jemi në udhëtim pa fund. Namazet tona nuk janë të vetmit që janë të ekspozuar rrezikut që të transformohen nga ibadeti në adet.

Ramazani është mysafiri ynë më i dashur. Ai do të na fisnikërojë nëse ndaj tij jemi fisnik. Me ardhjen e tij, përjetojmë ardhjen e bereqetit dhe mirësive të panumërta. Ai është mysafir që duhet prituri bukur. Ndoshta dikush prej nesh do ta pret për herë të fundit. Andaj, ta gostitim bukur mysafirin e dashur! T'i shfrytëzojmë momentet që t'i kalojmë me të!

Besimtarë të nderuar, ejani që bashkërisht të arrijmë ndjenjat të cilat i ka

dikush kur me një të dashur ndahet përgjithmonë, ta forcojmë besimin tonë duke kaluar këtë muaj të bekuar në shkallën më të lartë të vëmendjes dhe brengës, sikurse me qenë i fundit në jetë, duke shpresuar fuqishëm në shpërblimin dhe faljen e Allahut ndaj mëkateve tona të cilat janë të shumta.

Le të përpiqemi që këtë Ramazan ta studiojmë Kuranin fisnik duke medituar thellë për versetet e tij.

Përveç ushqimit trupor, le të pasurohem me ushqim shpirtëror, të mundohemi t'i gëzojmë familjet tona, farefisnin tonë dhe besimtarët e tjerë.

Le të përpiqemi të bëjmë sa më shumë vepra të mira.

Këtë vit le të përpiqemi që në vetmi të bëjmë llogari me vetveten.

Afrohu në safë me ata që nuk i njeh! Renditi rreshtat pas imamit me qëllim të bashkimit të zemrave në rrugën e vërtetë.

Edhe unë edhe ti kemi armiç. Të mbrohemi nga ata me lutje.

Për çdo vit dëgjojmë për vlerat e mëdha të këtij muaji të bekuar. Mundohu këtë vit që brenga jote kryesore të jetë shfrytëzimi i të gjitha begative të këtij muaji.

Vlera kulmore e Ramazanit arrin në natën e Kadrit. A ke menduar ndoshta viteve të kaluara dhe ke lëshuar rastin e këtyre vlerave? Shfrytëzoje këtë vit që sa më shumë të kalosh në ibadet, dhikër, mirësi, sepse ndoshta nuk do ta përjetosh më këtë!

Sill vendim të fuqishëm për fillim të ri me pendim të sinqertë dhe kthim kah Allahu i Madhërishëm.

Zot i dashur, na beko në këtë muaj! Na ndihmo të agjërojmë në mënyrë të drejtë dhe na bëj prej atyre që u ke pranuar agjërimin dhe na bëj prej të devotshmëve!

Husein Gjozo

Takimi me Ramazanin

Ramazani paraqet një mundësi unike për qetësi shpirtërore. Duhet të kuptohet vetëm ashtu dhe vërtet ashtu të përjetohet.

Njeriu është shumë i lidhur me nevojat e ekzistencës së tij fiziko-trupore, në mënyrë që të mund të lirohet nga materiet dhe presionet e tij. Përpjekjet për një lirim të tillë nuk do të ishin në përputhje me natyrën e qenies njerëzore, dhe sipas kësaj as në përputhje me mësimet islame. Është fakt i pakundërshtueshëm se njeriu është një qenie fizike, që jeton në kushtet e botës materiale dhe se jeta e tij është më shpesh e lidhur me materien. Karakteristika themelore e ekzistencës së tij në këtë botë është materia pa të cilën nuk mund të ekzistojë.

Islami në tërësi e pranon këtë karakter të jetës së kësaj bote. Nuk ka asnjë gërmë në Kuran, e jo vetëm ajet dhe rregull që do të mohonte varësinë materiale të njeriut.

Por njeriu, megjithatë, nuk është vetëm materie e as qenie fizike. Ai është padyshim shumë ma shumë se kaq. Nuk është një kafshë e zakonshme që vetëkënaqet me nevojat materiale. S'është edhe më shumë, qenie e pastër shpirtërore që nuk varet nga materia. Është diku në mes kafshës (hajvanit) dhe të melaqes. Aty e ka vendin për nga natyra e qenies së tij. Aty dhe duhet të mbetet. Nuk mund të shpërthejë pengesat e larta, nuk mundet, në formën dhe de-materializimin e tij, të dalë nga kornizat e natyrës njerëzore dhe varësisë nga materia. Ngritja njerëzore është e kufizuar. Nuk mund të dalë nga materia.

Por, në linjën e rrënjës nuk ka kufij. Njeriu mund t'i kthehet kafshës dhe madje të jetë më keq se ajo. Nuk është thënë pa arsye: "Nëse i thua

Qëllimi themelor i Islamit është forcimi i elementit shpirtëror, frenimi i instinkteve shtazore dhe krijimi i ekuilibrit midis nevojave materiale dhe shpirtërore.

njeriut që është kafshë, e keni ofenduar kafshën, e jo njeriun." (Tolstoi). Vetëm mundësia e kësaj lëkundjeje morale-shpirtërore, ngritjes dhe rënies paraqet karakteristikën thelbësore të njeriut. Do të ishte gabim të mendohet se mu në këtë qëndron tragjedia e tij. Zoti nuk e ka demantuar kundërshtimin e melaqeve në dialogun e mirënjohur me ta, që njeriu do të shkaktonte huti dhe do derdhte gjak, por, megjithatë, i është dhënë përparësi dhe i është besuar udhëheqja mbi tërë botën e shfaqur.

Në njeriun, që nga lashtësia zhvillohet beteja midis elementeve shtazore dhe atyre më të larta shpirtërore. Njeriu, ashtu siç thotë Kurani dhe si e vërteton realiteti, është krijuar nga materia dhe shpirti. Në fazën e tanishme të zhvillimit të tij, elementi shtazor ende është shumë i theksuar dhe mbizotërues.

Qëllimi themelor i Islamit është forcimi i elementit shpirtëror, frenimi i instinkteve shtazore dhe krijimi i ekuilibrit midis nevojave materiale dhe shpirtërore, përkatësisht nevojave të trupit dhe shpirtit, ekzistencës fizike dhe shpirtërore. Ky është, në të vërtetë, kuptimi thelbësor i gjithë zhvillimit njerëzor. Në esencë, ai shpie në të gjitha përpjekjet dhe sferat në një qëllim të vetëm: njerëzishmen e njeriut, krijimi i kushteve për zhvillimin e shpejtë dhe afirmimin e elementeve njerëzore, për shpejtimin e procesit të largimit të tjetërsimit të tij.

Është më se e qartë se Islami i ka drejtuar të gjitha mësimet e tij drejt procesit të humanizmit dhe njerëzishmen e njeriut. Të gjitha rregullat e tij e çojnë në atë qëllim themelor.

Çfarë nënkupton Islami me njerëzishmen e njeriut, si manifestohet në praktikë dhe si realizohet më së miri, mendojmë se do të na përgjigjet kuptimi i rregullave të agjërimit.

Le të themi së pari se thelbi i njerëzishmes të njeriut qëndron në ndërgjegjen ndaj tjetrit dhe në raport me të.

Sa është kjo vetëdije e zhvilluar, sa shumë ajo manifestohet në raport me tjetrin, aq njeriu vërtetohet si një njeri, aq është i njerëzishëm. Marrëdhëniet ndër njerëzore paraqesin fushë të vetme të shprehjes dhe afirmimit të tij njerëzor dhe të vërtetësisë. Aty ai e gjen veten dhe çlirimin e tij të plotë nga tjetërsimi. Roli i Ramazanit dhe i agjërimit në procesin e gjetjes së vetvetes, në vërtetimin e tij si njeri në raport ndaj

të tjerëve, që, siç e kemi theksuar tashmë, paraqet kuptimin thelbësor të ekzistencës njerëzore, me të vërtetë është vlerë e paçmueshme.

Ramazani është një muaj i freskimit shpirtëror, rilindjes dhe ngritjes së tij. Ky është një moment kaq i domosdoshëm dhe i këndshëm kur i kthehemi vetes, përjetojmë dhe hyjmë në një botë më të lartë të çliruar nga gjithçka e ulët, egoiste dhe shtazore. Agjërimi na çon në atë botën më të mirë dhe më të lartë, në të cilën vjen në shprehje ajo njerëzorja në ne, në të cilin ne hapemi ndaj të tjerëve, mendojmë për ta dhe për detyrimet tona ndaj tyre. Agjërimi është, para së gjithash, një masë shumë e efektshme në fushën e zbehjes dhe frenimit të instinkteve shtazore të njeriut, duke i zvogëluar ato në masën e tyre të vërtetë dhe duke arritur ekuilibrin e nevojshëm midis elementeve njerëzore dhe shtazore. Agjërimi pastaj na hap karshi të tjerëve, duke zhvilluar te ne ndenjen e solidaritetit shoqëror.

Ramazani paraqet një mundësi unike për qetësi shpirtërore. Duhet të kuptohet vetëm ashtu dhe vërtet ashtu të përjetohet. Rëndësinë e tij në këtë drejtim më së miri na e vërteton fakti që në të është shpallur Kurani si burim i transformimit shpirtëror, i cili me të vërtetë ka hapur një proces të fuqishëm në njerëzishmen e njeriut dhe rilindjes shpirtërore të tij. Ishte momenti vendimtar në zhvillimin e mendjes njerëzore. Ishte një "natë fati" (Lejlei-kadr), për të cilën Kurani thotë se është më e vlefshme dhe më e mira nga njëmuaj muaj (hajrun min elfi shahrin). Në këtë natë të bekuar, çdo vjet në tokë derdhet mëshira e Zotit, zbrasin melaqet e fuqizuara me Frymën e Zotit, duke u dhënë njerëzve një mundësi të veçantë që të paktën në një çast të transferohen në botën më të lartë, që të lehtësohen nga presionet e epsheve dhe të pasioneve që shpesh i tërheqin në mëkatet të mëdha, duke mohuar në këtë mënyrë dhe duke e tjetërsuar veten si njeri.



Ajo është një natë e kthimit dhe gjetjes së njeriut

Kjo natë, si gjithë muaji Ramazan, është gjithmonë e mirëpritur si vërejtje dhe paralajmërim. Ne shpesh harrojmë detyrimet tona njerëzore, misionin tonë, i nënshtrohemi pasioneve dhe mbyllemi në interesat tona të ngushta materiale. Bëhemi robër të materies. Ramazani na inkurajon, na zgjon dhe i thërret vetes që ti kthehemi vetvetes (le'al-lekum tet-tekune).

Shprehja e devotshmërisë, e me çka Kurani e motivoi përshkrimin e detyrimeve të agjëritit (Kutibe 'alejkumu-s-sijam ... le'al-lekum tet-tekune), nuk bëhet vetëm me fjalë, siç mendojnë gabimisht shumë njerëz, dhe për shkak të këtij, në Ramazan forcohet ibadati verbal në formën e dhikrit, leximit të Kuranit, adhurimi, dëgjimi i mukabelës, etj.. Ky konceptim i gabuar i përkushtimit dhe i devotshmërisë në përgjithësi ka mbetur një trashëgimi e ndryshkur nga periudha e dekadencës, kur ibadeti është ulur në formalizëm të thjeshtë dhe kur u morën të gjithë elementët e veprimtarisë. Ajo ishte një frikë-respekt i rrejtshëm dhe boshe. Nuk ka devotshëri pa vepra. Devotshmëria e vërtetë manifestohet, konfirmohet dhe vërtetohet në vepër.

Devotshmëria që e ka përmbajtjen dhe domethënien e agjëritit më së paku vërtetohet me përmbajtje nga ngrenia, pirja dhe kënaqësitë e tjera

trupore. Agjërimi në kuptimin kuranor (le'al-lekum tet-tekune) nuk do të thotë uri. Kush në agjërim sheh dhe përjeton vetëm uri dhe etje, ai badihava ka agjëruar. Një agjërim i tillë nuk do të pranohet dhe nuk do të shpërblehet. Përkundrazi, ai largon nga mëshira e Zotit (hadith).

Duke shprehur të gjitha këto me gjuhën e nevojave aktuale të jetës fetare, duhet thënë që përkushtimi dhe devotshmëria e Ramazanit duhet të pasqyrohet, vërtetohet dhe të dëshmohet me pjesëmarrje aktive në aksionet që i organizon Bashkësia Islame dhe nga të cilat në masë të madhe varet zhvillimi i jetës sonë fetare. Agjërimi, për të cilin thamë, që na hap karshi të tjerëve, liron nga mbyllja egoiste në interesa të ngushta vetjake dhe na paralajmëron për detyrimet ndaj të tjerëve dhe të shoqërisë, dhe duhet si i tillë të dëshmohet në aktivitetet tona dhe në veprimet e përditshme.

Është e qartë se anëtarët e Bashkësisë Islame e kuptojnë mirë këtë si dhe nuk do ta humbasin këtë shans. Ata tashmë janë dëshmuar se kanë përmbushur detyrat të vëna nga historia.

Ramazani në ardhje ka një rëndësi të veçantë në këtë drejtim. Mund të thuhet, deri diku, paraqet një provë. Padyshim, që në të aksioni i mbledhjes së zekatit, sadekatu-l-fitrut dhe dhënies së tjetër vullnetare, hyn në një fazë vendimtare.

Marr nga "Preporod:" VI. nr. 120, fq. 1.

Përkthehu: Shaban Basha

Abdulhamid Mahmud Tuhmaz

Agjërimi

Përmes nijetit ibadeti dallon nga zakoni, ndërsa nijeti është vendim i fortë i zemrës për të agjëruar.

Definicioni i agjërimit (savm-it)

Domethënia filologjike e fjalës savm është: të përmbajturit e përgjithshëm.

Në këtë kuptim janë fjalët e Merjemes: “Unë jam betuar për heshtje, andaj sot nuk do të flas me asnjë njeri.”¹

Por edhe vargjet e poetëve: “Kalorësia e cila ha dhe kalorësia e cila nuk ha, njëra është në furtunë, kurse tjetra kafshon frerët.”

Domethënia terminologjike e fjalës savm është: të përmbajturit me vetëdije (me nijet) realisht ose formalisht (juridikisht)² nga çdo gjë që e prish agjërimit, gjatë tërë ditës, prej agimit deri te perëndimi i diellit.

Agimi i vërtetë (el-fexhrus-sadik)

Ky është agimi, i cili është përhapur gjithandej në horizont, kurse drita e tij është shtrirë në skajet e qiellit. Paraqitet dymbëdhjetë minuta pas agimit të rremë. Agimi i rremë (el-fexhrul-kadhib) së pari paraqitet si rreze e zgjatur drejtvizore, si bisht i ujkut, pastaj tretet dhe pason errësira. Koha e namazit të sabahut dhe fillimi i agjërimit fillojnë me paraqitjen e agimit të vërtetë. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Mos e lini sehurin për shkak të ezanit të Bilallit as zgjatjes së agimit, porse për shkak të agimit i cili e mbulon horizontin”³.

Agjëruesi i përmbahet kohës së vendit në të cilin ndodhet gjatë agimit dhe perëndimit të diellit. Nëse ndodhet në një vend të lartë, nuk duhet të bëjë iftar gjersa dielli të perëndojë atje.

Bilalli thërriste ezan natën për ta paralajmëruar afrimin e agimit, në mënyrë që të çlodheshin ata që faleshin dhe të zgjoheshin ata që kishin fjetur, për t'u përgatitur për namazin e sabahut. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Vërtet Bilalli e thërret ezanin natën, kurse ju hani e pini gjersa të mos e thërrasë ezanin Ibën Umi Mektumi”⁴.

Kurse Allahu i Madhëruar thotë: “...hani e pinin derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim...”⁵

Me perëndimin e diellit mendohet në kohën e perëndimit të diskut diellor, ashtu që dukshëm paraqitet errësira në anën lindore. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kur nga errësira (nga lindja) arrin nata, kurse

dita shkon atje (në perëndim) dhe kur dielli perëndon, atëherë agjëruesi mund të bëjë iftar.”⁶

Do të thotë, paraqitet koha e iftarit, atëherë agjëruesi në planin formalo-juridik është pa agjërimit, ngase nata nuk është kohë e agjërimit. Allahu i Madhëruar ka thënë: “Pastaj agjërimitin plotësojeni deri në mbrëmje...”⁷

Agjëruesi i përmbahet kohës së vendit në të cilin ndodhet gjatë agimit dhe perëndimit të diellit. Nëse ndodhet në një vend të lartë, nuk duhet të bëjë iftar gjersa dielli të perëndojë atje. E nëse e fillon agjërimitin në një vend, e pastaj merr rrugë, iftar duhet të bëjë në vendin në të cilin e zë perëndimi i diellit. Në viset që janë afër polit të Veriut dhe të Jugut, ku agimi paraqitet gjatë perëndimit të diellit, ose pas tij, për një kohë të shkurtër në të cilën agjëruesi mund të hajë mjaft për ta mbajtur trupin dhe për ta ruajtur jetën, është i detyruar të agjërojë sipas llogarisë së vet. A u llogaritet agjëruesve nata sipas vendit më të afërt, siç pohojnë shafitët, ose llogaritet koha, e cila mjafton për të ngrënë dhe pirë, ose ata janë të obliguar vetëm ta kompensojnë, por jo edhe ta kryejnë atë (agjërimitin)⁸. Ajo që unë e konsideroj të drejtë është në pajtim me shafitët. Kjo është që nata të caktohet sipas vendit më të afërt të tyre, ku ka ditë dhe natë, ndërsa kjo dispozitë aplikohet edhe për vendet në pole në të cilat dita dhe nata zgjasin nga gjashtë muaj.

Me rastin e shqyrtimit të caktimit të kohës së namazit e kemi theksuar dispozitën e atyre që banojnë në veriun e skajshëm ose jugun e skajshëm, afër poleve të tokës, ku nata nuk ekziston fare. Ata janë të obliguar ta caktojnë në çdo njëzetekatër orë kohën e pesë namazeve ditore. Siç theksohet në hadithin për dexhallin.

“Thamë: ‘Sa mbetet në tokë?’ Ai u përgjigj: Dyzet ditë; ditë si viti, ditë si muaji, ditë si java, ndërsa ditët tjera si ditët tuaja. Pastaj i thanë: ‘O i Dërguar i Allahut, a mjafton në këtë ditë që zgjat sa një vit të kryhet vetëm namazi ditor?’ Jo, caktojeni vetë.”⁹

Kushtet për pranimin e agjërimit

1) Nijeti (vendimi) në kohën e tij, për çdo ditë

Përmes nijetit ibadeti dallon nga zakoni, ndërsa nijeti është vendim i fortë i zemrës për të agjëruar. Dijetarët pohojnë se nijeti është mirë të deklarohet me gjuhë, për shkak të detyrimeve të shumta në kohën tonë. Kusht për vlerën e nijetit është që të

këmbëngulet në të, andaj, nëse dikush heq dorë para agimit nga qëllimi për agjërime, nuk llogaritet agjërues. Lejohet të hiqet dorë nga nijeti në të gjitha llojet e agjërimit, ndërkaq nëse dikush e përsërit nijetin gjersa ende ka kohë për të, agjërime tij është i vlershëm.

Sipas medhhebit tonë, nijeti është i obliguar për çdo ditë të ramazanit, ndërsa te Zuberi, nxënësi i Ebu Hanifes dhe tek imam Maliku lejohet një nijet për gjithë muajin.

Vetë sehuri (ngrënia para agimit) në ramazan është nijet, por gjithashtu edhe nëse bëhet sehur për agjërime edhe në ndonjë muaj tjetër jashtë ramazanit. Kushtëzimi (gjegjësisht fjala “Nëse do Allahu”) nuk e prish nijetin, siç është deklarimi: “Nesër do të agjëroj, nëse do Zoti”. Kjo ngase ka të bëjë me kërkimin ndihmë nga Allahu dhe jo për kushtëzim të vërtetë.¹⁰

Te nijeti është kusht që agjëruesi të jetë i vetëdijshëm për agjërime. Tek agjërime ku kërkohet caktimi i kategorisë së tij, duhet që agjëruesi të dijë ta caktojë atë, për çka do të bëhet fjalë më vonë...

Koha e nijetit

Për agjërime të muajit të Ramazanit, agjërime për cilin është dhënë betimi se do të agjërohet në kohë të caktuar¹¹ dhe agjërime vullnetar koha e nijetit është prej fillimit të natës së ditës që do të agjërohet e deri në gjysmën e kësaj “dite sipas Sheriatit”. Dita, sipas Sheriatit, fillon prej agimit, ndërsa përfundon me perëndimin e diellit, andaj gjysma e ditës është në pjesën e fundit të mëngjesit, respektivisht afërsisht një orë para kohës së drekës. Nëse dikush bën nijet para kësaj kohe, nijeti i tij është i drejtë, me kusht që agjërime ta bëjë nijet nga fillimi i ditës, gjegjësisht prej agimit, dhe që para nijetit të mos ketë bërë diç që e prish agjërime, siç është të ngrënë ushqim, të pirët, apo marrëdhënie seksuale, qëllimisht, ose nga harresa. Nëse e ka bërë ndonjë prej këtyre veprimeve pas agimit, agjërime nuk është i drejtë¹². Ekziston mendimi sipas cilit agjërime është i drejtë, nëse kjo bëhet para nijetit nga harresa edhe atë tek agjërime të muajit të ramazanit dhe agjërime të betuar. Këtë mendim e ka konfirmuar



dijetari Ibën Abidini, autor i veprës së njohur Hashijetu redil-muhtar.

Nëse bën nijet për agjërim prej momentit kur e ka bërë atë nijet, e kjo është pas agimit, ai nuk është agjërues.

Te këto tri lloje të agjërimin, e të tilla janë agjërimi i muajit të ramazanit, agjërimi betues ditën e caktuar dhe agjërimi vullnetar, është e drejtë të bëhet nijet pa caktim nëse ky agjërim është farz apo sunet, ndonëse është më mirë të përkufizohet me çfarë lloji të agjërimin ka të bëjë nijeti.

Gjithashtu është e drejtë që për ndonjërin prej këtyre tri llojeve të agjërimin të bëhet nijet si agjërim vullnetar, madje edhe nëse agjëruesi është udhëtar ose i sëmurë, për shkak të ekzistimit të tjetrit. Meqë në ramazan nuk është lënë të agjërohet ndonjë agjërim tjetër, ai agjërim është caktuar si farz, ndërsa ajo që është caktuar nuk ka nevojë të caktohet rihatas¹³.

Kjo është në rastin kur në muajin ramazan bëhet nijet agjërimi vullnetar. E nëse bëhet nijet në ramazan për ndonjë agjërim tjetër që është vaxhib, të sëmurit i numërohet si agjërim i ramazanit, gjersa udhëtarit do t'i numërohet si agjërim për të cilin edhe ka bërë nijet, kurse ai e ka obligim ta kompensojë agjërimin e ramazanit. Kjo për arsye se udhëtarit i lejohet të prishë dhe të agjërojë ndonjë lloj tjetër të agjërimin, ngase lehtësimi i prishjes është lidhur me supozimin e pamundësisë së agjërimin, për shkak të situatës që e vështirëson, gjë që edhe është udhëtimi. Këtë supozim e plotëson udhëtarit, për dallim nga i sëmurit, tek i cili ka lehtësim lidhur me pamundësinë reale të agjërimin. Nëse i sëmurit agjëron, do të dëshmohej se është i aftë për këtë¹⁴.

Nëse këtë e bën tek agjërimi për të cilin është betuar se do ta agjërojë ditën e caktuar, do t'i numërohet si agjërim të cilin e ka bërë nijet, pavarësisht nëse është i shëndoshë, i sëmurë udhëtar, apo në shtëpi, me kusht që është i obliguar ta

Agjëruesi nuk do të prishë vetëm me nijetin për të prishur, por vetëm pasi ta ketë prishur vërtetë

kompensojë atë agjërim betues, sipas mendimit më të drejtë¹⁵.

Kur dikush në ramazan bën nijet për namaz vullnetar, prej kësaj nuk del se bëhet jobesimtar, ngase nuk ka varshmëri ndërmjet nijetit për agjërim vullnetar dhe besimit se agjërimi i ramazanit nuk është farz. Mund të ndodhë të besojë se ky është farz, por të bëjë nijet për agjërim vullnetar. Mirëpo, nëse nijetit për agjërim vullnetar i shtohet bindja se agjërimi i ramazanit është vullnetar (nafle), ose mendimi se është kështu, në këtë rast ai bëhet jobesimtar¹⁶.

Për llojet e tjera të agjërimin është kusht që nijeti të bëhet natën ose paralelisht me paraqitjen e agimit dhe që ta caktojë cilin lloj të agjërimin e bën nijet.

Këto lloje të agjërimin janë: kompensimi i ramazanit, agjërimi i përgjithshëm betues,¹⁷ kompensimi i agjërimin vullnetar të prishur me diçka, kompensimi i agjërimin për të cilin përbetohet që do të agjërohet ditën e caktuar dhe agjërimi i kefaretit.¹⁸ Andaj, nëse bëhet nijet ndonjëri prej këtyre llojeve të agjërimin gjatë ditës, ai agjërim bëhet vullnetar dhe është mirë të përmbushet. E nëse gjatë ditës prishet, nuk është obligim të kompensohet, pos nëse vetë ai nuk është kompensim (savmul-kada'). Kjo ngase ai është agjërim me kualifikim shtesë, e ai është "kompensim" dhe në këtë rast e ka humbur kushtin e validitetit të këtij kualifikimi dhe do të mbetej ai lloj për të cilin është bërë nijet, gjegjësisht agjërim vullnetar.¹⁹

Nëse dikush konsideron se është i obliguar ta agjërojë një ditë dhe e

fillon agjërimin me të gjitha kushtet, ndërsa pastaj konfirmon se nuk ka qenë i obliguar ta kompensojë, nuk obligohet ta përmbushë atë agjërim, ngase e ka filluar për obligim ta bëjë këtë dhe kjo i arsyetohet me harresë. Ai këtë ditë nuk është i obliguar ta kompensojë, nëse agjërimin e ndërpret menjëherë pasi e ka kuptuar që nuk ka obligim të kompensimit, e nëse nuk e ndërpret menjëherë, bëhet obligim, andaj nuk i lejohet ta ndërpresë. Nëse do ta bënte këtë, duhet ta kompensojë.²⁰ Nuk është i drejtë nijeti, në të cilin personi është i pavendosur nëse duhet të agjërojë nesër apo jo. Shembull është kur dikush bën nijet që nuk do të agjërojë nesër nëse e ftojnë në gosti dhe se do të agjërojë nëse nuk e ftojnë. Me këtë nijet personi nuk bëhet agjërues. Gjithashtu, nuk është agjërues nëse agon në ramazan dhe nuk ka bërë nijet as që do të agjërojë as që do të prishë.

Agjëruesi nuk do të prishë vetëm me nijetin për të prishur, por vetëm pasi ta ketë prishur vërtetë, ndonëse Shafiu (Allahu e mëshiroftë) ka mendim të kundërt.

Nëse dikush ka borxh t'i kompensojë dy ditë nga një ramazan ose nga dy ramazana, dhe dëshiron ta bëjë këtë, do të bëjë nijet agjërimin e ditës së parë prej dyve që duhet t'i kompensojë, por mjafton edhe nëse nuk e bën këtë.²¹

Nëse dikush e braktis islamit - ruana Zot - pastaj kthehet sërish dhe bën nijet para pjesës së fundit të mëngjesit, do të jetë agjërues. Nëse prish, duhet ta kompensojë, ndërkaq që nuk është i detyruar të bëjë kefaret.²²

2) Të mos ekzistojë diç që është në kundërshtim me agjërimin, si hajdi apo nifasi

Femra, e cila është me hajd ose nifas gjatë ramazanit, nuk është e detyruar të agjërojë dhe ajo sipas Sheriatit nuk është agjërues. Ndalohet që femra me hajd ose nifas të përmbahet nga ajo që e prish agjërimin, ngase asaj i ndalohet agjërimi. Ndërsa kryerja e diçkaje që i ngjan



haramit është vetë harami.²³ Femra është e detyruar ta kompensojë numrin e ditëve që i ka lëshuar gjersa ka qenë me hajd apo nifas.

Një grup transmetuesish nga Aishja r.a. transmetojnë të ketë deklaruar: “Na ndodhte kjo (d.m.th., hajdi) andaj na është urdhëruar ta kompensojmë agjërimin, por nuk na është urdhëruar ta kompensojmë namazin.”

Dallimi ndërmjet agjërimit dhe namazit është në atë që namazi shpesh përsëritet, andaj është shumë vështirë të kompensohet, ndërsa agjërimi nuk përsëritet, andaj nuk është vështirë të kompensohet.

Nuk është i drejtë agjërimi i femrës gjersa ndodhet në hajd apo nifas, pavarësisht nëse ai agjërim është farz apo nafle. E nëse është agjëruese dhe vëren gjak pak para perëndimit të diellit, agjërimi i asaj dite është prishur dhe ajo duhet ta kompensojë, pavarësisht nëse ka qenë farz apo nafle. Farzin duhet të kompensojë për shkak se ai nuk është i drejtë, kurse nafilen për faktin se është obliguar me fillim, ndërsa është prishur para se të përmushej.

A kushtëzohet për vlefshmërinë e agjërimit pastrimi i gruas pas përfundimit të ciklit menstrual apo të lehonisë- hajdit dhe nifasit? Për vlefshmërinë e agjërimit kjo nuk kushtëzohet, por ajo do të llogaritet mëkatore, nëse nuk do të pastrohet, menjëherë pas ndërprerjes së ciklit, për shkak të shtyrjes së namazit (deri në kalim të kohës).²⁴

Duhet ditur që koha e cila mjafton për larje-gysl, pastaj për sigurimin e ujit, ndërrimin e rrobave, edhe ajo llogaritet brenda vet periudhës së ciklit menstrual- hajdit dhe brenda vet periudhës së lehonisë- nifasit, kushtimisht nëse gjaku i hajdit është ndërprerë para kalimit të afatit maksimal, i cili është dhjetë ditë, apo edhe te lehonia-nifasi nëse ndërpritet rrjedhja e gjakut para kalimit të afatit maksimal e cila është prej dyzet ditësh.

Prandaj, nëse gjaku i hajdit pushon të rrjedhë para kalimit të ditës së dhjetë (që është afati maksimal i ciklit) edhe madje para agimit në Ramazan, për aq kohë sa i mjafton gruas për t'u larë dhe për ta filluar namazin duke marrë tekbinin fillestar “Allahu ekber”, pra femra e tillë është e detyruar ta agjërojë atë ditë. Nëse kjo periudhë kohore (pra e ndërprerjes së ciklit para agimit në Ramazan) nuk mjafton për këto veprime, agjërimi i saj nuk është i pranueshëm-ligjshëm. Nëse agjëron, agjërimi i saj nuk do të ishte i ligjshëm-vlefshëm dhe ajo do të duhej ta kompensonte. E nëse gjaku pushon të rrjedhë pas plotësimit të ditës së dhjetë (që ishte maksimumi i kohëzgjatjes së ciklit), qoftë edhe vetëm për një çast para agimit, femra është e detyruar ta agjërojë atë ditë dhe agjërimi i saj është i ligjshëm për shkak se cikli i saj është ndërprerë më herë, ngase dihet se ai- hajdi nuk zgjat më shumë se dhjetë ditë. (maksimumi)²⁴

Këtu është me rëndësi të theksohet që vlefshmëria e agjërimin nuk kushtëzohet që personi të mos jetë xhunub (i papastër) qoftë edhe nëse ka mundur të pastrohet. Këtë e konfirmon hadithi që e transmeton Buhariu nga Aishja r.a., e cila kishte deklaruar: “Të Dërguarin a.s. e zinte agimi, gjersa ishte xhunub (nga marrëdhënia me gratë e veta), por pastaj lahej dhe agjëronte.”

Nëse dikush qëndron xhunub aq gjatë sa t'i kalojë koha e namazit, ai do të jetë mëkatar për shkak të lëshimit të namazit dhe për shkak të shtyrjes së tij. Ndërsa lëshimi i namazit ose shtyrja e tij mund të bëhet shkak që agjëruesi të mos shpërblehet për agjërimin e tij, ose nga shkak që të mos pranohet devotshmëria e tij. Allahu i Madhëruar thotë: “Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve”²⁵

Ndërsa ai që e lëshon namazin nuk mund të jetë nga të sinqertët, ngase namazi është shtyllë e fesë. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kush e lëshon namazin e iqindisë i kanë dështuar të gjitha veprat.”²⁶

3) Të mos ndodhë diç që e prish agjërimin.

Përktheu: Dr. Selim Sulejmani

1. Merjem, 26. 2. Shembull i përmbajtjes juridikisht është kur personi ha diç si pasojë e harresës gjatë agjërimin. Ai juridikisht është agjërues, në bazë të dispozitës së Ligjvënësist, sipas së cilës agjërimi i personit, i cili ka ngrënë nga harresa, nuk është i prishur. 3. E transmetojnë Muslimi dhe Tirmidhiu. Për më shumë shih: Reddul-muhtar. 4. E transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, nga Aishja r.a.. I Dërguari i Allahut a.s. i kishte dy muezinë: Bilallin dhe Ibn Umi Mektumin, i cili ishte i verbër. 5. El - Bekare, 187. 6. E transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, nga Omeri r.a.. 7. El - Bekare, 187. 8. Më shumë shih: Reddul-muhtar. 9. E transmeton Buhariu në Sahihun e tij, 538. 10. Merakil-felah. 11. Si kur deklarohet: “Obligohem, në emër të Allahut, ta agjëroj të enjten e ardhshme!” 12. El-Fetava el-hindije. 13. Për më shumë shih: Hashijetut-Tahtavi alet-meraki. 14. Më shumë shih: Reddul-muhtar. 15. Më shumë shih: Reddul-muhtar dhe Ed-durrul-muhtar. 16. Hashijetut-Tahtavi. 17. Si në rastin kur deklarohet: “Obligohem, në emër të Allahut, që ta agjëroj një ditë”. 18. Sqarimi i tij do të paraqitet në kaptinën “Llojet e agjërimin”. 19. Më shumë shih: Takriratur-rafi’ala hashijeti Ibn Abidin. 20. Më shumë shih: El-Hedijetut-ala’ije. 21. Më shumë shih: Fetava Kadi Han. 22. Po aty. 23. Më shumë shih: El-Tahtavi alet-meraki. 24. Më shumë shih: Irshadun-nas ila ahkamil-hajdi ven-nifas. 25. El - Maide, 27. 26. E transmetojnë Buhariu dhe Nesaiu.

Nexhmi Hoxha

Agjërimi i të Dërguarit a.s.

Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik na urdhëron dhe na mëson se pasimi i të Dërguarit të Tij është rruga e vetme e shpëtimit në këtë dhe botën tjetër: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.” (El-Ahzab, 21).

S'ka dyshim se veprimet, sjelljet, qëndrimet, fjalët dhe punët e Pejgamberit a.s. duhet të jenë motivi dhe udhërrëfyesi ynë në këtë jetë. Ajo që na është urdhëruar nga ai a.s., ne duhet ta ndjekim dhe ta veprojmë, ngase kështu na porosinë edhe Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik: “...Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frikë Allahun, se Allahu është ndëshkues i ashpër.” (El-Hashr, 7).

Jeta fisnike e të Dërguarit a.s., si dhe kryerja e ibadeteve nga ana e tij janë mësimet më të mira se si duhet jetuar ne jetën tonë. Se agjërimi ishte ndër ibadetet më fisnike të Pejgamberit a.s. na e mëson edhe hadithi i burrit nga Nexhdi, kur erdhi te Pejgamberi a.s. dhe donte të mësonte se ç’është Islami, e Pejgamberi a.s. i

tha: “Të falësh pesë kohët e namazit në ditë.” Përveç këtyre, a ka ndonjë namaz tjetër që duhet ta fal? “Jo, por nëse dëshiron mund të falësh namaz nafile. Gjithashtu ta agjërosh muajin Ramazan.” Përveç këtij, a ka ndonjë agjërimit tjetër që më obligohet? “Jo, por nëse dëshiron mund të agjërosh vullnetarisht.” Pastaj Pejgamberi ynë i foli edhe në lidhje me zekatin. Ndërsa ai e pyeti përsëri: Përveç kësaj, a kam diçka tjetër që duhet të japë? I Dërguari i Allahut a.s. i përgjigjet: “Jo, por nëse dëshiron mund të japësh sadaka.” Ky njeri u nda nga i Dërguari a.s. duke deklaruar: “Pasha Allahun, nuk do të bëj as më tepër as më pak se këto që dëgjova.” Me këtë rast, Pejgamberi a.s. tha: “Ka shpëtuar nëse qëndron në fjalë.”¹

Agjërimi i Ramazanit nga Pejgamberi a.s.

Agjërimi i muajit Ramazan është obligim: “O ju që keni besuar, u është bërë obligim agjërimi sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më e mirë për të. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju.”

(El-Bekare, 183-184). Ai është bërë obligim në vitin e dytë hixhrij.

Jeta e Pejgamberit a.s. karakterizohet me veti dhe cilësi të mrekullueshme. Ai gjatë tërë jetës së tij ishte bujar, zemërgjerë dhe solidar me të gjithë, por kur hynte muaji Ramazan, këto cilësi sikur shtoheshin edhe më shumë gjatë këtij muaji. Ekzistojnë shumë thënie në të cilat është shënuar se Pejgamberi a.s., gjatë muajit Ramazan, bënte më shumë vepra të mira, u ndihmonte të varfërve, lexonte më shumë Kuran, falej më shumë, e përmendte Allahun më shumë, si dhe vetmohej për të bërë ibadete dhe për të medituar rreth mëshirës së Zotit të tij. Nëse vështrojmë me kujdes jetëshkrimin e tij, e shohim se gjatë Ramazanit, udhëtimet e tij ishin më të rralla, kjo sikur dëshmon se përkushtimi gjatë këtij muaji ishte edhe më i madh, ani pse edhe udhëtimi i tij dihet mirëfilli se ka qenë një ibadet. Por, edhe kur udhëtonte, ai agjëronte, por nganjëherë edhe e ndërpriste agjërimit, për të na bërë të ditur edhe neve se një gjë e tillë është e lejuar, bazuar në ajetin kuranor: “...e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë...” (El-Bekare, 184).

Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi a.s. është shembulli ynë më i mirë për mënyrën e plotë të adhurimit të Allahut xh.sh., e ai këtë e bënte më së miri gjatë muajit Ramazan, sidomos gjatë netëve të këtij muaji. Ai i kalonte netët e Ramazanit duke bërë ibadet, e duke shtuar namazin e natës me përlulësi e me nënshtrim. Ai

Pejgamberi a.s. gjatë tërë jetës së tij ishte bujar, zemërgjerë dhe solidar me të gjithë, por kur hynte muaji Ramazan, këto cilësi sikur shtoheshin edhe më shumë gjatë këtij muaji.

porosiste edhe shokët e tij duke iu thënë: “Kush falet në Ramazan me besim dhe vetëllogari, do t’i falen mëkatet e mëparshme.”² Namazet e gjata në thellësi të natës ishin energjia më e madhe e Pejgamberit a.s. që dëshironte ta ndryshonte botën dhe ta bënte një vend më të mirë për të jetuar. Pikërisht këto momente janë përshkruar përgjithmonë në suren El-Muzemil, ku Allahu xh.sh. ka thënë: “O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë, sepse Ne do të të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë...” (El-Muzemil, 1-5)

Gjatë ditëve të Ramazanit, Pejgamberi a.s. vazhdonte misionin e tij fisnik, atë të thirrjes në Islam, por edhe bërjen e veprave të bamirësisë dhe të dobishme. Ndër këshillat që Pejgamberi a.s. ua thoshte shokëve të tij, e nëpërmes tyre edhe neve sot, ishte edhe që të zgjohen para agimit dhe të hanë ushqim para syfyr, kjo ngase atë e cilësonte si një kohë të bereqetshme, kohë të afërsisë së Allahut dhe kohë të faljes. “Çohuni në syfyr, ngase në syfyr ka bereqet.”³

Fundi i Ramazanit e gjente Muhamedin a.s. edhe më të përkushtuar

dhe më të dhënë pas ibadeteve. Ai tërhoq në vetmi, në vetëizolim nga bota, gjegjësisht fillonte itikafin, me të vetmin qëllim, kërkimin e natës së madhe të Kadrit. Aisheja r.a. rrëfen dhe tregon se: “Pejgamberi a.s. gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit qëndronte në itikaf, derisa i kishte ardhur vdekja.” Ai gjatë këtyre netëve zgjonte anëtarët e familjes së tij dhe kërkonte nga ta që ta shtonin adhurimin dhe t’i shtonin duatë, lutjet për falje nga Allahu. Aisheja r.a. tregon se: “Kur vinte dhjetësi i fundit i Ramazanit, Pejgamberi a.s. i ngjallte netët (me ibadete), zgjonte familjen e tij prej gjumi, përpiquej (për ibadete të shumta) dhe shtrëngohej (për ibadete), si dhe largohej nga marrëdhëniet intime me gratë e veta.”⁴

Agjërime për të cilat nxiti Pejgamberi a.s.

Kurani fisnik na rrëfen tregime se edhe popujt e mëhershëm kanë pasur obligim agjërimitin “O ju që keni besuar, u është bërë obligim agjërimit, ashtu siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush...” (El-Bekare, 183), pa çka që agjërimiti ka qenë dhe do të mbetet një adhurim i lashtë i

Historiku islam e njeh agjërimitin e ditës së Ashurës si një prej agjërimeve të para që ka praktikuar Pejgamberi a.s. dhe myslimanët në përgjithësi.

pazëvendësueshëm. Është e pakontestueshme obligueshmëria e agjërimit në muajin Ramazan, por kjo nuk do të thotë se jashtë këtij muaji, agjërimiti është i ndaluar apo që nuk është i pëlqyer, me përjashtim të dy ditëve të Bajrameve, kur ndalohet agjërimiti, si dhe në ditët e teshrikut, kur është i papëlqyeshëm agjërimiti. Krahas këtyre, Pejgamberi a.s. na ka mësuar dhe ka praktikuar edhe agjërime të ditëve të tjera, të cilat do t’i përmendim më poshtë.

Agjërimiti i ditës së Ashurës

Historiku islam e njeh agjërimitin e ditës së Ashurës si një prej agjërimeve



të para që ka praktikuar Pejgamberi a.s. dhe myslimanët në përgjithësi.⁵ Agjërimi i kësaj dite duket të ketë qenë traditë e kahershme, që nga koha e Ibrahimit a.s., ngase, bazuar në rrëfimin e Aishes r.a. kurejshët e kishin zakon të agjëronin ditën e Ashurës edhe para Islamit. Edhe Pejgamberi a.s. e agjëronte atë ditë.

Me migrimin e Pejgamberit a.s. nga Meka në Medine, aty gjeti hebrenjtë e Medinës duke e agjëruar ditën e dhjetë të muajit Muharrem, e njohur si dita e Ashurës. Ata e konsideronin këtë si një ditë feste, andaj edhe e madhëronin me agjërim. Ibën Abasi r.a. tregon se Pejgamberi a.s. kur shkoi në Medine i gjeti hebrenjtë duke agjëruar ditën e Ashurës. Ai iu tha: “Për çfarë e bëni këtë agjërim?” Ata i thanë: “Është një ditë e madhe, se Allahu e shpëtoi Musain dhe fiset e Izraelit nga armiqtë e tyre në këtë ditë, prandaj edhe Musai ka agjëruar në këtë ditë.” Pejgamberi a.s. u tha: “Ne kemi më shumë të drejta te

Nga fjalët e Pejgamberit a.s., personi që e agjëron muajin Ramazan dhe e pason atë edhe me gjashtë ditë të muajit Sheval, e ka shpërblimin sikur të ketë agjëruar tërë vitin.

Musai se ju.” Kështu ai agjëroi dhe i urdhëroi njerëzit të agjërojnë atë ditë.⁶ Pejgamberi a.s. i urdhëroi nje-rëzit që ta agjëronin këtë ditë, derisa erdhi urdhri për ta agjëruar

muajin Ramazan, më pastaj ai tha: “Kush dëshiron mund ta agjërojë ditën e Ashurës dhe kush do mund ta lërë atë.”⁷

Nga rrëfimi i Ibën Abasit na bëhet e ditur se shokët e Pejgamberit a.s. kur u urdhëruan të agjëronin ditën e Ashurës, i thanë Pejgamberit a.s.: “O i Dërguari i Allahut! Kjo është dita që e nderojnë hebrenjtë dhe të krishterët.” Pejgamberi a.s. iu tha: “Kur të vjen viti tjetër, në dashtë Allahu, ne do të agjërojmë (edhe) ditën e nëntë.”⁸

Bazuar në këtë hadith, dijetarët islamë kanë dhënë edhe mendimin e tyre në lidhje me agjërimin e kësaj dite dhe kanë përmendur tri mënyra: E para, agjërimi i tri ditëve, 9, 10, 11 në muajin Muharrem; E dyta, agjërimi i ditës së 9 dhe të 10 të këtij muaji; E treta, agjërimi i ditës së 10 Muharrem.⁹

Përveç ditës së Ashurës, Ebu Hurejra r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. është pyetur se cili namaz është më i vlefshëm pas namazeve të detyruara. Ai ka thënë: “Namazi gjatë mesit të natës.” Pastaj është pyetur, se cili është agjërimi më i mirë pas agjërimit të Ramazanit dhe Pejgamberi a.s. është përgjigjur: “Muaji i Allahut që ju e quani Muharrem.”¹⁰

Agjërimi i tri ditëve të çdo muaji

Në traditën e çmuar të Pejgamberit a.s., ekziston edhe agjërimi i tri ditëve të çdo muaji, e që në të drejtën e Sheriatit njihen ndryshe edhe si “Ditët e bardha” ose “Ditët e ndriçuar”. Fjala është për agjërimin e ditës së 13, 14 dhe 15 të muajit hënor, ditë në të cilat hëna është e plotë dhe e ndriçuar, për çka bën që këto të quhen edhe me këtë emër. Ebu Hurejra r.a. na tregon se: “I dashuri im, Pejgamberi a.s. më këshilloi me tri gjëra, e para, të agjërojë tri ditë për çdo muaj, e dyta, të falë dy rekate namaz të duhasë para drekës, dhe e treta, ta falë namazin e vitrit para se të bie me fjet.”¹¹

Po ashtu, transmetohet nga Ebu Dherr el-Gafariu, se Pejgamberi a.s. e kishte urdhëruar të agjëronte tri ditë të çdo muaji, pikërisht ditët 13, 14 dhe 15 (sipas kalendarit hënor). Ai në lidhje me to ka thënë: “Nëse



agjëron ato ditë, është si të agjërosh gjithë vitin.”¹²

Agjërimi i ditës së hënë dhe ditës së enjte

Dita e hënë dhe dita e enjte në traditën profetike gëzonin një respekt të madh. Pejgamberi a.s. në këto ditë tregonte një kujdes të veçantë sa i përket agjërimin të këtyre ditëve. Nga Ebu Hurejra r.a. transmetohet se ditët në të cilat më së shumti agjëronte i Dërguari i Allahut a.s. ishin dita e hënë dhe dita e enjte. Kur u pyet rreth kësaj, ai tha: “Veprat paraqiten tek Allahu çdo të hënë dhe të enjte. Allahu fal çdo mysliman, çdo besimtar, përveç atyre që janë grindur me njëri-tjetrin. Ai thotë: Lërimi ata për më vonë.”¹³

Ndërsa, sa i përket agjërimin në ditën e hënë, Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Ajo është dita kur unë kam lindur dhe është dita kur më ka ardhur shpallja.”¹⁴

Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval

Muaji Sheval është muaji pasues pas muajit Ramazan. Nga fjalët e Pejgamberit a.s., personi që e agjëron muajin Ramazan dhe e pason atë edhe me gjashtë ditë të muajit Sheval, e ka shpërblimin sikur të ketë agjëruar tërë vitin. Andaj për këtë, Pejgamberi a.s. i ka nxitur shokët e tij që muajin Ramazan ta përcjellin edhe me gjashtë ditë të tjera gjatë muajit Sheval. Ebu Ejub el-Ensariu transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e agjëron muajin Ramazan dhe e përcjellë me gjashtë ditë të muajit Sheval, do të shpërblehet sikur të ketë agjëruar tërë vitin.”¹⁵

Agjërimi i ditës së Arafatit

Dita e Arafatit apo thënë më ndryshe nata e Kurban Bajramit, përkon të jetë në ditën e dhjetë të muajit Dhulhixhe. Pejgamberi a.s. e ka pëlqyer agjërimin e këtyre dhjetë ditëve, e veçanërisht të ditës së dhjetë, apo ditës së Arafatit për personin, i cili nuk është në haxh. Ebu Kutada r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Agjërimi i ditës së

Arafatit i shlyen gabimet e dy viteve, një vit përpara dhe një vit pas.”¹⁶

Hafsa r.a. tregon se Pejgamberi a.s. nuk i ka braktisur kurrë katër gjëra, agjërimin e ditës së Ashurës, agjërimin e dhjetë ditëve të para të Dhulhixhes, agjërimin e tri ditëve të çdo muaji, si dhe faljen e dy rekateve para namazit të agimit.¹⁷

Sa i përket vlerës së kësaj dite, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ka ditë tjetër kur Allahu të ketë çliruar më shumë njerëz nga zjarri i Xhehenemit se sa në ditën e Arafatit.”¹⁸

Agjërimi gjatë muajit Shaban

Pejgamberi a.s. agjëronte pjesën më të madhe të muajit Shaban. Nga Aisheja r.a. transmetohet të ketë thënë se kurrë nuk e kishte parë Pejgamberin a.s. të agjëronte një muaj të plotë përveç Ramazanit dhe se kurrë nuk e kishte parë atë të agjëronte më shumë se sa në muajin Shaban.¹⁹

Rreth vlerës dhe rëndësisë që ka ky muaj, Usame bin Zejdi r.a. e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut a.s.: “O i Dërguari i Allahut! Nuk të shoh të agjërosh në asnjë muaj tjetër, ashtu siç bën në muajin Shaban.” Pejgamberi a.s. i tha: “Ai është muaji që njerëzit nuk i kushtojnë vëmendje. Ai është midis Rexhebit dhe Ramazanit. Ai është muaji, gjatë të cilit ngrihen veprat te Zoti i botëve dhe unë preferoj që të jem agjërueshëm kur të ngrihen veprat e mia.”²⁰

Agjërimi gjatë “muajve të ndaluar”

“Muajt e ndaluar” në kalendarin islam janë muajt Dhulkade, Dhulhixhe, Muharrem dhe Rexheb. Gjatë këtyre muajve është e pëlqyeshme të shpeshtohet agjërimi. Një burrë nga Bahileh shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë jam ai që erdhi te ju një vit më parë.” Pejgamberi a.s. i tha: “Çfarë të ka gjetur?! Ke qenë shumë më i pashëm!” Ai u përgjigj: “Nuk kam ngrënë, përveçse natën që u ndava prej jush.” Pejgamberi a.s. i tha:

“Përse e ke dënuar veten? Agjëro gjatë muajit të durimit (Ramazan) dhe nga një ditë në çdo muaj.” Burri tha: “Më shto diçka tjetër, pasi unë kam më shumë forcë dhe mundësi për të agjëruar.” Pejgamberi a.s. i tha: “Agjëro nga dy ditë (të çdo muaji).” Burri këmbënguli dhe tha: “Më shto përsëri.” Atëherë Pejgamberi a.s. i tha tri herë: “Agjëro nga “muajt e ndaluar” (tri ditë rresht) dhe lëre agjërimin (tri ditë rresht).”²¹

Agjërimi një ditë po një ditë jo

Nga Ebu Seleme ibën Abdurrahmani transmetohet se Pejgamberi a.s. i kishte thënë Abdullah ibën Amrit: “Më kanë thënë se ti falesh natën dhe agjëron ditën (vazhdimisht).” Abdullahu iu përgjigj: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Pejgamberi a.s. i tha: “Agjëro dhe ha, falu dhe fli, pasi ti ke detyrim ndaj trupit tënd, ndaj bashkëshortes tënde dhe ndaj mysafirrit tënd. Është e mjaftueshme për ty të agjërosh tri ditë të një muaji.” Abdullahu donte ta nënshtonte veten dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, unë kam fuqi më tepër.” Pejgamberi a.s. i tha: “Agjëro tri ditë në javë.” Abdullahu tha: “Unë kam fuqi më tepër.” Atëherë Pejgamberi a.s. i tha: “Agjëro sipas agjërimin të Davudit dhe mos bëj më tepër.” Abdullahu e pyeti: “Cili ishte agjërimi i Davudit?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Ai agjëronte një ditë dhe hante në tjetrën.”²²

1. Muslimi, kapitulli mbi imanin, 8. 2. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. 3. Muslimi, Sijam, 45. 4. Transmeton Muslimi. 5. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Islami nëpërmjet haditheve 2, fq. 442. 6. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. 7. Transmetojnë Muslimi dhe Ebu Davudi. 8. Transmetojnë Muslimi dhe Ebu Davudi. 9. Sejid Sabik, Legjislacioni i traditës së Profetit a.s., vëll. I, fq. 471. 10. Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi dhe Muslimi. 11. Transmetojnë Buhariu dhe Nesaiu. 12. Sahihu en-Nesai, 2423. 13. Transmeton Ahmedi. 14. Transmeton Muslimi. 15. Transmeton Muslimi. 16. Transmeton Muslimi. 17. Transmetojnë Ahmedi dhe Nesaiu. 18. Transmeton Muslimi. 19. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. 20. Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesaiu. 21. Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi, Ibën Maxhe dhe Bejhakui. 22. Transmeton Ahmedi dhe të tjerët.

Bajram Zeqiri

Agjërimi, shpresë për Rejjanin

“Me të vërtetë në Xhenet ekziston një derë e cila quhet Rejjan. Në të do të hyjnë vetëm agjëruesit dhe askush tjetër pos tyre.” (Buhariu dhe Muslimi)

Muaji Ramazan është adhurim, mëshirë, falje. Ai konsiderohet devotshmëri, mbrojtje për shpirtin dhe epshin. Është shpëtim, qetësi, paqe, solidaritet e vëllazërim ndërmjet besimtarëve. Muaji Ramazan është bindje, mirësi dhe afrim tek Allahu i Madhëruar. Është periudhë qetësie, në të cilën hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyert e Xhehenemit, ashtu siç ka thënë i Dërguari a.s.: “Kur vjen muaji Ramazan, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët.”¹

Muaji Ramazan është njëri ndër dymbëdhjetë muajt e kalendarit hënor, më konkretisht muaji i nëntë. Ndonëse ka vlerë dhe rëndësi të veçantë, muaji Ramazan, në Kuranin fisnik nuk është përmendur në mesin e katër muajve të shenjtë (Dhulkade, Dhulhixhe, Muharrem dhe Rexhep)², të cilët në mesin e arabëve gëzonin privilegj të madh. Në këta muaj ndaloheshin luftërat dhe gjakrrjedhja. Por, muaji Ramazan ka një specifikë tjetër që e dallon ndërmjet muajve të tjerë, e ajo është agjërimi, si një ndër adhurimet thelbësore, më konkretisht ndër kushtet bazë të Islamit, bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s.: “Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla, dëshmia (shehadeti), falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe haxhi (shkuarja në Qabe).”³

Ramazani është muaji i vetëm të cilit i përmendet emri në Kuranin fisnik. Ajo që e privilegjon përmendjen

Ashtu siç e nderoi Medinën ardhja e Pejgamberit a.s. në atë vend, duke e emëruar "Qytet i Nderuar", ashtu edhe zbritja e Kuranit e shndërroi muajin Ramazan në "Muaj të Bekuar".

e këtij muaji në Kuranin fisnik është vetë zbritja e Librit të Zotit, shpalljes së fundit, udhëzuesit për mbarë njerëzimit. “Muaji Ramazan është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhëzues për njerëzit, me plotë shenja

të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja...” (El-Bekare, 185). Përveç përmendjes së emrit, Allahu i Madhëruar e ka specifikuar këtë muaj edhe me agjërime. Zoti për këtë, në Kuranin fisnik ka thënë: “O ju që keni besuar! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare, 183).

Devotshmërinë, e përmendur në fundin e këtij ajeti, njeriu e merr si një mbrojtje shpirtërore përballë të këqijave të shumta. Për këtë arsye, agjërimi nuk është vetëm lënie e ushqimit dhe pijes për kohë të caktuar, por është forcim i vullnetit për t’u mbrojtur nga çdo e keqe. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush nuk e braktis gënjeshtrenë dhe të vepruarit me të, Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë ngrënien dhe pirjen.”⁴ Nga kjo



kuptohet se largimi nga gënjeshttra, fjalët e këqija dhe të punuarit me të përbën një nga veprimet më të rëndësishme etike të agjërimit. Agjërimi është sprovë e durimit. Për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Agjërimi është gjysma e durimit.”⁵

Madhështori i Ramazanit

Ekziston një lidhje e posaçme ndërmjet Ramazanit dhe Kuranit. Këta të dy janë përmendur bashkërisht në një ajet: “Muaji Ramazan është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë...” (El-Bekare, 185).

Është e ditur se në muajin Ramazan ka zbritur i tërë Kurani prej Lehtë Mahfudhit në qiellin e Tokës, për të vazhduar zbritjen graduale për vite të tëra tek i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s.. Ashtu siç e nderoi Medinën ardhja e Pejgamberit a.s. në atë vend, duke e emëruar “Qytet i Nderuar”, ashtu edhe zbritja e Kuranit e shndërrroi muajin Ramazan në “Muaj të Bekuar”.⁶

Nga gjërat më të mira që pritet të bëjë besimtari gjatë ditëve të agjërimit është leximi i shpeshtuar i Kuranit. Pejgamberi ynë i dashur në ditët e Ramazanit lexonte shumë Kuran. Deri në fund të Ramazanit, çdo natë, Xhibrili a.s. vinte tek ai dhe ia dëgjonte leximin e Kuranit Pejgamberit a.s..⁷ Përveç leximit, Pejgamberi a.s. i dëgjonte edhe të tjerët teksa lexonin Kuran, mirëpo kjo gjë arrin kulminacionin pikërisht gjatë Ramazanit. Për këtë shkak, besimtari që lexon Kuran gjatë agjërimit e përtërinë lidhjen e Ramazanit dhe të Kuranit, e që në fakt, i përgjigjet thirrjes së Zotit, i cili ka thënë: “Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed) për të përsiatuar mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.” (Sad, 29).

Një ndër elementet më të rëndësishme që e bën edhe më të çmuar dhe më të bekuar muajin Ramazan, padyshim se është edhe Nata e Kadrit.

Mund të themi se Kurani fisnik gjatë Ramazanit ka aromë të posaçme dhe ofron një shkëlqim të posaçëm të porosive hyjnore. Pejgamberi a.s. porosiste që të lexohet Kurani, ngase ai (leximi i Kuranit), së bashku me agjërimin do të ndërmjetësojnë në botën tjetër për lexuesit e tij, përkatësisht agjëruarit. Ai a.s. ka thënë: “Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për robin në Ditën e Kiametit. Agjërimi do të thotë: O Zot, gjatë ditës e privova nga ushqimi dhe epshet, më jep leje të ndërmjetësojë për të. Kurani do të thotë: O Zot, gjatë natës e privova nga gjumi, më jep leje të ndërmjetësojë për të. Tha: Kështu do t’u jepet leje të ndërmjetësojnë.”⁸

Një natë sa njëmijë muaj


Një ndër elementet më të rëndësishme që e bën edhe më të çmuar dhe më të bekuar muajin Ramazan, padyshim se është edhe Nata e Kadrit. Allahu i Madhëruar me madhërinë e Tij ka veçuar ditë, net, muaj, persona e vende. Nga muajt e vitit, Ai zgjodhi Ramazanin për ta veçuar nga muajt e tjerë, e nga ditët dhe netët e këtij muaji, Zoti zgjodhi një natë, të cilën e veçoi dhe e bëri më të vlefshme se njëmijë muaj. Madje, edhe në Librin fisnik, të cilin Ai e veçoi nga libra e tjerë, dhe e zbriti mu në këtë natë, e

zgjodhi një sure, të cilën e emëroi po me këtë emër.

Kjo natë ka një vlerë dhe rëndësi të madhe, ngase po në këtë natë, Allahu na mësoi se e zbriti edhe Kuranin fisnik: “Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit.” (El-Kadr, 1); “Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmëruar.” (Ed-Duhan, 3).

S’ka dyshim se madhështinë dhe rëndësinë e kësaj nate më së miri e kishte kuptuar vetë i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s.. Raporti i tij karshi dynjasë ndryshonte tërësisht kur bëhej fjalë për kërkimin e Natës së Kadrit. Ai fillonte edhe praktikimin e itikafit, e që kuptimin e ka të veçuarit, të burgosurit, të qëndruarit të një personi për një kohë të caktuar në xhami për adhurime duke u larguar nga sjelljet e përditshme.⁹

Siç tregon sahabiu Ebu Seid el-Hudri, Pejgamberi a.s. fillimisht hynte në itikaf në dhjetë ditët e para të Ramazanit. Më vonë filloi të hynte në dhjetë ditët e mesme. Pasi që kalonte nata e njëzetë, pra në natën e njëzetë e një kthehej në shtëpinë e tij. Edhe të tjerët që qëndronin bashkë me të shkonin në shtëpitë e tyre. Por, në një Ramazan qëndroi në xhami edhe në natën në të cilën e kishte zakon të kthehej në shtëpi. Në një moment, me dorën e vet e largoi me një anë hasrën nga hyrja e tendës. Pastaj e nxori kokën jashtë dhe iu drejtua xhematit me këto fjalë: “Unë hyra në itikaf në dhjetë ditët e para të Ramazanit për ta kërkuar Natën e Kadrit, pastaj fillova ta praktikoj itikafin në dhjetë ditët e mesme. Pastaj m’u tregua se kjo natë gjendet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Prandaj, kush prej jush dëshiron të hyjë (përsëri) në itikaf, le të hyjë!” Me këtë rast, edhe xhemati bashkë me Pejgamberin a.s. hynë në itikaf. I Dërguari i Allahut a.s. urdhëroi: “M’u tregua se Nata e Kadrit është në netët tek (21, 23, 25, 27, 29) dhe në një natë në mëngjesin e së cilës do të bëj sexhde në ujë me baltë.” Në mëngjesin e ditës së njëzet e një, kur u çuan për ta falur sabahun, në qiell



nuk kishte as edhe një re të vetme. Papritmas u shfaqën retë, filloi të bjerë shi dhe në mesxhid filloi të rridhte ujë.¹⁰

Më pas, Pejgamberi a.s. i nxiste shokët e tij që ta kërkonin këtë natë në dhjetëshin e fundit të Ramazanit. Nga Aisheja r.a. rrëfëhet se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kërkojeni natën e Kadrit në dhjetë netët e fundit të Ramazanit”¹¹, e në disa transmetime, ai i specifikoi netët tek të këtij dhjetë netëshi. Po ashtu, nga Aisheja r.a. transmetohet se: “I Dërguari i Allahut a.s. përpjekjet që tregonte (për të bërë ibadet) në dhjetë ditët e fundi (të Ramazanit), nuk i tregonte në kohë të tjera.”¹²

Madhështia e saj tejkalon mendimet njerëzore, Zoti atë e mbivlerësoi me mbi një mijë muaj “Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.” (El-Kadr, 3); e nga kjo ne kuptojmë se adhurimet, ibadete, punët dhe veprat e mira gjatë kësaj nate vlerësohen sikur të jenë bërë përgjatë këtyre muajve që është krahasuar. Si rrjedhojë, Pejgamberi a.s., nga mësimet e tij të arta, na mësoi edhe një këshillë të çmuar rreth kësaj nate. Ai tha: “Kush ngrihet (për namaz nate) në natën e Kadrit me besim dhe llogarit në shpërblimin e Allahut, atij i falen gjynahet e mëhershme.”¹³

Meqenëse nga rahmeti i Allahut, kjo natë mbeti e pacaktuar, Aisheja r.a. njëherë e pyeti të Dërguarin e Allahut se: “O i Dërguari i Allahut! Nëse unë e takoi këtë natë, çfarë të them në të?! Pejgamberi a.s. ia mësoi asaj një dua, tha thuaj: “O Zoti im! Ti je falës, e do faljen, falmë mua!”

Duaja, kandilli ndriçues i agjëruesit

Të gjithë ne fare mirë e dimë hadithin e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë se “Duaja e agjëruesit nuk refuzohet.”¹⁴ Shkak për këtë është gjendja e posaçme e zemrës së agjëruesit, ngase zemra e tij agjëron pandërprerë prej të gjitha të këqijave dhe pendohet vazhdimisht tek Allahu i Lartësuar për mëkatet e bëra.

Ramazani është muaj i duave, i madhërimit të Allahut të Lartësuar, muaj i pendimit e i pranimit të duave. Duke qenë se agjëruesit në këtë muaj, buzët i thahen e barku i ngelet i zbrazët, kërkohet nga ai që t’i ngrit duart dhe ta lut Allahun e Lartësuar, i qëndrueshëm dhe i vendosur në dua dhe në kërkimin e faljes nga Allahu.

“Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, thuaj Unë jam afër, i përgjigjet lutësit kur ai më lutet” (El-Bekare, 186), ky ajet i zbriti të Dërguarit a.s.,

pikërisht atëherë kur sahabët e tij e pyesnin atë se a është afër Zoti i tyre, me qëllim që ta thërrasin dhe ta lusin Atë me zë dhe të qetë.

Besimtari agjërues duhet ta lus Allahun me përlulje dhe me bindje se lutja e tij do të dëgjohet dhe do të pranohet tek Allahu. Kështu na ka mësuar Allahu xh.sh. kur thotë: “Lutjuni Zotit tuaj të përlulur dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin.” (El-Araf, 55).

Po ashtu, Pejgamberi a.s. në një hadith na ka thënë: “Çdo natë, kur mbetet pjesa e fundit e natës, Zoti ynë, qoftë i lavdëruar dhe i madhëruar, zbret në qiellin më afërt dhe thotë: A ka kush që të më lutet Mua e që t’ia pranojë? A ka kush që kërkon prej Meje e që t’ia japë? A ka kush që kërkon falje prej Meje që t’ia falë?”¹⁵

Ky mësim dhe kjo këshillë e të Dërguarit a.s. për lutje drejtuar Zotit duhet të jenë alfa dhe omega jonë përgjatë ditëve dhe netëve të Ramazanit. E meqenëse duaja e agjëruesit na qenka e pranuar, ne lusim Zotin e Madhëruar që të na mundësojë hyrjen në Xhenet përmes derës së agjëruesve, derës Rejjan.

“O Allahu i Gjithmëshirshëm, na jep të mira në këtë botë dhe në Ahiret. Na mbroj prej zjarrit të Xhehenemit, sepse ai është dënim i dhembshëm. O Zot, mos lejo që zemrat tona të enden pasi që i kenë nderuar me udhëzimin Tënd dhe na mëshiro o Allahu i Madhërishëm! Vërtet prej Teje është çdo e mirë!”

1. Transmetojnë Buhariu (4/97) dhe Muslimi (1079). 2. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Islami nëpërmjet haditheve 2, fq. 430. 3. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. 4. Transmeton Buhariu, 1903. 5. Transmeton Ibën Maxhe, 1677. 6. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Islami nëpërmjet haditheve 2, fq. 430. 7. Transmeton Buhariu, 1902. 8. Transmeton Imam Ahmedi (6589). 9. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, “Islami nëpërmjet haditheve 2”, fq. 474. 10. Transmeton Muslimi, marrë prej librit “Islami nëpërmjet haditheve”, fq. 473. 11. Transmeton Buhariu. 12. Transmeton Muslimi. 13. Transmetojnë Buhariu (2014) dhe Muslimi (760). 14. Transmeton Tirmidhiu. 15. Transmeton Buhariu (1145).

Blerim Musliu

Po të presim me mall

E ne dëshmojmë o Zot se jemi përmallu për mysafirin tënd, për Ramazanin, e dora po më dridhet vetëm kur po e përshkruaj mallin e përjetimet për të, e si është gjendja e zemrave kur e kujtojnë takimin me ty o Zoti i gjithësisë.

Njeriu gjatë jetës së tij, mërzhitet për gjërat që i mungojnë, mërzhitet për ato gjëra, që me prezencën e tyre ndjehet i lumtur, ndjehet i qetë dhe që i ofrojnë siguri e ngrohtësi.

Malli për to bëhet edhe më i madh, atëherë kur njeriu e rrethojnë vësh-tirësitë e atmosfera e vrazhdë, atëherë kur është i frikësuar, e kur ka nevojë t'i mposht të gjitha këto.

Në kohën e problemeve sociale e shpirtërore brenda rrethit, e deri tek ato globale, të luftërave e pamjeve të trishtuara, shpirti ka nevojë për qetësi e rehati, e malli për ty Ramazan bëhet edhe më i fuqishëm.

Për ty që je si uji i freskët në shkretëtirë, ani pse në ty ndalohet pirja e ujit.

Për ty që vjen si një ilaç për të sëmurin.

Për ty që vjen si përgëzim i madh nga qielli për banorët e Tokës.

Për ty që për pak momente për disa ditë na nxjerr nga atmosfera e përditshme, e na zbret nga treni i paqartësive të shumta.

E na mëson kuptimin real të jetës.

Jemi përmallu për ty...

E si të mos përmallohemi për ditët në të cilat hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyert e Xhehenemit. "Kur të vjen muaji Ramazan, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët." (Hadith).

Jemi përmallu për ty, e si të mos na merr malli për kohën e iftarit e për pranimin e lutjeve, ashtu siç na mësoi i Dërguari ynë i dashur a.s.: "Janë tre

persona, lutja e të cilëve nuk kthehet prapa, lutja e agjëruesit kur çelë iftarin...", e si të mos përmallohemi për pranimin e lutjeve të shumta, të cilat tashmë i kemi bërë gati.

E vallë, si të mos përmallohemi kur te ty ndiejmë shijen e adhurimeve, ndiejmë ngrohtësinë familjare në kohën e syfyrit e të iftarit, ndiejmë butësinë e Kuranit, duke na i larguar për pak momente nga duart tona telefonat, ndiejmë madhësitinë e mësimëve dhe udhëzimeve kuranore, në vend të lajmeve të shumta e të pa kuptimita ditore.

Sa shumë jemi përmallu për ty, sepse na kanë rënduar gjynahet, e po presim me padurim stacionin e pastrimit e të shkarkimit nga to.

E sa e sa dhurata që i përmban kjo pako nga i Madhi Zot, secilën nga to që e kujtoj, e pres me padurim ta hapi e ta përqafoj fort dhe ta kuptoj o Zot se sa shumë na do.

Sa shumë e do faljen tonë...

Sa shumë do të na afrosh te Ti...

E sikur nuk na mjafton Ramazani me të gjitha këto, pikërisht tek ajetet

e agjërimit na ke treguar se si të bëhemi të devotshëm e të arrihet te Ti pa ndërmjetësim. "O ju që keni besuar, u është bërë obligim agjërimi, ashtu siç ishte edhe i atyre para jush, ashtu që të bëheni të devotshëm." (El-Bekare, 183).

Na ke treguar e na ke përgëzuar se Ti je afër robërve që pyesin për Ty. "E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet..." (El-Bekare, 186).

Je afër atyre që e duan përmirësimin, je afër tyre që e duan faljen, afër tyre që e duan ngritjen.

E ne dëshmojmë o Zot se jemi përmallu për mysafirin tënd, për Ramazanin, e dora po më dridhet vetëm kur po e përshkruaj mallin e përjetimet për të, e si është gjendja e zemrave kur e kujtojnë takimin me ty o Zoti i gjithësisë, "Agjëruesi ka dy gëzime, i pari kur ta çelë iftarin, e i dyti kur të takohet me Zotin e tij." (Hadith), e padyshim se këtu ndalen fjalët, duke i lënë vend të gjatë meditimit e përjetimit...



Isa Tërshani

Ramazani dhe agjërimi

Allahu e zgjodhi këtë muaj që ta shpallë librin e Tij më të mirë te krijesa e Tij më e zgjedhur, dhe që ky muaj, me agjërime, të jetë adhurim i detyruar vjetor. “O ju që besuat, u është bërë obligim agjërimi, sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”¹

Efalënderojmë të Madhin Allah xh.sh., që na ka bërë pjesëtarë të fesë islame, na ka dhënë jetë dhe shëndet që ta presim edhe këtë muaj të bekuar Ramazan me gëzim të madh dhe me zemër të hapur, si dhe me shpresë për faljen e mëkateve. E mirëpresim duke qenë të bindur se Ramazani dhe agjërimi janë një dhunti e Allahut dedikuar besimtarëve në mbarë botën.

Muaji i madhërisë Ramazan ka qenë dhe mbetet inspirim i përherëshëm i të gjitha gjeneratave të myslimanëve, që prej kohërave të para e deri sot, ashtu do të jetë deri në Ditën e Gjykimit. Subteliteti-ruhanijeti i tij pushton çdo besimtar, ndërsa atmosfera e veçantë dhe e papërshkrueshme shtrihet mbi çdo rrugë dhe shtëpi.

Muaji Ramazan bëhet i shenjtë dhe merr famë më të madhe, ngase Zoti Fuqplotë e zgjodhi dhe e caktoi këtë muaj për zbritjen e Kuranit, i cili duke shtruar fakte të sakta mbi të vërtetën, ndihmoi njerëzimin që të dallojë se çka është mirë e çka është keq, të dallojë të vërtetën prej asaj që është e kotë dhe gënjeshtër dhe të dallojë dritën prej errësirës.

Kurani sikur që na është e njohur, i zbriti të dërguarit të fundit, Muhamedit a.s., më të zgjedhurit nga të gjithë të dërguarit e tjerë të mëparshëm. Për Kuranin mund të thuhet se është kushtetutë e përsosur dhe ideale, gjersa dispozitat e tij shumë lehtë mund të praktikohen në çdo kohë dhe vend. Është libër i cili ka përmbledhur të gjitha të mirat e

dynjasë dhe Ahiretit, duke mos lënë asgjë pa përmendur e sqaruar lidhur me çështjet e fesë e jetës. Pasi që është i zbritur prej të Madhit Zot, saktësia e tij është e garantuar, andaj edhe është i ruajtur si burim original. Duke i praktikuar rregullat dhe dispozitat e tij, njerëzisë gjithnjë iu ka bërë mundur zhvillimi i jetës së lumtur në këtë rruzull tokësor.

Ramazani, muaj i mëshirës

Kurani është libër mëshire, i zbritur tek i Dërguari i mëshirës, në muajin e mëshirës më të madhe, Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “Ne të shpallëm Kuranin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...”²; “E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”³

Kurani u zgjodh që të zbriste në muajin e mëshirës, e për këtë, Muhamedi a.s. ka thënë: “...Ai është muaji, fillimi i të cilit është mëshirë, mes i tij falje dhe fundi i tij është shpëtim nga zjarri...”⁴

Nuk është habi, duke u mbështetur në vlerën e madhe të këtij libri të shenjtë, kur Zoti xh.sh., e vlerëson ibadet edhe leximin e tij, qoftë edhe nga ai, i cili nuk e kupton domethënien e tij, e të mos flasim për vlerën e tij si ibadet, te lexuesi, i cili e njeh edhe domethënien e tij dhe e orienton jetën sipas udhëzimeve të tij. Andaj për rëndësinë që i është dhënë mësimi dhe leximi të Kuranit, po përmendim vetëm dy

Kurani u zgjodh që të zbriste në muajin e mëshirës, dhe Zoti e përmendi me emër në Kuran vetëm këtë muaj të vitit, e jo edhe muajt e tjerë,

hadithe edhe pse ka shumë rreth kësaj tematike. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Më i miri prej jush është ai i cili mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve”⁵, si dhe “Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë në Ditën e Gjykimit...”⁶

Sigurisht, për rëndësinë që pati zbritja e Kuranit në këtë muaj në mbarëvajtjen e jetës së njerëzimit, Zoti xh.sh., e përmendi me emër në Kuran vetëm këtë muaj të vitit, e jo edhe muajt e tjerë, ku thotë: “Muaji Ramazan, që në te (filloi të) shpallet Kurani...”⁷

Madje, në shenjë të madhërimit të fillimit të zbritjes së Kuranit, bëhet obligim edhe agjërimi i këtij muaji, e që është një nga pesë shtyllat e fesë Islame.⁸

Agjërimi
shtyllë e fesë islame

Agjërimi është një nga pesë shtyllat e fesë islame. Ai është bërë farz-

detyrim në vitin e dytë të Hixhretit, para betejës së Bedrit. Myslimanët e shpalljes së fundit u obliguan me agjërimit në muajin Ramazan, e jo në ndonjë muaj tjetër, edhe pse ditët, muajt dhe vitet janë të njëjta. Këtë më së miri e di Zoti xh.sh., por është e ditur edhe kjo se, ngjarjet historike bëjnë që të dallohet njëra ditë prej tjetrës. Kjo është praktikë e rëndomtë tek të gjithë popujt, pra edhe këtu kemi një ndodhi të pashembullt. Në të vërtetë, Zoti Fuqiptotë, mu në këtë muaj, nga mëshira e Tij, ia zgjati dorën e mëshirës njerëzimit, e tërhoqi prej injorancës, ia hapi dyert e arsimimit dhe të përparimit në çdo pikëpamje, i dha mundësi ngritjes së tij shpirtërore e morale, ashtu që atyre të mos u kthehet kurrë më ndonjë errësirë e ngjashme në jetë. Pra, për herë të parë, pas një periudhe bukur të gjatë, krijohet lidhja ndërmjet tokës dhe qiellit, ndërmjet Krijuesit dhe krijesave. Xhibrili a.s. për herë të parë i sjell Muhamedit a.s. këshillat e para prej Zotit xh.sh..

Nga të gjitha këto të mira, që filluan të na lajmërohen pikërisht në muajin Ramazan, Zoti xh.sh. na shpërblen edhe me një vepër të lartë ndaj Tij, me agjërimit, dhe shih si fillon ajeti në fjalë: “O ju që besuat, agjërimit u është bërë obligim...” (El-Bekare, 183).

O ju të cilët keni arritur të njihni Zotin e vërtetë dhe vetveten, duke ditur se të tillët do të nguten t'i përgjigjen thirrjes së Tij duke i thënë: “Urdhëro, o Zoti ynë, prej teje është urdhri, kurse prej nesh zbatimi.”

Të gjitha këto në shenjë kënaqësie me Zotin xh.sh., ngase myslimani e di fare mirë se në legjislacionin e Allahut të Madhërishtëm pa dyshim ka fshehtësi, në dispozitat e Tij ka urtësi dhe në krijesat e Tij ka qëllime. Andaj disa prej këtyre fshehtësive, urtësive, qëllimeve e arsyeve janë të njohura për mendjen e njeriut dhe mund të arrihet të kuptuarit e tyre, e disa të tjera janë të pakapshme dhe të paarrtshme për mendjen e tij, qoftë kjo për një kohë të caktuar apo përfundimisht.

Rëndësinë dhe vlerën e ibadetit të agjërimit njeriu nuk është në gjendje që ta kuptoj plotësisht. Rëndësia dhe vlera e këtij adhurimi qëndron tek Allahu i Madhëruar, edhe agjërimit ka fshehtësitë, urtësitë dhe qëllimet e tij, e që për disa prej tyre na i ka treguar vetë Allahu xh.sh. në Kuranin Fisnik dhe Muhamedi a.s., në hadithet e tij. Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “O ju që besuat, agjërimit u është bërë obligim... kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare, 183). Pra, agjërimit është një prej rrugëve drejt devotshmërisë ndaj Allahut të Madhëruar dhe agjëruesi është personi më i afërt me Zotin xh.sh..⁹

Pejgamberi a.s. na ka treguar se Allahu xh.sh. për agjëruesin ka përgatitur shpërblim të veçantë. Ebu Hurejre r.a. transmeton një hadith të Muhamedit a.s., në të cilin thuhet: “Allahu i Lartësuar ka thënë: Çdo vepër e njeriut i takon atij-përveç agjërimit, sepse atë e bën vetëm për Mua dhe Unë do ta shpërblej për atë (posaçërisht)...”¹⁰

Me agjërimit nuk duhet kuptuar vetëm të ndalurit nga ushqimi dhe pija, por diç më shumë, më tepër. Të

ndalurit nga ushqimi etj., është vetëm hyrje në agjërimitin e vërtetë, e ai është të ndalurit, abstenimi nga çdo punë, sjellje, fjalë e keqe e dëmshme, nga çdo gjynah, i cili është i inspiruar prej shejtanit, si dhe tërë qëllimin e ka, që ta përputhë jetën me mësimet e Zotit të shpallura në Kuran. Nëse agjërimit nuk kuptohet në këtë mënyrë, ai nuk do t'i sjell njeriut atë shpresë, atë shpërblim dhe atë sevap aq të madh, të cilin e dëshiron dhe të cilin e shpreson.

Dimensionet e agjërimit

Ky ibadet-adhurim, gjegjësisht agjërimit, jo vetëm që është rehabilitim dhe shërim për trupin, por është rehabilitim dhe shërim edhe për shpirtin e myslimanit, i cili pikërisht në urinë që e karakterizon juridikisht agjërimitin, i ushqen ndjenjat, dëshirat dhe pretendimet e veta për ngritje kah piedestalet më të larta dhe kah përsosmëria. Në këtë muaj, besimtari bënë humanizmin e shpirtit të vet, dhe si të thuash në një mënyrë



paraqitet në shoqëri si personalitet i ri, i cili ka bërë ndryshime rrënjësore.

Ai, agjëruesi, është më i kujdesshëm në fjalët dhe veprimet e veta, është më i ndjeshëm dhe interesohet më tepër për vëllëzërit e tij të varfër dhe hallexhinj, forcohen edhe lidhjet, sepse në Ramazan, ashtu siç predikojnë hoxhallarët tanë të nderuar nga mësimet islame, duhet të shuhen zënkat dhe konfliktet në shoqëri. Ramazani-agjërimi, krahas ibadeteve të tjera që thirrin në këtë parim, paraqet thirrjen më të madhe vjetore për pajtim mbarë njerëzor, sepse Ramazani-agjërimi dhe hidhërimi nuk kanë asgjë të përbashkët, dhe duhet patjetër të theksojmë se kjo nuk vlen vetëm për myslimanët, por thirrja e Ramazanit për mirësi, zemërgjerësi, humanitet, devotshmëri, vetëkontroll, vlen edhe për jomyslimanët, të cilët nuk na luftojnë, dhe me këtë Islami na mëson se në vend të konfliktit në mes civilizimeve, ofron dialogun në mes tyre dhe sjelljen e mirë.¹¹

Pejgamberi a.s., ashtu si për të gjitha adhurimet, vë në dukje edhe dimensionet e agjërimit që ndikojnë mbi sjelljen e njeriut dhe e rregullojnë atë. Ebu Hurejre r.a. transmeton nga Muhamedi a.s., i cili ka thënë: “Agjërimi është një mburojë. Agjëruesi të mos sillet keq, të mos flas keq. Nëse dikush nis të përleshet ose të shahet me të, le t’i thotë dy herë: “Unë jam agjërueshëm.” Beto hem në Allahun i cili e mban këtë shpirt në trup, aroma e gojës së agjëruesit (që vjen si pasojë e urisë) është më e këndshme te Allahu se aroma e miskut...¹²

Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut a.s., e krahason agjërimit me mburojën. Ashtu si mburoja që mbron nga sulmet, shigjetat dhe shpatat e armiqve në luftë, njashtu agjërimi e mbron agjëruesin. Madje jo vetëm nga sulmet që mund të vijnë nga jashtë, por edhe nga sulmet që mund të vijnë nga egoja e tij, nga dëshirat epshore apo nga cytjet e shejtanit. Personi i cili agjëron me këtë vetëdije dhe ndjeshmëri, në këtë botë do të mbrohet nga mëkatet

Agjërimi është rruga më e efektshme për ta mbajtur veten nën kontroll, sepse detyrimet fetare i kryen me kënaqësi e sinqeritet dhe nga ana tjetër e ndalon veten nga fjalët dhe veprimet e këqija.

dhe të këqijat, ndërsa në botën tjetër do të jetë i mbrojtur nga zjarri i Xhehenemit.

Agjëruesi, mburojën në radhë të parë do ta përdorë ndaj sjelljeve dhe qëndrimeve të gabuara që mund të burojnë nga vetë gjuha dhe dora e tij. Prandaj ndaj askujt nuk do të sillet vrazhdë, kurrë nuk do të mbaj qëndrime injorante dhe të dhunshme. Në qoftë se dikush e provokon, kërkon të zihet e të përleshet me të, atëherë mburojën e agjërimit do ta përdorë kundër tij. Sepse, edhe pse e vështirë, kjo mënyrë sjelljeje është një mënyrë për të ngadhënjyer mbi zemërimin dhe për t’iu përgjigjur së keqes me të mirë. Nuk i ka hije besimtarit lëndimi i njerëzve, aq më pak myslimanit që agjëron. Fytyra e qeshur dhe goja e ëmbël, duke u bashkuar me qetësinë që i fal shpirtit agjërimi, i lejon njeriut të përkapë flladën e mëshirës hyjnore.¹³

Rëndësia e agjërimit është edhe nga pikëpamja e ngulitjes së bukurive morale te personi i cili agjëron, duke qenë se agjërimi e mëson njeriun të bëhet durimtar, i devotshëm dhe falënderues. Agjërimi është një sprovë e durimit. Gjatë agjërimit, njeriu nuk e zgjatë dorën drejt ushqimit që ka përpara, nuk flet fjalë të këqija, nuk shikon me sy të keq dhe çdo të keqe që i ndodh e përballon me maturi. Për sa kohë që

është agjërueshëm, ai është i durueshëm përballë urisë e etjes dhe ndaj çdo lloj mëkati apo veprë të shëmtuar. Prandaj edhe i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Agjërimi është gjysma e durimit.”¹⁴

Agjërimi është rruga më e efektshme për ta mbajtur veten nën kontroll, sepse detyrimet fetare i kryen me kënaqësi e sinqeritet dhe nga ana tjetër e ndalon veten nga fjalët dhe veprimet e këqija. Lidhur me këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush nuk e braktis gënjeshtrenë dhe të vepruarit me të, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të lë ngrënien dhe pijen.”¹⁵

Kjo do të thotë se largimi i agjëruesit nga gënjeshtria, dëshmimi i rremë, shpifjet, thashethemet, fjalët e sjelljet e këqija, përbënë një nga parimet më të rëndësishme etike të agjërimit. Në fakt, veprime si thashetheme e përgojimi kurrë nuk i kanë hije myslimanit.

Agjërimi është manifestim i besës ndaj Allahut xh.sh., ngase ai është adhurimi më i sinqertë, tek i cili shfaqet ndjenja e besnikërisë mes Allahut dhe robit të Tij. Njeriu, duke hequr dorë në kohë të caktuara nga gjëra e veprime të caktuara, më së miri e tregon se e respekton premtimin e dhënë. Kështu që, besnikëria, përmes agjërimit bëhet pjesë e pandashme e karakterit të njeriut, përkatësisht agjëruesit.¹⁶

1. El-Bekare, 183. 2. El-Isra, 82. 3. El-Enbija, 107. 4. Pjesë nga hadithi i Bejhekiut. 5. Transmeton Buhariu, kitabul fedail. 6. Mustedrek el Hakim, nr. 154. 7. El-Bekare, 185. 8. Sherif Ahmeti, Komente dhe mendime Islame, Prishtinë, 1995, f.123. 9. Aid el Karni, Mësime për agjëruesit, Shkup 2015, f.16. 10. Buhariu, Babu Savmi, nr. 1904. 11. Bashkim Aliu, Shkrime Ramazani, Shkup, 2014, f.22. 12. Buhariu, Babu Savmi, nr. 1894. 13. Islami nëpërmjet haditheve 2, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, f.453. 14. Ibni Maxhe, Babu Sijam, nr.1745. 15. Buhariu, Babu Savmi, nr.1903. 16. Ilmihal i zgjeruar, Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2018, f.338.

Mihana Goga-Bekteshi

Ramazani, ilaçi i trupit dhe shpirtit

"Çdo vepër që bën biri i Ademit (çdo njeri) është për vetë atë, përveç agjërimit i cili është për Mua dhe Unë do ta jap shpërblimin për të. Ka dy momente për agjëruesin në të cilat ai gëzohet: kur ha iftar, dhe kur të takojë Zotin e vet. Këtë herë ai gëzohet duke u kënaqur për agjërimitin që ka bërë." (Hadith Kudsij)

Të gjithë njerëzit bëjnë llogari brenda 12 muajve se çfarë kanë përfituar dhe çfarë kanë humbur. Në përgjithësi, mund të thuhet se mundësitë të cilat Zoti xh.sh. na i ka dhënë për t'i shfrytëzuar gjatë vitit, që të gjitha janë të përmbledhura në muajin Ramazan.

Kur vjen muaji Ramazan, i gjen njerëzit në gjendje të ndryshme, kështu që në qoftë se njeriu e shfrytëzon Ramazanin si duhet, ajo çfarë mund t'i ikën pas tij mund të përballohet më lehtë. Sa më të qartë që njeriu ta ketë qëllimin, aq më sigurt do të vazhdojë drejt tij. Fatkeqësia dhe problemi i shumë prej nesh është se pas përfundimit të Ramazanit, gjithmonë ndiejmë keqardhje dhe kemi brengën se mos edhe ky Ramazan shkoi sikurse i kaluari.

Zoti xh.sh. për ne e ka zbritur Kuranin mëshirë, sistem jete dhe sakrifice. Secili nga ne ka mëkate dhe Zoti xh.sh. na i fal ato nga një periudhë në tjetrën, p.sh. në vit - shkuarja në haxh, në muaj - Ramazani, në javë - dita e xhuma, në ditë - 5 kohët e namazit, brenda ditës prej një kohe të namazit në tjetrën.

Së pari duhet ditur se obligimi i agjërimit është bërë gradualisht duke kaluar në dy etapa, ku etapa e parë ishte me dëshirë, kush dëshironte të agjërojë agjëronte, kurse etapa e dytë ishte kur u bë obligim për të gjithë.

Në fillim agjërimit ishte i vështirë, pasi po të flije pas iftarit, nuk të lejo-

...njihe veten tënde në këtë Ramazan përmes kualitetit të adhurimeve i cili dëshmon se ti je duke e ndier përcjelljen e Zotit mbi ty!

hej të haje ushqim deri të nesërmen në iftar. Por më pas u lehtësua dhe u bë në mënyrën që e njohim sot. Kjo pasi një nga myslimanët u kthye një ditë i lodhur dhe e zuri gjumi pas akshamit, kështu iu ndalua të hajë deri të nesërmen në iftar. Të nesërmen nga lodhja dhe uria i ra të fikët. Atëherë Pejgamberit a.s. iu shpall ajeti i cili përshkruan mënyrën e agjërimit duke ua lejuar të ushqeheshin deri në agim:

"Natën e agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. Allahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin tuaj dhe ua fali gabimin. Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkoni atë që ua ka caktuar Allahu dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj

agjërimitin plotësojeni deri në mbrëmbeje. (El-Bekare,187)

Zoti xh.sh. e dinte shumë mirë që një agjërimit i tillë ishte i vështirë, por e bëri që besimtari ta ndejë mëshirën dhe dhembshurinë e Zotit, i cili obligon vetëm gjëra të cilat janë të mundshme për t'u arritur.

Rëndësia e përmirësimit të gjendjes sonë të tanishme është se duhet të bëjmë një ndërlidhje të fuqishme, të pa shkëputur mes gjërave, një lidhje shkak-pasojë. Në qoftë se si rezultat i këtij Ramazani përmirësojmë vetët tona, atëherë shkak i këtij përmirësimi do të jetë kualiteti i Ramazanit. Sa



Prej urtësive të agjërimit është edhe barazimi ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, andaj ky është një sistem praktik dhe prej sistemeve më të fuqishme e më të mahnitshme për socializim të shëndoshë.

më kualitativ që të jetë Ramazani, aq më i lartë do të jetë shkalla e përmirësimit. Ta kuptojmë këtë fakt se nuk ka përmirësim të gjendjes, në qoftë se kualiteti mbetet në shkallën e vitit të kaluar. Ne duhet të synojmë përmirësimin e vetes tonë, të ecim përpara për ta bërë Ramazanin sa më kualitativ. Pra, shkaku është adhurimi, ndërsa pasoja është përmirësimi ynë, e tek atëherë do të kemi një Ramazan më ndryshe.

Në çdo aspekt të jetës së tij njeriu ka nevojë për përgatitje. Ndjenja e besimtarit se Zoti xh.sh është duke e përcjellë bën që veprat e tij të jenë sa më kualitative. Pra kjo është një pikë e rëndësishme përmes të cilës besimtari do të mundohet të jetë më i përgjegjshëm në Ramazan, sepse është dikush që është duke e vlerësuar agjërimit tënd, namazin tënd. Zoti xh.sh. thotë: “Ti nuk angazhohesh në asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kurani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi dëshmitarët tuaj, kur ju e ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm se është evidentuar në Librin e Sigurt. (Junus, 61).

Pra njihje veten tënde në këtë Ramazan përmes kualitetit të adhurimeve i cili dëshmon se ti je duke e ndier përcjelljen e Zotit mbi

ty, pra sa më kualitativ të jetë rrugëtimi, aq më e sigurt do të jetë arritja. Zoti xh.sh. thotë: “Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit), duke mos mbetur fshehtë asnjë sekret juaji.” (Hakkah,18)

Pra, përgatitu për Ramazan para fillimit të tij, sepse Pejgamberi a.s. bënte lutje para fillimit të ardhjes së këtij muaji dhe thoshte: “O Zot na jep begati në muajin Rexhep e muajin Shaban dhe na mundëso të arrijmë muajin Ramazan.”

Vlera dhe epërsia e agjërimit

Ebu Hurejra r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Agjërimit është mburojë nga zjarri i Xhehenimit. Kështu që agjëruesi duhet të shmangë kontaktet intime me bashkëshorten dhe nuk duhet të sillet pa mend dhe me paturpësi, edhe nëse dikush tjetër e lufton a sillet keq me të apo e shan atë, atëherë ai duhet t’i thotë atij dy herë: “Jam agjërueshëm!” (Sahihul-Buhari)

Pejgamberi a.s. shtoi: “Për Atë, në Duart e të Cilit është shpirti im! Era që vjen nga goja e agjëruesit është më e mirë dhe më e dashur tek Allahu i Lartësuar sesa era e miskut. (Allahu thotë për agjëruesin): “Ai i ka lënë mënjanë ushqimin, pijen dhe dëshirat e tij për hatrin Tim. Agjërimit është për Mua, kështu që Unë do ta shpërblej (agjëruesin) për të dhe shpërblimi i veprave të mira shumëfishohet dhjetë herë.” (Sahihul-Buhari)

Rejjani, një nga portat e Xhenetit është vetëm për agjëruesit. Sehli r.a. tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Është një portë në Xhenet që quhet Rejjan, nga e cila do të hyjnë agjëruesit Ditën e Ringjalljes dhe askush tjetër nuk do të hyjë andej, përveç atyre. Do të thirret: “Ku janë agjëruesit?” Ata do të ngritën dhe askush tjetër nuk do të hyjë nga ajo portë përveç tyre. Kur ata të kenë hyrë të gjithë, ajo do të mbyllet dhe askush nuk do të hyjë më që andej.” (Sahihul-Buhari)

Megjithatë veprat dhe veprimet adhuruese janë vetëm për Zotin xh.sh., këtu Zoti xh.sh. veçon agjërimitin, sepse agjërimiti nuk është formë adhurimi dhe përkushtimi që mund të bëhet për t’u dukur. Agjërimiti është i fshehtë dhe askush nuk mund ta dijë nëse dikush agjëron apo jo përveç Zotit xh.sh.. Kësisoj pra, agjërimiti është vepër e pastër plotësisht për Zotin e që nuk mund të njolloset me hipokrizi.

Tregon Ebu Hurejra r.a.: “(Thotë Allahu i Madhëruar): Çdo vepër që bën biri i Ademit (çdo njeri) është për vetë atë, përveç agjërimiti i cili është për Mua dhe Unë do ta jap shpërblimin për të. Ka dy momente për agjëruesin në të cilat ai gëzohet: kur ha iftar, dhe kur të takojë Zotin e vet. Këtë herë ai gëzohet duke u kënaqur për agjërimitin që ka bërë.” (Përmbledhje e librit ”Sahih el-Buhari”)

Po ashtu ngrënia e syfyrit ka shumë bekime e mirësi, por nuk është e detyruar. Enesi r.a. tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Hani syfyri, pasi ai ka shumë bekime e mirësi.” (Muhtesar Sahih El-Buhari, Përmbledhje e librit ” Sahih el-Buhari”)

Qëllimi i agjërimit

Zoti xh.sh. mbi qëllimin e agjërimit në Kuranin fisnik ka thënë: “O ju që besuat, agjërimiti u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare,183)

Qëllimi kryesor i agjërimit është që të jemi të devotshëm, por si ta arrijmë ne devotshmërinë? Devotshmëri është që Zoti të të gjejë aty ku të ka urdhëruar dhe të mos shkosh aty ku të ka ndaluar. Njerëzit sot gjithë vëmendjen ia kanë kushtuar trupin duke lënë shpirtin në harresë. Shpirti nuk lëviz dot pa trupin, por edhe trupi nuk lëviz dot pa shpirtin. Secili prej tyre ka ushqimin e tij i cili ka të bëjë me origjinën nga është krijuar. Kështu ushqimi i trupit është të ngrënit, të pirët, shëtitjet, kurse ushqimet e shpirtit janë leximi i

Kuranit, namazi, agjërimi, të kujtuarit e Zotit xh.sh., lëmosha.

Agjërimi forcon dy gjëra:

1. Forcon rezistencën ndaj çfarëdo lloj joshjeje pasi ty ndoshta të hahet, por kur mendon që po agjëron ndalon derisa të vijë koha e iftarit, pra rezistenca ndaj joshjeve është vetë devotshmëria.

2. Forcon marrëdhëniet shoqërore - familja bashkohet e gjitha në kohën e iftarit, bashkohen në namaz të teravisë, vizita të ndërsjella.

Agjërimi është tri lloje

1. Agjërimi i njerëzve të zakonshëm dhe ky agjërim është kur agjëruetit i agjëron thjesht stomaku. Ky lloj agjërimi është i pranuar dhe të llogaritet se ke agjëruar, por nuk e ka shpërblimin e Zotit xh.sh. Zoti ka thënë: “Dhe ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.” (Kaf,18). Në një hadith Muhamedi a.s. ka thënë: “Kush nuk i lë fjalët e këqija, por vepron kështu edhe (gjatë Ramazanit), Allahu s’ka nevojë që ai ta lë ushqimin dhe pijen e tij.”

2. Agjërimi i njerëzve të veçantë. Agjëruetit e këtij lloji veç stomakut u agjërojnë edhe pjesët e tjera të trupit. Atyre u agjërojnë të gjitha gjymtyrët sytë, veshët, duart, këmbët, dhe kjo jo vetëm gjatë agjërimit, por edhe natën pasi të kenë çelur iftar. Zoti xh.sh. thotë: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (El-Isra’ë, 36).

3. Agjërimi tepër i veçantë, ky lloj është më i miri. Dashuria për Zotin xh.sh. ka mbushur zemrën e tij, në çdo gjendje që është ai është me Zotin xh.sh. dhe kujdeset për çdo veprim të jetës së tij. Zoti xh.sh. thotë: “Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdeshëm gjatë faljes së namazit, ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë).” (El-Mu’minun 1-3)



Urtësitë dhe dobitë e agjërimit

Agjërimi ka urtësi dhe dobi të shumta, si nga aspekti shoqëror, ashtu edhe nga ai individual, e prej tyre janë:

Solidarizimi me të gjerët, kjo ngase, agjërueti kur të përjetojë urinë, atëherë i kujton ata që janë në të njëjtën gjendje gjatë gjithë kohës dhe ky rikujtim e shtyn atë që të ketë mëshirë ndaj të ngratëve, ngase mëshira te njeriu buron nga dhimbja. Andaj agjërimi është metodë praktike për edukimin e shpirtit me edukatën e mëshirës e kurdo që realizohet mëshirimi nga ana e të pasurit ndaj të varfrit, atëherë ndjenja e brendshme humane ka fuqinë e ndikimit, për këtë transmetohet se Pejgamberi a.s. ka qenë më bujari ndër njerëzit (për të bërë) mirë. Ishte më bujar në Ramazan, kur e takonte Xhibrili a.s., Xhibrili e takonte në çdo natë të Ramazanit.

Prej urtësive të agjërimit është edhe barazimi ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, andaj ky është një sistem praktik dhe prej sistemeve më të

fuqishme e më të mahnitshme për socializim të shëndoshë.

Prej urtësive të agjërimit duhet theksuar edhe zbehja e fuqisë së shprehisë-zakoni, ngase te disa persona ka arritur fuqia e shprehive deri në masën e skllavërimit të njeriut. Po që se u vonohet atyre ushqimi nga termini i caktuar dhe i godet ata uria, atëherë edhe morali i tyre përkeqësohet. E ndoshta pasioni i varshmërisë ndaj kondicionerëve, kafesë, çajit, duhanit është edhe më e fuqishme se sa fuqia e shprehisë së ushqimit për ata që janë të varur në këtë, të tillët konsiderohen skllavër të shprehive të tyre.

Prej urtësive të agjërimit është edhe përforsimi i vullnetit, ngase Gerhard, profesor gjerman, e kishte shkruar një libër për fuqizimin e vullnetit, ku e kishte vendosur agjërimin si bazë të fuqizimit të vullnetit, e në të kishte shkruar se ai është mekanizmi me efikas për të realizuar fuqinë dhe epërsinë e shpirtit ndaj trupit, dhe kështu do të jetonte njeriu duke i pasur në dorë të tij frenat e vetvetes.

Një tjetër faktor që ka mjaft ndikim në gjendjen psikologjike të njeriut është namazi i natës.

Msc. Abdullah Klinaku

Ramazani në shkrimet e hafëz Ali Korçës

Ramazani si adhurim, identitet dhe kulturë

Identiteti fetar të shqiptarët ka qenë i brumosur për shekuj me radhë. Jeta, veshja, doket, traditat, kultura, mendimi e shkrimi kanë qenë të ngjyrosura me bukuritë e Islamit për një kohë të gjatë të kombi ynë. Identiteti fetar me shenjat e tij ka qenë i theksuar në të gjithë gjeografinë tonë shqiptare, ku më pak e ku më shumë.

Shenjat e këtij identiteti e kanë shoqëruar në vazhdimësi kombin tonë, përveç kohës së komunizmit, i cili dhunshëm e ndryshoi identitetin tonë dhe historinë ndaj identitetit tonë. Krahas së vërtetës sonë për identitetin fetar të mishëruar brenda strukturës sonë kombëtare dhe historisë së keqinterpretuar zyrtare ndaj këtij identiteti, e kemi obligim t'i shpërfaqim të vërtetat e lidhjes së fortë midis identitetit dhe kulturës kombëtare e islame të shqiptarët.

Ramazani të shqiptarët përveç si adhurim ndaj Zoti të Madhërishëm ka qenë edhe shenjë identitare, kulturore e intelektuale. Historia jonë dëshmon për lidhjen e ngushtë ndërmjet Ramazanit si adhurim, atmosferës si festë kulturore dhe studimet rreth tij si vlerë intelektuale. Tradita myslimane shqiptare me përgjegjësi dhe dashuri e ka kuptuar peshën universale të Ramazanit dhe është munduar që nga kjo traditë të strukturojë kulturën dhe mënyrën e jetesës së tij. Muaji Ramazan ishte një muaj të cilin mbarë Shqipëria e priste me respekt. Por, diçka më e thellë dhe më me peshë se kjo ishte se tri ditët e fundit para Bajramit për dyqanxhinjtë dhe besimtarët e pasur ishte periudha e regjistrimit të mallit, që në fakt, ka qenë përgatitja për

Tri ditët e fundit para Bajramit për dyqanxhinjtë dhe besimtarët e pasur ishte periudha e regjistrimit të mallit, që në fakt, ka qenë përgatitja për dhënien e zekatit dhe sadakatul-fitrit, andaj gjatë këtyre ditëve, rrugët e qyteteve ndriçoheshin me llamba vajguri.

dhënien e zekatit dhe sadakatul-fitrit, andaj gjatë këtyre ditëve, rrugët e qyteteve ndriçoheshin me llamba vajguri.¹

Ramazani krahas ndikimit në jetën kulturore e organizative të shqiptarët, ishte edhe objekt studimi e hulumtimi nga dijetarët e hoxhallarët tonë. Ishte shkak për ngritje intelektuale, edukative e shkencore të elitës sonë kombëtare e fetare. Në funksion të shpërfaqjes së kontributit



intelektual të dijetarëve tonë për Ramazanin, është edhe kontributi i madh i hafëz Ali Korçës.

Hafëz Ali Korça lindi më 5 prill të vitit 1873 në Korçë dhe vinte nga një familje e njohur intelektualësh. Fillimisht shkollohet në Korçë, ku në moshën 12 vjeçare arrin të bëhet hafëz i Kuranit dhe të mësojë gjuhën turke. Shkollimin universitar e kreu në Stamboll, ku krahas gjuhëve që njihhte arriti të mësoi gjuhën arabe,

perse dhe frënge, si dhe të njihet më pasurinë shkencore të autorëve klasik, dituri të cilat i shfaqti gjatë shkrimeve dhe publikimeve të tij të mëvonshme.²

Hafëz Ali Korça, përveç që ishte intelektual e personalitet i kohës, ai ishte i angazhuar vazhdimisht edhe në çështjen kombëtare dhe në jetën organizative fetare. Ishte në pozita të ndryshme shtetërore e shoqërore, që nga pozita këshilltar për çështje arsimore në Ministrinë e Arsimit (v. 1914), pastaj kryemyfti në Këshillin e Naltë të Sheriatit në Shkodër (v. 1916), si dhe kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit në Tiranë (v. 1918), ku së bashku me kolegë hapi Medresenë e Tiranës.³ Hafëz Ali Korça përveç kontributit të tij kombëtar e fetar dha kontribut të jashtëzakonshëm edhe në publicistikën shqipe. “Abetare”, “Alfabeti arabisht”, “Myslimania”, “Treqint e tri fjalët të Imam Aliut”, “Kur’ani i Madhnueshim e Thelbi Tij”, “Shtat ëndrrat e Shqipërisë”, “Mevludi 1909-1923-1944”, “Historija e shënjtë edhe katër Halifetë”, “Bolshevizma çkatërimi i njerëzimit”, “Publicistikë dhe shkrime të tjera në revistat Zani i Naltë dhe Kultura Islame”⁴, janë vetëm disa nga kontributet e jashtëzakonshme intelektuale të hoxhës, hafëz Ali Korça, në kuadër të së cilave e trajton shpesh herë edhe çështjen e Ramazanit.

Trajtimi i Ramazanit në revistën “Zani i Naltë” nga hafëz Ali Korça

Hafëz Ali Korça, shumë çështje kombëtare e fetare krahas trajtimit në librat e tij autorial, i ka trajtuar edhe në revistat e kohës, në veçanti në revistën “Zani i Naltë” dhe “Kultura Islame”. Revista “Zani i Naltë” është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, themeluar në vitin 1923, menjëherë pas ngritjes së institucionit të Komunitetit

...agjërimit, përveç si adhurim i jepet rëndësi e madhe edhe si instrument për kontrollin e nefsit, egos, dhe për vlerën që ka në moralizimin e besimtarit...

Mysliman të Shqipërisë, pas Kongresit të parë. Botimi i saj ka zgjatur nga viti 1923 deri në vitin 1939.⁵

Hafëz Ali Korça në revistën “Zani i Naltë” i ka dy trajtesa të mrekullueshme sa i përket çështjes së reflektimit mbi Ramazanin. “Hytbe e Ramazani Sherifit”, është shkrimi i publikuar në numrin 6/1924, të kësaj reviste, ku hafëz Aliu trajton disa elemente qenësore të agjërimit. Kjo hytbe që në fillim i drejtohet besimtarit për dashurinë e madhe që ka Zoti i Madhërishëm ndaj tij si “mu’min” si dhe në të njëjtën kohë për dashurinë e pa kushte që duhet ta ketë besimtari ndaj Zotit të Madhërishëm. Pastaj trajtohet aspekti historik i agjërimit dhe qëllimi fisnik i agjërimit për ta ndritur aspektin shpirtëror të besimtarit dhe për ta ofruar më shumë të Zotit. Po ashtu, agjërimit, përveç si adhurim i jepet rëndësi e madhe edhe si instrument për kontrollin e nefsit, egos, dhe për vlerën që ka në moralizimin e besimtarit, duke e larguar atë jo vetëm nga pija e ngrënia, por edhe nga fjala dhe vepra e ndaluar. Hafëz Aliu, në këtë hytbe, rëndësinë e agjërimit e nxjerr edhe në aspektin e drejtësisë sociale dhe solidarizimit me të tjerët. Ai në paragrafin përmbyllësh të kësaj hytbe, u drejtohet besimtarëve duke tërhequr vëmendjen për urtësitë e mëdha të agjërimit dhe kujdesin ndaj njëri-tjetrit. “Hazreti Jusufi a.s. në vjetët e zisë gjer mos ngopte të varfrit t’urët, vetë s’futte bukë në gojë. Ne,

vallë a i mendojmë të varfrit që agjërojnë pa bukë?”⁶

“Mirë se erdhe hënëz e uruar” është shkrimi i hafëz Aliut, i botuar në numrin 1/1929, të revistës “Zani i Naltë”. Autori në këtë shkrim shpreh gëzimin ndaj ardhjes së muajit të Ramazanit, duke e quajtur si hënëz e uruar dhe duke i uruar mirëseardhje, “Mirë se vjen hënë e agjërimit! Ti po vjen si një dhuratë qiellore e dërguar nga ana e Zotit, duhet të pritët me nderime të nalta, duhet pritët me buzë të qeshur e me krahë hapët.”⁷ Që në fillim të kësaj teme autori bën fjalë për kategoritë e njerëzve që do t’i gjejë Ramazani i posa ardhur. Ndër këto kategori, ai thekson varfanjakët, gratë e veja, të vdekurit dhe shumë të tjerë, të cilët presin mësimin dhe porosinë e lartë të agjërimit për solidaritet, ndihmë, durim dhe gjithë ato urtësi që përfshinë ky muaj.⁸

Trajtimi i Ramazanit në revistën “Kultura Islame” nga hafëz Ali Korça

Revista “Kultura Islame” ka qenë botim filozofik, letrar, moral e shoqëror i Komunitetit Mysliman Shqiptar, me drejtor përgjegjës z. Sadik Bega, e cila e ka mbuluar një hapësirë kohore nga 1 shtatori i vitit 1939 e deri në janar-shkurt të vitit 1946.⁹ Pas ndërprerjes së punës dhe veprimtarisë së revistës “Zani i Naltë” për hafëz Ali Korçën vazhdon të mbetet muaji i Ramazanit tema më interesante që e preokuponte ku edhe vazhdoi t’i botoi shkrimet e tij në revistën “Kultura Islame”.

“Rreth hënës së Ramazanit” është artikulli i botuar në numrin e muajit shtator – tetor 1940, në revistën “Kultura Islame”¹⁰, i cili vazhdon edhe në numrat e tjerë. Në këtë shkrim hafëz Aliu, ndriçon pjesën historike të jetës para islame arabe. Po në këtë studim prek interesimin arab të hershëm për astronominë. Në këtë kontekst, duke përshkruar jetën

e vështirë të shkretëtirës së thatë e të mundimshme, arabët gjatë udhëtimeve me karvanët e gjatë tregtar, orientoheshin përmes yjeve. Në vijim vë në dukje se astronomia morri hovin e zhvillimit me mësimet kuranore.¹¹ Nga analiza e thellës që i bënë kësaj çështje, hafëz Aliu, bënë thirrje dhe na e kujton detyrimin fetar për studimin e shkencave natyrore dhe astronomike. “Kur’ani e detyroi besnikun e vet të studioi kartën e qiellit që me anën e saj të kuptojë madhërinë e pashembullt të Zotit dhe me anë të kësaj të njoh kohën, të dijë hisabet dhe të udhëtojë.”¹²

“Rreth hënës së Ramazanit” është vazhdim i artikullit paraprak. Ky artikull është botuar në numrin e muajit nëntor të vitit 1940, në revistën “Kultura Islame”.¹³ Në këtë pjesë, hafëz Aliu, konstaton përmes llogaritjeve numrin e ditëve të vitit diellor prej 365 ditësh dhe atij hënor prej 354 ditësh, duke konstatuar lëvizjen prej 11 ditësh për vitin hënor. Në këtë pjesë të trajtimit janë dy specifika, e para që është llogaritje e detajuar matematikore e kohore, flet për kohën, klimat, zonat kohore, muajt e përlogaritje të ndryshe që lidhen me këto kategori, që në fakt edhe sot është problem t’i dimë. Ndërsa pjesa e dytë e shkrimit është fikh, jurisprudencë islame, por që përfshinë trajtesa jo pak të komplikuar, e cila sistemohet në formën pyetje-përgjigje.

Tejet i rëndësishëm është fakti se çka e shtyu hafëz Ali Korçën t’i hyjë kësaj teme aq të komplikuar, ku shkakun e sqaron në artikullin e botuar me titull “Shkaku i artikullit rreth hënës së Ramazanit”, në po këtë revistë, numër. 6/1941. Hafëz Aliu thekson arsyen që e shtyri t’i hynte kësaj pune me vlerë për sistemin kalendarik islam shqiptar, e që ishte ofendimi që i bëri një i ri, i cili kishte deklaruar se “hoxhallarët s’kuptojnë asgjë nga astronomia përveç disa fjalëve arabisht”. Ky rast, si duket, e detyroi që ai t’i hynte kësaj çështjeje në mënyrë shumë të hollësishme. Në



vazhdim të punimit theksohen emrat dhe nivelet e yjeve përmes të cilave bëhet njehsimi i kohës.¹⁴ Fatkeqësisht, me këtë formë nënçmimi ballafaqohen edhe sot hoxhallarët e fetarët, por, fatbardhësisht e kemi modelin se si duhet të reagojmë në raste të tilla duke e pasuar shembullin e hafëz Ali Korçës.

“Ç’është agjërimi dhe përse na u bë farz” është shkrimi i radhës i hafëz Aliut i botuar në revistën “Kultura Islame” për muajin tetor 1941. Në këtë vazhdim autori i qaset citatit të Kuranit që i referohet agjërimin, “O ju të cilit keni besuar, ju është bërë obligim juve agjërimi, sikur se për ata që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare, 183). Po ashtu janë prekur temat vitale ndërmjet agjëruesit dhe agjërimin si detyrim i dorës së parë, si dhe shumë tema të tjera.

Përfundim

Kombi shqiptar në mesin e vet ka pasur dijetarë e hoxhallarë të mëdhenj të cilët kanë dhënë kontribut të madh si në çështjen kombëtare e po ashtu edhe në çështjen fetare, letrare e shkencore. Trajtimet të cilat ua kanë bërë dijetarët shqiptar çështjeve të rëndësishme islame dëshmojnë për mishërimin dhe lidhjen e fuqishme që ka pasur dhe vazhdon të ketë identitetin ynë kombëtar dhe fetar. Po

ashtu ky kontribut dëshmon edhe për kulturën e thellë islame në kombin dhe në gjeografinë tonë shqiptare. Besoj fuqishëm se është detyrim yni intelektual të nxjerrim në dritë kontributin e dijetarëve tonë si dëshmia më e mirë e pajtueshmërisë së plotë ndërmjet identitetit tonë kombëtar e fetar. Kontributi i tyre dhe shpërfaqja e punës së madhe të tyre, neve gjeneratës së këtij shekulli të ri, na bëjnë krenarë me identitetin tonë shqiptar dhe mysliman.

1. Bardhi, Ismail, “Amanet Ramazani” Sh.B. “Logos-A”, Shkup, 2019, fq.12. 2. Ismaili, Ahmed, “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra” vepra 1, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 33-34. 3. Enciklopedi “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame” Komuniteti Mysliman Shqiptar, Tiranë 2012, fq. 26. 4. Ismaili, Ahmed, “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra” vepra 1, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 11. 5. “Zani i Naltë” Organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë” Sh.B. “KMSH”, themeluar në vitin 1923. 6. Korça, Ali, “Publicistikë dhe shkrime të tjera” vepra 12, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 34. 7. Korça, Ali, “Publicistikë dhe shkrime të tjera” vepra 12, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 163. 8. Ismaili, Ahmed, “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra” vepra 1, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 314. 9. “Kultura Islame” Organ i KMSH-së, përmbledhja e riprodhuar, Sh.B “ALSAR”, Tiranë, fq. 2. 10. “Kultura Islame, shtator - tetor” Organ i KMSH-së, përmbledhja e riprodhuar, Sh.B “ALSAR”, Tiranë, fq. 33. 11. Ismaili, Ahmed, “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra” vepra 1, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 314. 12. Korça, Ali, “Rreth hënës së Ramazanit”, “Kultura Islame – shtator, tetor”, përmbledhja e riprodhuar, Sh.B “ALSAR”, Tiranë, fq. 33. 13. “Kultura Islame, nëntor” Organ i KMSH-së, përmbledhja e riprodhuar, Sh.B “ALSAR”, Tiranë fq. 59. 14. Ismaili, Ahmed, “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra” vepra 1, Sh. B. “ALSAR”, Tiranë, fq. 316.

Agron M. Rexhepi, MD, MSc, PhD

Agjërimi nga aspekti mjekësor

Krijesa njeri përbëhet nga komponentët truporë (komponenta fizike) dhe shpirtërorë (komponenta psikike). Mirëqenia e këtyre dy komponentëve padyshim që është domosdoshmëri e një shëndeti të mirë. Vetëm në një trup të shëndetshëm do të kemi një shpirt të shëndetshëm, e kur këto dy komponentë të jenë të ekuilibruar, atëherë edhe njeriu do të jetë i pranueshëm për shoqëri (komponenta sociale) dhe anasjelltas.

Me argumente shkencore mund të vërtetohet se nuk ka obligim që Zoti i ka bërë njeriut, e ai obligim të mos jetë në tërësi në të mirë të njeriut. Nga aspekti shkencor/mjekësor, me agjërime nënkuptojmë një formë të dietës, e cila karakterizohet me abstenim të përkohshëm nga një lloj, disa lloje apo të gjitha ushqimet. Ndërkaq, agjërimi në Islam nënkupton edhe më shumë se kaq. Në Islam për një kohë të caktuar agjëron e tërë qenia e njeriut (komponenta shpirtërore dhe trupore), agjëron goja, syri, veshi, trupi, mendja, si dhe abstenohet plotësisht për kohë të caktuar nga marrëdhëniet intime ndërmjet bashkëshortëve. Kur është fjala për ndikimin e agjërimit në shëndetin e njeriut, hulumtimet tregojnë se nuk ka qelizë trupore në të cilën agjërimi nuk ndikon. Agjërimi është një pushim/pastrues fiziologjik i organizmin. Këtë dhunti Zoti e ka mbjellë në natyrshmërinë e njeriut.

Prej se ekziston njeriu ka agjëruar në forma të ndryshme, qoftë me qëllim të kryerjes së obligimit që i është bërë nga Krijuesi i tij (në të gjitha religjionet në forma të ndryshme bëhet agjërimi), qoftë për qëllime mjekësore (Hipokrati, Sokrati, Galeni, Paracelsiusi nga kohët e mëhershme, si dhe shumica e mjekëve të tanishëm preferojnë forma të ndryshme të agjërimit si metodë kuruese). Egjiptianët e vjetër kanë agjëruar çdo verë nga dy javë, ndërkaq agjërimi te indianët amerikan është bërë për të rritur aftësitë e

Hulumtimet tregojnë se nuk ka qelizë trupore në të cilën agjërimi nuk ndikon.

Agjërimi është një pushim/pastrues fiziologjik i organizmin. Këtë dhunti Zoti e ka mbjellë në natyrshmërinë e njeriut.

gjuetisë. Hipokrati, Sokrati dhe Platoni, për qëllime shëndetësore kanë bërë agjërimi dhjetë ditore. Pitagora ka praktikuar të agjëroj nga 40 ditë, si dhe i ka nxitur studentët e vetë që të agjërojnë. Galeni, Paracelsiusi po ashtu kanë preferuar praktikën e agjërimit si metodë shërimi.

Janë bërë shumë hulumtime shkencore që në tërësi kanë dhënë rezultate të njëjta. Mjafton të përmendim hulumtimin e doktorit amerikan Herbert Shelton, i cili për 50 vjet ka hulumtuar ndikimin e agjërimit në mbi 40000 persona. Lidhur me ndikimin e agjërimit në shëndet, dr. Shelton ka botuar librin: “Shkenca dhe arti i bukur i agjërimit”.

Dr Shelton ka studiuar proceset e ndryshme vetëshëruese të organizmit,

si p.sh. ndikimi i etheve në ngritjen e metabolizmit dhe forcimin e organizmit në shkatërrimin e mikroorganizmave patogjen (prandaj nuk duhet që me shpejtësi menjëherë të luftohen/ndalohen ethet). Sipas dr. Shelton, gjëja apo veprimi më i mirë që duhet bërë pasi të sëmuremi është të ndërpresim të ushqyerit dhe të pushojmë.

Dr. Alexis Carrel (fitues i çmimit Nobel në mjekësi - 1940), në librin e tij “Njeriu, ky i panjohur” thotë: “Gjatë agjërimit shpenzohen dhjamërat dhe lëndët e tepërta të depozituara në trup, e më pas këto zëvendësohen me të reja, kështu ndodh një ripërtëritje në trup.”

Dr. Ehret ka thënë: “Pas 21 ditë agjërimi me ujë, do të bëhet pastrimi i organizmit dhe ngritja e funksioneve mentale.

Sipas dr. Et'har, gjatë namazit të taravisë mund të shpenzohen deri në 200 kcal. Nëse kësaj ja shtojmë edhe namazet e tjera brenda ditës, aktivitetin tjetër fizik brenda ditës, si dhe zvogëlimin e energjisë hyrëse (marrja e kujdesshme e ushqimit në dy pjesët e ditës), shumë lehtë mund të arrijmë një shpenzim ditor të kalorive prej 500-1000 kcal, respektivisht shpenzim javor prej 3500-7000 kcal që në gramazh d.m.th 0.5-1 kg humbje e peshës trupore brenda një jave. (Rexhepi, 2010)

Dr. Nouman ka vërtetuar se agjërimi gjatë Ramazanit shkakton një ngritje të shënuar të kolesterolit me dendsitet të lartë (HDL) dhe



zvogëlon kolesterolin me densitet të vogël (LDL), si dhe trigliceridet.

Mekanizmi i ndikimit të agjërimit në shëndetin e njeriut ende nuk është plotësisht i shpjeguar, por mund të potencohen tre mekanizma të njohur deri më tani:

1. Aktivizimi i procesit të AUTO-FAGISË (Yoshinori Ohsumi);

2. Ekonomizimi i punës së shumë organeve të organizmit;

3. Stimulimi i punës së SNQ (hipersekretimi i eukefalinës, endorfinës);

1. Procesi i autofagisë nënkupton “vetëngrënien” e komponentëve të dëmtuara të qelizave të organizmit, në çmënyrë organizmi duke i eliminuar komponentët e dëmtuara dhe të dëmshme për mbarë funksionimin e qelizës si njësi themelore, bënë vetë pastrimin e brendshëm të organizmit. Shpjegimin më të mirë të këtij procesi e ka dhënë biologu i njohur japonez Yoshinori Ohsumi, për çfarë edhe është shpërblyer me çmimin Nobel (2016). Ohsumi me bindje të thellë e thekson ndikimin e praktikës së agjërimit në nxitjen e procesit të autofagisë. Sipas tij, koha e nevojshme e agjërimit për “fillimin” e këtij procesi është individuale dhe sillet nga 12-24 orë agjërimit, e në disa raste mund të nevojiten edhe 48 orë. Mekanizmi/procesi i autofagisë deri më tani mund të merret si shpjegimi më i logjikshëm i ndikimit të agjërimit në shëndetin e njeriut (Ives, 2018; Davis, 2021).

2. Ekonomizimi i punës së organeve të organizmit. Agjërimit ndikon në sistemin nervor vegjetativ duke e zvogëluar aktivitetin e sistemit nervor autonom simpatic. Si rezultat zvogëlohet metabolizmi bazal si dhe frekuenca e zemrës, po

ashtu shkaktohet një zgjerim (vazodilatacion) i lehtë i enëve të gjakut me çrast vije deri te një rënie e lehtë e shtypjes së gjakut;

3. Ndikimi i agjërimit në sistemin nervor qendror bazohet në lirimimin e dy mediatorëve të fuqishëm: eukefalina dhe endorfina që kanë ndikim të fuqishëm në funksionimin e sistemit nervor dhe në gjendjen e përgjithshme shpirtërore.

Hulumtimet tregojnë se agjërimit ka ndikim në tërë organizmin, por ne do të përmendim disa prej tyre:

-Shkrirjen e masës dhjamore dhe detoksifikimin e organizmit (me shkrirje të masës dhjamore lirohen dhe largohen toksinat e deponuara më herët);

-Përmirëson gjendjen e depresionit, i ngadalëson problemet e Alzheimerit dhe Parkinsonit;

-Sistemin kardiovaskular, zvogëlon punën e zemrës për afërsisht 13000-14000 të rrahura në ditë, zvogëlon metabolizmin bazal dhe bënë zgjerimin e enëve të gjakut (Samudera, 2020);

-Zvogëlon punën e mëlçisë për 5-6 orë në ditë;

-Zvogëlon nivelin e lipoproteinave me densitet të ultë (në popull e njohur si kolesteroli i keq);

-Ka ndikim qetësues te sindroma e zorrëve të irrituara;

-Ka ndikim lehtësues te sëmundjet reumatizmale dhe artritet;

-Duke e fuqizuar epshin seksual ndikon në tejkalimin e problemeve të impotencës;

-Te një numër i madh i sëmundjeve malinje ka treguar ndikim inhibues dhe shkatërrues në zhvillimin e qelizave malinje;

Meqenëse qëllimi i agjërimit është të fuqizohet shëndeti psiko-fizik i njeriut, ka disa raste kur nuk preferohet:

-Çdo person i sëmur, tek i cili agjërimit do të ndikoj në shtyrjen e procesit të shërimit apo përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore;

-Sëmundjet malinje të mëlçisë;

-Shtatzënat dhe lehonat.

Gjatë agjërimit duhet kushtuar rëndësi marrjes së mjaftueshme të lëngjeve (30ml/kg + 10-12% e peshës trupore), si dhe marrjes së ushqimit të shpërndarë në disa racione. Ushqimi duhet të merret në sasi të pakët dhe shpesh. Në iftar, mos të ngarkohet organizmi me ushqime të shumta dhe hiperkalorike, mjafton të prishet agjërimit me 1-2 gota ujë dhe 1-3 hurme, të pihet një supë dhe të hahet një sallatë. Pas namazit të teravive të hahet darka që i përgjigjet drekës kur nuk jemi agjërueshëm, ndërkaq për syfyër preferohet kos (apo tambël) me drithëra. Gjatë syfyrit nuk preferohet çaji i zi, i gjelbër, i bardhë, kafja, dhe as ëmbëlsirat. Nga iftari në syfyër t'i kushtohet rëndësi marrjes së mjaftueshme të lëngjeve, pemëve dhe perimeve (por duhet pasur kujdes kohën kur merren dhe përzierjen e tyre – për shkak se mund të japin shqetësime dhe probleme në tretje).

Sa i përket agjërimit te sportistët, nëse ka mundësi kishte me qenë më mirë që ushtrimet e lehta të bëhen pas dite, ndërsa ushtrimet me intenzive të bëhen pas iftarit. Të ushqehen dhe hidratohen si duhet dhe nuk do të kenë asnjë problem as me shëndet e as me performancat e tyre morfo-funksionale. Këtë e kanë vërtetuar hulumtimet serioze të bëra nën mbikëqyrjen e FIFA-së.

Referenca:

- Davis, P.Ch. (2021) How long do you need to fast for autophagy? *MedicineNet*. Qasja në: https://www.medicinenet.com/how_long_do_you_need_to_fast_for_autophagy/article.htm Ives, L. (2018) Can the science of autophagy boost your health? Qasja në: <https://www.bbc.com/news/health-44005092> Rexhepi, A. *Nutricioni dhe sportistët*, Prishtinë, 2010. Samudera, S.W., Fernandez, V.G., Fitriyah, R. (2020) The Benefits of Fasting to Improve Health Conditions and to Prevent Cardiovascular Disease. January 2020, *Jurnal NERS* 14(3):383, DOI:10.20473/jn.v14i3.17168

Prof. ass. dr. Musa Vila

Monopoli dhe spekulimi në çmime

Sheriati islam e ka ndaluar kategorikisht monopolin. Pejgamberi a.s. për këtë ka thënë: “Nuk depoziton përveçse mëkatari.”

Feja islame e ka ndaluar monopolin duke nxitur konkurrencë në mesin e tregtarëve dhe ruajtjen e ekuilibrit në ofertë dhe kërkesë. Feja islame inkurajon për shpenzime dhe prodhim duke ruajtur vazhdimësinë e ofertës, stabilitetin e çmimit dhe likuidimin e krizave rrënjësisht.

Ma'mer ibën Abdilahu tregon se Resulullahu a.s. ka thënë: “Nuk bën monopol përveçse gabimtar.”¹

Fjalët e panjohura

Nocioni الإحتكار – ihtikar rrjedh nga fjala *el-hiker*, që d.m.th. padrejtësi. Kuptimi është: e ka blerë, e ka fshehur, e ka izoluar për t'u pakësuar dhe për t'u shtrenjtuar. Themi *ihtekere ta'ame*, pra e ka izoluar, e ka fshehur ushqimin duke pritur që çmimi i tij të rritet. Kjo nënkupton një nocion më të gjerë që quhet monopolizim.

Fjala حَاطِيٌّ (hatiū) ka kuptimin e gabimtarit, mëkatari.

Shpjegimi i hadithit

Hadithi bazë tregon se çështja e monopolizimit është e ndaluar. Nëse kthehemi te mendimet e dijetarëve – fekihëve, do të shohim se ka kundërthënie në atë që konsiderohet ose jo monopol, pastaj cilat janë gjërat ku nuk lejohet monopol apo spekulimi.

Grupi i parë: Pjesa dërrmuese e dijetarëve thonë se monopol përfshin çdo send që është interes i njerëzve. Izolimi i artikujve të tillë

konsiderohet vështirësi për njerëzit, pavarësisht a është ushqim, rroba, ar, argjend ose gjëra të tjera me vlerë. Pra, monopol i çdo sendi është i ndaluar pa bërë përjashtim asgjë prej pasurisë.

Për këtë si argument kemi hadithin: “Kushdo që bën monopol në diçka që ka për qëllim të ngrejë çmimin ndaj myslimanëve, ai është gabimtar (mëkatari).”²

Grupi i dytë: Këta dijetarë mendojnë se monopol ndodh vetëm në atë që është ushqim për njerëzit dhe kafshët. I këtij mendimi është El-Hadevije dhe shafitë.³

Sipas tyre, monopol lejohet në gjëra që nuk janë ushqim. Ky grup dijetarësh çështjen e monopolit e kufizojnë me ushqimin e njerëzve dhe kafshëve, ngase këtu është urtësia e ndalimit të monopolit për shkak se kemi të bëjmë me një të keqe që u bën dëm njerëzve në përgjithësi. Njerëzit dëmtohen pikërisht nga monopol i ushqimit të tyre dhe të kafshëve, ndërsa për

monopole të tjera nuk konsiderohet dëm. Hadithet e përgjithshme këta dijetarë i kanë kushtëzuar me shkakun e dëmtimit, e në këtë rast është ushqimi.

Grupi i tretë: Dijetarët e këtij grupi mendojnë se monopol është i ndaluar vetëm në gjërat ushqimore për njerëzit. Ajo që nuk është ushqim për njerëzit lejohet të bëhet monopol. Ajo që nuk është ushqim, por është e nevojshme për njerëzit, tek ajo lejohet monopol. Këtu hyn edhe ushqimi i kafshëve, që konsiderohet monopol i lejuar. Ky grup, hadithet e përgjithshme i kanë kushtëzuar me veprimin e sahabit që është transmetues i hadithit bazë.

I është thënë Seid ibën el-Musejibit se ti po bën monopol, por ai është përgjigjur se edhe Ma'mer bin Abdullahu⁴ ka bërë monopol.

Ibën Abdul Berri ka thënë: “Ata të dy kanë bërë monopol në vaj.”

Këta të dy hadithin e kanë kuptuar se ka të bëjë me monopolin e ushqimit në rast nevojë e jo në gjëra



të tjera. Të këtij mendimi janë edhe Ebu Hanife dhe Shafiu.⁵ Sipas tyre monopoli është në gjëra ushqimore, ndërsa vaji nuk është ushqim i drejtpërdrejtë.

Ajo që mund të konkludohet nga këto tre grupe dijetarësh është se mund të themi se monopoli është i ndaluar në çdo gjë për të cilën njerëzit kanë nevojë. Shkaku i ndalimit të monopolit është se njerëzit dëmtohen në nevojat e tyre. Kështu që çdo gjë që prek dhe dëmton nevojat e njerëzve, pavarësisht a është ushqim i tyre apo i kafshëve, veshje, ari, argjend konsiderohen monopol dhe një gjë e tillë është e ndaluar.

Kemi raste kur njeriu nga frytet e tokës së tij, një pjesë të të korrave e depoziton për nevoja familjare për një vit, atëherë ky depozitim nuk futet nën ombrellën e monopolit. Po ashtu nëse personi importon një produkt nga jashtë vendi, që nuk i shkakton dëm vendasve të tij, një gjë e tillë nuk konsiderohet monopol.

Hadithi bazë konsiderohet prej haditheve që në fillim u mungon transmetuesi, *sahabiu الْمُعَلَّقَاتُ*. Ashtu siç e transmeton Imam Muslimi në "Sahihun" e tij nga Seid bin Musejhib.

Depozitimi i pasurisë (monopoli)

Me depozitim të pasurisë (monopol) nënkuptojmë blerjen e artikujve dhe depozitim të tyre që ato të pakësohen ose të mos gjenden në treg në mënyrë që njerëzit të privohen nga ato dhe kjo të nxitë ngritjen e çmimit. Kështu tregtari arrin të fitojë shumëfish më tepër se fitimi normal.

Kjo dukuri e shëmtuar zhvillohet me ngritjen e çmimeve nga sanksionet që bëjnë depozituesit ndaj konsumatorëve. Po ashtu, mund të zhvillohet nga një grup i vogël biznesmenësh, të cilët artikujt i kufizojnë për biznesmenë të caktuar dhe përmes kësaj ata arrijnë të monopolizojnë dhe të rrisin çmimet, e në anën tjetër largojnë konkurrencën në treg.

Sheriati islam e ka ndaluar kategorikisht monopolin. Pejgamberi a.s. për këtë ka thënë: "Nuk depoziton përveçse mëkatarin."⁶

Në thënien tjetër të Pejgamberit a.s. thuhet: "Dhënësi është i furnizuar, ndërsa depozituesi është i mallkuar."⁷

Në të dy hadithet e lartcekura shihet qartë se kush është mëkatar dhe i mallkuar, edhe vepra e tyre është e ndaluar. Shkaku i ndalimit është i qartë, ngase dëmi bie mbi konsumatorët dhe nuk ekziston ndonjë ekuilibër ndërmjet çmimit dhe artikujve. Këtu kemi edhe një rregull që përfshin të gjitha shitblerjet, e që për burim ka fjalën e Pejgamberit a.s.: "Mos i bëj dëm vetes e as mos u bëj dëm të tjerëve."⁸

Kështu që në ato raste ku i bëhet dëm vetes dhe të tjerëve, edhe vepra që është shkak për to mbetet e ndaluar.

Të ndaluarit e monopolit rezultojnë në pengimin e krizave ekonomike. Ky ndalim pengon shfrytëzimin e nevojtarëve, dominimin dhe monopolin, rritjen astronomike të çmimeve, pengon krizat ekonomike dhe kriminalitetin në ekonomi, duke mos i lënë tregtarët të realizojnë interesat e tyre me fitime kolosale.

Monopoli në gjërat ushqimore

Monopoli nuk përcaktohet vetëm në gjërat ushqimore, por përfshin çdo gjë që magazinohet dhe u shkakton dëm njerëzve. Dijetarët islamë këtë problem e kanë zgjidhur përmes stabilizimit të çmimeve, duke u imponuar tregtarëve çmime të caktuara ku as tregtari e as konsumatori nuk mbetet i zhgënjyer.

Ibën Kajimi ka thënë: "Tregtarëve duhet t'u caktohen çmimet dhe mos të shesin përveçse sa u takon, e as të mos blejnë përveçse sa u takon. E nëse i lejojmë ata të shesin dhe të blejnë sipas qejfeve të tyre, kjo do të konsiderohej mizori për njerëzit, mizori për shitësit dhe mizori për blerësit." Pastaj tha: "Konkluzat e kësaj çështjeje është që interesi

shoqëror të dominojë me vendosjen e çmimeve reale, të drejta pa nënçmim dhe përbuzje."⁹

Nëse artikulli ka çmimin e vet normal dhe tregtarët bëjnë marrëveshje për monopolizim të tij, atëherë përgjegjësia i bie Ministrisë së Tregtisë. I mbetet obligim asaj të ndërhyjë dhe t'i detyrojë tregtarët që artikullin e përbashkët ta shesin me çmim real ose të parashohë masa ndëshkuese që do t'i detyronin tregtarët të shisnin pa i shfrytëzuar konsumatorët.

Në vazhdim Ibën Kajimi thotë: "Për këtë i takon përgjegjësit (ministrisë) që monopolistët t'i detyrojë që atë mall që kanë ta shesin me çmim të arsyeshëm edhe kur njerëzit kanë nevojë të patjetërsueshme për të. Kjo është e njëjtë edhe për atë që ka rezerva ushqimore dhe njerëzit kanë shumë nevojë për atë ushqim."¹⁰

Feja islame e ka ndaluar monopolin duke nxitur konkurrencë në mesin e tregtarëve dhe ruajtjen e ekuilibrit në ofertë dhe kërkesë. Feja islame inkurajon për shpenzime dhe prodhim duke ruajtur vazhdimësinë e ofertës, stabilitetin e çmimit dhe likuidimin e krizave rrënjësish.

Meqenëse dhënësi dhe ndihmuesi janë të furnizuar e depozituesi është i mallkuar, kjo tregon qartë se çdo fitim që vjen nga monopoli është i ndaluar për arsye se bie në kundërshtim me legjislacionin e Sheriatit islam. Kështu fitimi nga monopoli vishet me mallkim ngase konsumatorët detyrohen të shpenzojnë pasuri pa pëlqimin e tyre, por të imponuar se kanë nevojë për ata artikuj. Këta njerëz monopolistë e tërheqin pasurinë e njerëzve pa të drejtë, pa lejen e tyre dhe në formë përbuzëse. Kjo është e ndaluar nga legjislacioni islam si për konsumatorët ashtu edhe për pronarët e pasurisë.

1. "Sahihu Muslim", vëll. VIII, fq. 313, nr. 3013. 2. "Musned Ahmed", vëll. XVII, fq. 305, nr. 8263. 3. Esh-Shevkani, "Nejlul evtari", vëll. V, fq. 233. 4. Ma'mer bin Abdilah është transmetuesi i hadithit bazë: "Nuk bën monopol, përveçse gabimtarin". 5. Es-Sanani, "Subul s-selam", vëll. III, fq. 25. 6. "Sahihu Muslim", bi sherh En-Nevevij, vëll. XI, fq. 44. 7. "Sunen Ibën Maxhe", vëll. VI, fq. 375, nr. 2144. 8. "El-Mushtedrek ala sahihajn", lil Hakim, vëll. II, fq. 66, nr. 2345. 9. "Et-Turuk el-hikimije fis siase esh sherije li Ibën Kajim", fq. 260. 10. Ibid, fq. 254, 255.

Mr. Driton Arifi

Pasuritë vakëfnore, një aset i çmueshëm investitor

Një fakt të pamohueshëm e afirmon secili vëzhgues real i rrethanave në botën myslimane, se cilido zhvillim, e avancim që ka ndodhur në cilindo vend ku jetuan myslimanët, gjatë cilësdo periudhë historike, një hise të madhe të meritave për të e kanë ata njerëz që ndanë nga pasuria e tyre e çmueshme - lanë vakëfe dhe ia dedikuan ato të mirës së përgjithshme apo interesit shoqëror.

Për të mbetur dobia e pasurisë së tyre vakëfnore e rrjedhshme dhe që produktiviteti i saj të jetë i pandërprerë, juristët islamë përvijuan një mori normash e dispozitash me anë të të cilave justifikuan që një pjesë e të ardhurave të pasurive vakëfnore duhet t'i dedikohet vetë mirëmbajtjes, sanimit e renovimit të atyre pasurive. Kjo madje është ligjësuar edhe nëse një gjë të tillë nuk e ka kushtëzuar fare vakëflënësi. Ky justifikim buron nga rregulli juridik islam që thotë se “ajo gjë - veprim pa të cilën nuk mund të realizohet detyra-obligimi, edhe ajo vetë bëhet detyrë dhe obligim”. Thënë ndryshe,

nëse mëkëmbja e përhershëmëria e pasurisë vakëfnore që është detyrë mbi supet e myslimanëve, nuk mund të realizohet pa bërë ndarjen e një hiseje të përfitimeve nga ajo pasuri për këtë synim, atëherë ndarja e asaj hiseje të pasurisë vakëfnore bëhet detyrë që doemos duhet realizuar. Ky menaxhim e kjo mirëmbajtje është obligim i kujdestarit të vakëfeve, qoftë ai person fizik-individi, apo person juridik, siç janë ministritë gjegjëse të vakëfeve në disa vende të botës islame, apo bashkësitë fetare islame në vende perëndimore, siç qëndron çështja edhe te ne.

Ligjshmëria e investimit të pasurive vakëfnore

Ideja dhe projekti i investimit të pasurive vakëfnore në botën islame shfaqet pak më fuqishëm gjatë viteve të 90-ta, ani pse, raste më të rralla kishte edhe më herët. Prej aty gjejmë edhe disa nisma dhe eksperiencia interesante që për herë të parë në formën më të avancuar e kreative ndoshta u shfaqen në Kuvajt. Veçanërisht aty gjetëm investimin e atyre pasurive vakëfnore që ishin në monedha, por edhe të tjera që ishin

Synimi themelor dhe i drejtpërdrejtë ekonomik i investimit të pasurive, vakëfeve, është produktiviteti dhe rritja e të ardhurave sa më të larta në para



pasuri të patundshme. U krijuan edhe fondet investitore të vakëfeve të cilat përdorshin për investime në fusha të ndryshme ekonomike e zhvillimore. Këto fonde funksiononin në atë formë sa që bëheshin bashkë disa prej të interesuarve për vakëflënie, ata derdhnin një pjesë të kapitalit në një fond të përbashkët investitor dhe të tillat para i përdornin pastaj për qëllime vakëfnore.¹

Por çfarë në realitet është investimi si term ekonomik, apo edhe investimi i pasurisë vakëfnore specifikisht?

Investimi si term ekonomik, që në gjuhën arabe përdoret shprehja (الاستثمار - El-Istithmaru), nuk është se e gjejmë të përdorur po të njëjtin si edhe te juristët klasikë myslimanë. Ata, në vend të tij, i përdornin termet (التَّجْمِيرُ Et-Tenmijetu, التَّجْمِيرُ – Et-Tethmiru, الاستثمار – El-Istinmau, dhe الاستغلال - El-istiglalu). Afërsisht kuptimi tyre është: rritje, zhvillim e shumim i produktivitetit të pasurisë.

Ndërsa, investimi në terminologji të ekonomisë islame nënkupton: përpjekjen për shumim e rritje të burimeve financiare dhe të resurseve humane, në mënyrë që të realizohet fitim dhe produktivitet sa më i madh i kapitalit material dhe njerëzor.² Pra, investimi është akti i shpërndarjes së burimeve, zakonisht parave, me pritjen e gjenerimit të një të ardhure ose fitimit më të mirë prej tyre. Ai ka domethënien e vendosjes së parave apo një aseti me vlerë, por edhe të përpjekjeve, e të kohës në diçka që sjellë një fitim material ose që të ofron një avantazh të caktuar. Në rastin tonë, është për synim që një pjesë e pasurisë vakëfnore të destinohet për qëllime të përfitimit nëpërmes investimit të tyre në projekte profitprurëse.

Që në fillim, mund të konstatojmë se synimi themelor dhe i drejtpërdrejtë ekonomik i investimit të pasurive, vakëfeve, është produktiviteti dhe rritja e të ardhurave sa më të larta në para, aq sa të jetë mundësia, në mënyrë që ato pasuri vakëfnore të ofrojnë shërbime e produktivitet sa më të mirë dhe sa më të shumtë për shoqërinë, për ata të cilëve iu është dedikuar ajo pasuri. Meqenëse

pasuritë vakëfnore në shumë prej vendeve islame përbëjnë një aset të fuqishëm ekonomik-zhvillimor, atëherë duhet pasur parasysh se ato kërkojnë një menaxhment të besueshëm gjithsesi, por dhe që kanë afinitet e profesionalizëm të lartë në fushat ekonomike e zhvillimore po ashtu.³

Format e mundshme të investimit të pasurive vakëfnore

Në parim, është e pranuar ideja e investimit të pasurive vakëfnore, megjithatë duhet kujdesur që investimi të bëhet vetëm nga ajo pjesë e tepërt apo shtesë e saj-suficit buxhetor i vakëfeve, pasi që të jenë përmbushur nevojat apo interesat për të cilat është dedikuar në themel ajo pasuri vakëfnore. Madje shumë prej juristëve islamë ishin këmbëngulës dhe thoshin që nuk lejohet të bëhet deponimi i pasurisë vakëfnore, asaj të tepërtës pra, por duhet bërë investimi i saj në fusha të tjera apo lloje të tjera që do ta shtonin edhe më tej pasurinë e vakëfeve. Ky mendim i atribuohet njëri prej dijetarëve më të mëdhenj të shkollës juridike malikitë, Ibën Maxhishun dhe këtë mendim e mbështesnin edhe shumica e

dijetarëve të Andaluzisë së atëherëshme, por jo vetëm.⁴

Si pikë referencë dhe si argument për ligjshmërinë e lejueshmërisë së investimit të pasurive vakëfnore, juristët islamë marrin kijasin-analogjinë. Ata bëjnë analogji në mes të lejimit të investimit të pasurisë së vakëfeve me lejimin e investimit të pasurisë së jetimëve. Pra, ashtu siç është e ligjshme që kujdestari i pasurisë së jetimit të investojë pasurinë e jetimit nëse dëshiron ta rrisë apo të shtojë atë, gjithashtu në të njëjtin rol është edhe kujdestari i vakëfeve. Ndërsa për rastin e parë, Muhamedi a.s. tha: “Bëni tregti (investoni) me pasuritë e jetimëve në mënyrë që të mos ua konsumojë pasurinë e tyre zekati.”⁵ Pra, kujdestari i jetimit porositet që nëse ka nën kujdestari të tij një shumë të parave mbi nivelin e nisabit-limit minimal mbi të cilin obligohet zekati, e cila në fakt është pasuri e jetimit, ai (kujdestari) le të bëjë tregti me atë pasuri, që së paku atë shumën që e nxjerrë si zekat, t’ia kompensojë jetimit duke tregtuar me të, e duke e investuar në mënyrë që ajo të shtohet e të rritet. E njëjta gjë është edhe me pasurinë e vakëfeve.

Argument tjetër për ligjshmërinë e investimit të pasurive vakëfnore, merret edhe interesi i përgjithshëm (El maslahatu el amme). Interesi i përgjithshëm kërkon që të ruhet pasuria e vakëfit, rritja e të ardhurave



prej tij, në mënyrë që ajo pasuri të vazhdojë që t'i realizojë synimet shoqërore e ekonomike që ndërlihen me të. Kështu, patundshmëria (lokalet afariste-banesat, apartamentet), si pasuri vakëfnore, nëse dëmtohen apo shkatërrohen, logjika e shëndoshë do të na e kërkonte që të ndërrohet dobia-interesi i pritshëm prej saj, me kusht që t'i ruhet natyra e saj vakëfnore. Sepse nëse nuk bëhet ky investim, atëherë ajo pasuri vakëfnore do të mbetet pa kuptim, dhe si pasuri do të shndërrohej në pasuri jo fitimprurëse. Andaj investimi i saj është i kërkuar për të realizuar këtë interes vital.

Edhe Akademia Juridike Islame nxori një vendim që ndërlihet me investimet dhe përfitimet e pasurive vakëfnore, ku ndër të tjera konstatoi që:

- Lejohet investimi i pjesës së tepruar nga përfitimet e pasurisë vakëfnore, në mënyrë që me atë pjesë të suficitit buxhetor të vakëfeve, të shtohet edhe kapitali vakëfnor, apo të rriten përfitimet prej së njëjtës pasuri. Kjo, natyrisht, do të bëhej pas shpërndarjes së përfitimeve të shtresat meritore të asaj pasurie apo institucionet për të cilat është dedikuar, pas heqjes së shumës së shpenzimeve si dhe ato të mirëmbajtjes. Po ashtu, lejohet investimi i atyre të ardhurave vakëfnore, pagesa e të cilave është vonuar (p.sh. sikur nëse një kompleks i lëshuar me qira vonohet pagesa e qirave të tij, atëherë kurdo që qiramarrësi ta paguaj qiranë, ajo shumë e qirasë së vonuar mund të destinohet për investime të lejuara).

- Nuk ka pengesë ligjore që të bëhet investimi i pasurive të ndryshme vakëfnore brenda një sektori investues, apo në disa syresh, natyrisht për qëllime të lejuara sipas Sheriatit.

Po e njëjta Akademi, vendosi edhe disa kriteret apo kushtëzime për të ofruar ligjshmëri për investimet e pasurive vakëfnore. Ato kriteret janë:

1. Që format e investimit të jenë të ligjshme dhe ato të bëhen në fushëveprimtari të lejuara sheriatikisht.

2. Marrja në konsideratë e sferave të investimit, në mënyrë që të

zvogëlohet risku i humbjes së atyre pasurive, si dhe marrja e garancioneve e dokumentimi i akteve të tilla, duke bërë edhe studimin e fizibilitetit të nevojshëm ekonomik për projektet e tilla investitore.

3. Përzgjedhja e mjeteve ose mënyrave më efikase dhe më të garantuara të investimeve, si dhe shmangia e atyre rreziqeve të larta të cilat janë të konstatuara me traditën tregtare investuese.⁶

Nga kriteret e lartshënuara, vihet re kujdesi i juristëve islamë që pasuritë vakëfnore janë ato që duhet në çdo rrethanë të shtohen e të rriten, e në asnjë situatë, të zvogëlohen apo falimentohen. Në realitet, studimin e fizibilitetit të një investimi duhet bërë njerëzit e fushës ekonomike, sepse ata janë të thirrurit që të japin mendim për të.

Si njërin prej investimeve të ligjshme të pasurive vakëfnore, është edhe ai kur një patundshmëri (objekt, lokale afariste, apartamente) ishte pasuri e vakëfeve, por pas një periudhe kohore, të njëjtat janë vjetërsuar, dhe përfitimet nga qiratë e tyre nuk janë të mjaftueshme as për mirëmbajtje të asaj pasurie. Në këso situatash, është e ligjshme që të rrenohet në tërësi objekti i vjetër e të ndërtohet në vend të tij një tjetër i ri. Në rast të pamundësisë që i njëjti të ndërtohet nga pasuria vakëfnore, ai ndërtim do të mund të kontraktohet me një ndërtues-investitor (palë neutrale), i cili më pas do të shfrytëzonte për disa vite disa prej lokaleve të atij objekti pa qira fare, si kompensim të ndërtimit apo kryerjes së punëve të tij.

Një lloj i tillë i investimit për herë të parë është praktikuar në pasuritë vakëfnore të Stambollit, qysh në vitin 1020 (lunar), kur u dogjën një pjesë e madhe e atyre lokaleve dhe përfitimet që rridhnin prej tyre ishin të pamjaftueshme për të mbuluar ndonjë ndërtim të ri, me atë rast juristët e asaj kohe lejuan investimin në formën e lartshënuar.⁷

Një gjë kanë preferuar studiuesit bashkëkohorë rreth investimeve të pasurive vakëfnore, që nëse kujdestari i një parcele –pronë vakëfnore kon-

trakton ndërtimin e një ndërtese në atë tokë, nga një investitor i jashtëm, duhet të përpilohet kontrata në atë formë sa që krejt në fund, ndërtuesit t'i mundësohet marrja e kësteve të ndërtimit të tij me fitim optimal edhe për të, por pa qenë e mundshme që ai, ndërtuesi në atë objekt të bëhet edhe bashkëpronar ose partner. Kjo, ngase toka mbi të cilën është ndërtuar ai objekt, ishte dhe duhet të mbetet tokë vakëfnore, gjithsesi, porse i tillë duhet të jetë edhe objekti që ndërtohet mbi të. Natyrisht edhe ndërtuesi duhet ta ketë hisen e tij të fitimit, por jo të bëhet ortak ose bashkëpronar i asaj pasurie që në fund të fundit është pasuri vakëfnore.

Ekzistojnë edhe shumë mënyra e forma të tjera të mundshme të investimit të pasurive vakëfnore që janë të mirësardhura me kusht që të njëjtat të jenë në fushëveprimtari të lejuara sipas Sheriatit islam, të jenë produktive, pra të shtojnë pasurinë vakëfnore e kurrsesi ta bëjnë të kundërtën.

Vetëm në këtë formë, dhe vetëm me këtë përkujdesje të çiltër, pasuritë vakëfnore do ta ruajnë rolin e tyre civilizues e zhvillimor në shoqëritë islame, ashtu siç e kishin edhe në të kaluarën.

1. Dr. Ibrahim Salih Ebul Ala, *Muhaderat fi el Iktisad ve et Temvil el Islamij* (fq.321). Bot. Xhamiatu El Melik Abdul Aziz, Xhide, 2018.
2. Alij es Semmanij, *Mu'xhem Mustalihat el iktisad el Islamij* (fq.26). Bot. Imam Muhamed Bin Saud Islamic University, Rijad, 2002. 3. Idaretu ve tethmir mumtelekat el Evkaf (fq.186). Libri në fjalë është një mori punimesh shkencore të realizuara nga Inëstituti Islamik për Hulumtime e Trajnime në kuadër të Bankës Islame për Zhvillim. Mblodhi: Hasen Abdullah El Emin. Bot. Banka Islame për Zhvillim, Xhide, Arabi Saudite, 1984. 4. Hasen El Benabu, *Istithmar Emval el Vakf el Islamij*, (fq.131). Punim shkencor botuar në revistën : <https://digitalcommons.aaru.edu.jo/dissat/vol19/iss20/4/> 5. Hadithin e evidenton Imam Maliku në "Muvetta-në" e tij me numër: 863. Megjithatë, zinxhiri transmetues i tij ka dobësi. 6. Mexhel-letu El Mexhma' El Fikh El Islamij, *Vendimi i Akademisë lidhur me çështjen e investimeve në vakëfe dhe përfitimet prej tyre. Numri i vendimit: 140/ (6/15)*. Shih dr. Tahir Kane, *El Mesarif el Islamijje ve devruha fi ref' I el kefaetu el intaxhijje lil mulikijje el vakfijje* (fq. 357-358). Bot. i parë. Daru El H'alixh, Amman, 2018. 7. Idaretu ve tethmir mumtelekat el Evkaf (fq.194). Libri në fjalë është një mori punimesh shkencore të realizuara nga Inëstituti Islamik për Hulumtime e Trajnime në kuadër të Bankës Islame për Zhvillim. Mblodhi: Hasen Abdullah el Emin. Bot. Banka Islame për Zhvillim, Xhide, Arabi Saudite, 1984.

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

Ligjërata si formë e diskursit në dave (2)

Para se të filloj ligjëratën, ligjëruesi duhet të krijoj aty për aty një lidhje emocionale me masën dhe kjo do të krijonte tek ai një qetësi në vete dhe një besueshmëri të lartë dhe po ashtu mos të ketë ndonjë befasi gjatë ligjëratës.

Bazamentet dhe shenjat e ligjëratës

Në pjesën e parë të kësaj teme theksuam se misioni i ligjërimit islam konsiston në përqendrimin e energjisë islame bashkëkohore për të faktorizuar sistemin e vlerave islame për kurimin e problemeve të shoqërisë shqiptare përmes edukimit të brezit të ri, dhe jo vetëm, me cilësitë e domosdoshme islame dhe humane që e bëjnë këtë brez të denjë dhe të aftë për të realizuar me sukses këtë lloj roli. Pyetja madhore që duhet t'i përgjigjet veprimtaria islame në mjedisin tonë shqiptar, është: sa është i aftë produkti i kësaj veprimtarie për përmirësimin e gjendjes së shoqërisë shqiptare?! Kjo pyetje mund të shtrohet ndryshe: sa është e aftë veprimtaria islame për t'i shpëtuar fenomenit të "akuariumit brenda në oqean" dhe për t'u shndërruar në një shiringë që injekton produktin e saj brenda në damarë të

Përzgjedhja me kujdes e literaturës gjatë përgatitjes së ligjëratës dhe të jetë kredibile ngase thirrësi (daiu) mbështetet mbi burime të qarta e të besueshme, të cilat janë në funksion të temës.

shoqërisë, si një ilaç të aftë për të kuruar ashtu siç duhet sëmundjet e kësaj shoqërie?! Për të pasur një produkt të tillë duhet domosdoshmërisht, të ngrihet në nivelin e sfidës dhe qëllimit, që është mënyra e prezantimit të Islamit, pra veprimtaria islame.¹

E para ka të bëjë me përzgjedhjen e temës së përshtatshme, duke u bazuar në mendje intelektuale e shkencore të sistemuara, të cilat shpiten drejt sistemit të sqarimit të idesë që ka objektiv ligjërimit natyrshmërisë dhe trupit. Po ashtu, në këtë sferë ligjërata duhet prek edhe anët e dobisë së kësaj bote, e assesi mos të përqendrohet vetëm në shpërblimet e botës tjetër. Por, të balancohen këto dy interesa të ndjenja e besimitarit dhe me këtë do t'u jepte vullnet e kurajë për të vepruar dhe kontribuar në ndërtimin e kësaj bote dhe drejtimin e saj drejt mirësive dhe drejtësisë. Kjo njëherësh është edhe logjika dhe parimi i vlerave islame: fe dhe dynja. Kuran dhe armë kur e kërkon nevoja të mbrohet vatani. "Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit." (El-Kasas, 77).



Po ashtu në një vend tjetër ka urdhëruar duke na thënë qartë: “E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim.” (El-Xhumua, 10).

Përzgjedhja me kujdes e literaturës gjatë përgatitjes së ligjëratës dhe të jetë kredibile ngase thirrësi (daiu) mbështetet mbi burime të qarta e të besueshme, të cilat janë në funksion të temës, ngase edhe publiku (xhemati) është sot i përgatitur, ngritur në kulturë fetare e jo si më parë.

Vendosja e disa pikave kryesore dhe të vazhdojë të japë sqarime për to, duke patur kujdes shumë që mos të kërcej nga një pikë në tjetër, vetëm se pasi që ta ketë shterur sqarimin për të dhe duke sjellë argumente të bollshme. Qenësore është ta mbajë dëgjuesin dhe fokusin e tij mbi temë dhe mos ta lejoj të shpërqendrohet.

T'i korrigoj tekstet fetare gjatë evidentimit (ajetet dhe hadithet) si dhe mendimet e dijetarëve dhe shkencëtarëve, në mënyrë që të dalë sa ma i plotë dhe mos gabojë në to, sepse përndryshe kjo luhet xhematin dhe mbjellë krizë në besimin ndaj ligjëratës së mbajtur, si dhe mund ta humb krejtësisht vlerën e saj.

Lidhja e ligjëruesit me objektivin, sepse koha është gjë e çmuar dhe askush nuk ka kohë të humb kot. Së këtejmi predikuesi islamë në ligjëratën e tij synon t'i realizoj dy objektiva:

Trajtimi i temës siç duhet që nga titulli në mënyrë që objektivi të arrihet që ata të binden me idenë dhe nënshtrahet argumentit; si dhe

Ringjallja e ndjenjave të cilat janë mbledhur rreth tij dhe ato t'i përçoj te dëgjuesi me faktin se mesazhi i Islamit është i madh dhe njëherësh, duke e potencuar dhe fokusuar se Islami i unifikon diturinë dhe bindjen të besimtarit me veprim dhe shpirt të gjallë e të lëvizshëm.

“A nuk e di ti (o dëgjues) se Allahu di çka në qiej dhe çka në tokë?! Nuk

bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti; e as mes pesë vetave e të mos jetë Ai i gjashti, e as mes pak vetave dhe as në shumë vetave, e të mos jetë Ai me ta, kudo që të jenë. Pastaj, në ditën e kiametit i njofton ata me atë që kanë punuar. Allahu ka përshirë çdo send në dijen e vet.” (El-Muxhadele, 7).

Zemërgjerësia në aspektin e dialogimit, debatit me ata që kanë mendime oponentë, e po ashtu edhe me ata që kërkojnë sqarime shtesë për ndonjë çështje të caktuar, qoftë edhe me kundërshtarët e daves dhe daiut. Kjo ngase zemërgjerësia sjellë të ligjëruesi besimin e masës, ndjenjat dhe respektin ndaj tij.

Para se të filloj ligjëratën, ligjëruesi duhet të krijoj aty për aty një lidhje emocionale me masën dhe kjo do të krijonte tek ai një qetësi në vete dhe një besueshmëri të lartë dhe po ashtu mos të ketë ndonjë befasi gjatë ligjëratës. Ndjenjat janë shtëpi të mbyllura, duhet hapur me qelës të duhur dhe të përshtatshëm.²

Nga ana tjetër, sa më e shkurtër të jetë hytbja dhe sa më shumë kuptime dhe efekte të japë ajo, aq më shumë tregon mençurinë, urtësinë dhe të kuptuarin e thirrësit. Zgjatja dhe stërzgjatja, pompoziteti, kapërcimi sa në një temë në tjetrën..., të gjitha këto janë të papëlqyera në të folur. Njëherë, një prej shokëve të Profetit a.s. filloi të ligjëronte para tij dhe u zgjat. Profeti a.s. i tha: “Hesht ose ulu!” më pas u ngrit Abdullah ibën Mesudi dhe foli, i përmbloodhi fjalët, foli qartë dhe mirë. I Dërguari i Allahut tha: “Ia qëlloi Ibën Mesudi! Ia qëlloi Ibën Mesudi dhe tha të vërtetën.”³

Përdorimi i qëllimshëm i rimës dhe zhytja nëpër librat e vjetër për të nxjerrë prej andej hytbe të rihuara dhe pompoze, nga të cilat njerëzit nuk kuptojnë veçse melodinë e fjalëve dhe zërin që kumbon i rimuar, nuk është aspak një vepër e mençur. Ibën Abasi ka thënë: “Folu njerëzve një herë në javë, nëse nuk pranon, atëherë dy herë, dhe nëse e shton, tri herë. Mos përdor rimë në lutje, por

largohu prej saj, sepse kështu e kam parë të veprojë i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij.”⁴ Ndalimi i ligjërimeve të stërzgatura dhe i rimës ka lidhje me atë që bëhet me sforco, ndërsa patosi ndalohet kur bëhet në kurriz të kuptimit dhe thjeshtësisë së paraqitjes. Nëse rima është e lehtë, e pa sforcuar, nuk i komplikon fjalitë dhe nuk e vështirëson kuptimin, ajo është diçka që i zbuluron fjalët.⁵ Profeti a.s. e ka përdorur diçka të tillë, si për shembull: “Allahume munezil el kitab, seriul hisab, ehzim el-ahzab, ue muxhries sehab.” “O Allah, Zbritës i Librit, i Shpejtë në llogari, ngadhënje mbi klanet, lëvizës i reve.” Po ashtu: “Allahume ini eudhu bike min kalbin la jahsha, ue ilmin la jenfa, ue min nefsin la tushba'." "O Allah, unë kërkoj mbrojtje prej Teje, nga një zemër që nuk frikësohet, nga një dije që nuk vlen, nga një lutje që nuk dëgjohet, nga një vete që nuk ngopet.” Po ashtu: “Kelimetani hafifetani alel lisani, thekiletani fil mizani, habibetani ila Rrahmani, subhanellahil-adhiim, subhanellahi ue bihamdih.” (Dy fjalë të lehta për gjuhën, të rënda në peshore, të dashura për Mëshiruesin, qoftë i Lëvduar Allahu i Madhërisëm, qoftë i Lëvduar Allahu dhe i Falënderuar). Fusha e thirrjes dhe predikimit të Islamit kërkon një qëndrim dhe durim të theksuar, e cila përqendrohet mbi durimin, këmbënguljen në sukses, vetëbesimin dhe vullnetin. Me zotërimin e këtyre cilësive përbën një forcë e cila premtan se do të realizoj objektivin e vet edhe pse ka pengesa dhe sfida të mëdha para vetës. Dhe këto mos t'i harrosh dhe jo gjithsecili mund të qëndroj i palëkundur në këto parime, por të gëzohesh se Allahu të ka zgjedhur ty për bartjen dhe prezantimin e mesazhit të Allahut.⁶

1. Sabahudin Jashari, *Hartë e ligjërimit islam bashkëkohor tek shqiptarët, Ardhmëria, botim i parë, Tiranë, 2020, f.38.* 2. *Tevfik el Vaië, Eddavetu ilall-llah, Daruljekin, botim i dytë, Mensure, 1995, f. 288.* 3. *Es-sahiha, 1225.* 4. *Buhariu, 6337.* 5. *Adnan Alaraur, Ibid., 225-226.* 6. *Xhemal Madi, Ed-davetu el muethire, El Medain lin-neshri ve tevzij, botim i parë, 1995, f.51.*

Harun Shabanaj

Pagëzim a vdekje (3)

Qëndrimi i hoxhallarëve të Deçanit dhe rrethinës ndaj konvertimit me dhunë në ortodoksë

Udhëheqësit fetarë shqiptarë, si ata të fesë islame dhe ata të krishterë, katolikë dhe ortodoksë, asnjëherë nuk u shkëputën nga kontributi i dhënë në shërbim të fesë dhe kombit shqiptar.

Në kohën kur treva e Deçanit ishte pushtuar nga trupat serbo-malazeze, popullsia e kësaj ane dominohej nga besimi islam. Kështu, lufta për ruajtjen e besimit ishte tepër e rëndësishme dhe shumë sfiduese. Popullsia e kësaj ane, sytë i kishte kthyer nga prijësit e tyre fetarë, pasi shpëtimi shihej te ta, kur dihet se nga këto anë tashmë ishin tërhequr edhe ushtritë e fundit të Perandorisë Osmane.

Duke u përballur me një gjenocid të paparë ndaj popullsisë së pambrojtur shqiptare të kësaj ane, prijësit fetarë të Deçanit dhe rrethinës, ishin përgatitur që t'i kundërviheshin kësaj fushate malazeze, që kishte për qëllim shkombëtarizimin e shqiptarëve si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë fetar.

“Po thuaj të gjithë hoxhallarët e Deçanit dhe rrethinës, por edhe më gjerë kishin dhënë mendimin e tyre në lidhje me konvertimin me dhunë. Pasi që nuk kemi mundësi të mbrohemi, duhet që assesi mos ta ndërrojmë fenë, por edhe nëse na pagëzojnë e na kryqëzojnë me dhunë, ne duhet që dëshminë (shahadetin) ta themi me zemër dhe assesi të mos konvertohemi. Shpresojmë se kjo valë e dhunshme shumë shpejt do të ndalet, ngaqë Zoti xh.sh., nuk do ta lejojë një zullum të tillë”.

Shumica e hoxhallarëve të Deçanit ishin në mesin e popullit dhe ballafaqoheshin me format e dhunës

dhe terrorit që ndërmori Mali i Zi. Në turmat, të cilat hynë në kishën e Deçanit, kishte edhe hoxhallarë, ku në mesin e tyre ishin mulla Haxhi Beqiri, mulla Musa i Strellit, mulla Adem Zekaj e mulla Beqir Panxhaj. Këta hoxhallarë për asnjë moment nuk u ndanë nga populli i tyre, të cilin ata e mbronin dhe kujdeseshin për të.

Përveç hoxhallarëve të kësaj ane, objekt i sulmeve serbo-malazeze ishin edhe ndërtesat e xhamive, të cilat në këto anë i kishin qëndruar shekujve me radhë. Krahas xhamive, në shënjestër të pushtetit malazez u vunë edhe mejtepet dhe bibliotekat fetare.

Në shumë raste, ushtritë malazeze vendoseshin nëpër xhami, ku ndiznin zjarre në dyert e minareve dhe aty piqnin derra, madje pinin raki, duke e shndërruar vendin në një papastërti. Në mëngjes, eshtrat e derrave të pjekur i hidhnin nëpër qilimat dhe brendësitë e xhamive.

Natyrshëm që procesi i konvertimit me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë mori përmasa të mëdha, jo vetëm rajonale por edhe më gjerë. Kështu, autoritetet malazeze theksonin para delegatëve të huaj se konvertimi i shqiptarëve bëhej me “vullnet” të popullit. Andaj, qeveritarët malazezë kishin përgatitur edhe deklarata të cilat gjoja ishin të nënshkruara kinse “vullnetarisht”. Pra, këto ishin vetëm makinacione të ulëta që autoritetet malazeze mundoheshin të arsyetoheshin para botës demokratike.

Është me interes të ceket edhe një fakt se pas konvertimit me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë, për shkak të mosdashjes që shqiptarët të kishin

në trupin e tyre pika uji që popët e caktuar iu hidhnin në trup, në shumë dokumente që trajtojnë këtë etapë të historisë, hasim dokumente ku tregohet se shqiptarët pas konvertimit me dhunë, shkonin te përroi apo lumi më i afërt dhe i lanin me ujë ato pjesë ku i kishte rënë uji nga popi. Kishte raste që ato pjesë i fërkonin me rërë derisa përgjakeshin vendet ku i kishte rënë uji nga duart e popëve.¹

Kulmi i gjenocidit serb që u krye ndaj popullsisë shqiptare myslimane të Deçanit dhe rrethinës arriti në fshatin Belle. Sipas të dhënave të një dëshmitari të kësaj masakre, mësojmë se popullsia e këtij fshati kishte përjetuar një dhunë të vërtetë gjenocidale. Kështu, Tahir Istrefaj nga fshati Strellc i Epërm i Deçanit, në një deklaratë dhënë historianit të shquar, Bicaj, në lidhje me këtë, shprehet: “Në kohën e Turqisë, një person i panjohur dhe i paidentifikuar ndonjëherë nga fshati Belle, kishte vrarë një serb në fshatin Bellopoje afër Pejës. Për hakmarrje organet malazeze e rrethojnë një natë gjithë fshatin, e çarmatosin dhe në mëngjes nga çdo familje marrin meshkujt dhe i dërgojnë në stallë të Sahit Bekës. Bile njëri nga fshatarët paska qenë i paralizuar, por me urdhër të komandës malazeze edhe ai është sjellë aty. Nga stalla i kanë nxjerrë jashtë dhe të mbështetur pas murit të oborrit i kanë pushkatuar mbi 40 veta. Pasi i vrasin, kufomat i hedhin në lumin e Bisticës (Lumbardh). Një fëmijë 10-11 vjeçar ka shpëtuar me ndërhyrje të një personi të organeve malazeze, pasi këtij fëmije i kishin vrarë babanë e xhaxhain dhe

në familje nuk kishte mbetur asnjë mashkull. Ky fëmijë ka qenë Hazir Musai i cili vdiq para dy vjetësh.”²

Gjatë punës sime kërkimore në terren, në lidhje me tmerret e përjetuara nga popullsia shqiptare në Belle, kam pasur rastin të takoj Murtez Lulajn nga fshati Belle. Ai tregon për tmerret e nëntë (9) fëmijëve, duke shtuar se: “Plaku Lan Halili me bashkëshorten e tij, Nanën Zaden, për të shpëtuar nga kjo masakër, kishte marrë nëntë (9) fëmijë nga fshati Belle, në mesin e të cilëve kishin qenë edhe tre fëmijët e tyre, Jonuzi, Luli dhe Neziri. Duke u larguar nëpër shkrepë e përroje, kur mbërritën te përroi i Bodoshit, takohen me ushtarë serbo-malazez, të cilët i rrethojnë fëmijët. Në mesin e ushtarëve kishte qenë edhe plaku serb Trif Laza nga Lloqani, i cili gjatë kohës së Perandorisë Osmane kishte pasur lidhje kumarie me një familje në Bellë. Kur fëmijët e shohin Trif Lazen i thonë nënës Zade, mos u tut, se me ta është kumbara Trif Laza. Kur ushtria malazeze i zë të gjallë, i pushkatojnë të gjithë. Gjatë kësaj masakre, mori pjesë edhe kumbara i shtëpisë Trif Laza, i cili gjatë pushkatimit kishte thënë, vriteni që të mos mbijë më fara e tyre. Këta u varrosën në përroin e Bodoshit, dhe sot këtij vendi i thonë, te varret e fëmijëve”.³

Vrasja e fëmijëve dhe grave të pambrojtura, ishte forma më e rëndë dhe më e egër që përjetoj popullsia shqiptare myslimane gjatë kohës së ndërrimit të fesë me dhunë nga ana e ushtrisë malazeze. Tentimi për të çrrënjësuar racën shqiptare, ishte një politikë shtetërore që ndërmorën malazezët dhe serbët ndaj shqiptarëve, por kjo politikë nuk arriti që të jetësohet, pasi e drejta historike ishte në anën e shqiptarëve. Dëshmitë e një egërsie, që ka ndodhur në Belle të Deçanit, janë të shumta. Në lidhje me këtë, Murtez Lulaj, do të shtonte: “Këtë masakër e pa me sytë e tij Sokol Coli, i cili i shpëtoi kësaj tragjedie i fshehur në kaçubë”.⁴

Po ashtu, në Belle të Epërme, sipas dëshmisë së Ismail (Demush) Ahmetajt, ushtritë malazeze pasi hynë në



Një fëmijë shqiptar i veshur me tirq të bardhë, duke u pagëzuar me dhunë nga priftërinjtë serbo-malazez

oborrin e Zeqir Ahmetit, para familjarëve pushkatuan Zeqir Ahmetin, më pas Metë Zymerin e Misin Sahitin, si dhe gruan e Zeqirit, Rabën me tre fëmijët e saj. Po ashtu, Ismaili, kujton se, “pasi e mbushin shtëpinë me tallë, ia fusin flakën dhe Demushi, i cili ishte vetëm pesë-mbëdhjetë (15) vjeç, gjatë aksionit të ushtrisë malazeze ishte fshehur në mal, dhe pas largimit të ushtrisë, shkon dhe hap derën e shtëpisë e cila ishte përfshirë në flakë, dhe i shpëton të gjallë”.⁵

Mizoria e serbo-malazezëve e kryer ndaj shqiptarëve, natyrshëm që do të ngjallte edhe reagimin e personaliteteve të huaja. Ndër ta ishte antropologja angleze, Edith Durham, e cila me shkrimet e saj alarmonte Londrën dhe botën perëndimore për krimet dhe gjenocidin që po kryente ushtria serbo-malazeze kundër shqiptarëve.⁶

Brenda Manastirit të Deçanit

Manastiri i Deçanit, i takon pjesës së trashëgimisë dhe kulturës shpirtërore të shqiptarëve ortodoksë të Deçanit, i cili qysh në kohën e Dushanit ishte pushtuar dhe uzurpuar nga serbët, çka ka bërë që qysh

në mesjetë ky tempull fetar të jetë i robëruar dhe i pushtuar nga serbët, të cilët në periudha të caktuara historike e kanë përdorur këtë vend për të arritur qëllimet e tyre kundrejt shqiptarëve të Kosovës në përgjithësi, dhe deçanasve në veçanti.

Gjatë kohës së fushatës për ndërrimin e fesë së shqiptarëve mysliman në ortodoks, brendësitë e kishave dhe manastireve kanë shërbyer për të kryer ritet fetare të konvertimit.

Edhe sot në popull ruhet një varg poetik, në të cilin një burrë i drejtohet Sava Llazareviqit në oborrin e kishës me këto fjalë:

*Pesqind vjet t'kam sundue
Kurr me zor n'xhami st'kam çue
As kurr fenë sta kam ndrrue.*

Aksioni për ndërrimin e fesë me dhunë për shqiptarët, u bë në kushte shumë të rënda, gjatë dimrit të vitit 1912-1913. Bora e madhe në Bjeshkët e Deçanit, kishte penguar që popullsia vendase të mund të largohej, qoftë në pjesët malore apo edhe në tokat shqiptare. Një numër i madh i burrave vdiqën nga torturat, ndërsa ata të cilët mbetën gjallë u kërcënuan me vdekje. Grave iu hiqeshin mbulesat dhe detyroheshin që të kryqëzoheshin, dhe ajo grua e cila e kundërshtonte kryqëzimin dhe pagëzimin dhunohej nga ushtria

malazeze. Ata të cilët pranonin kryqëzimin, pasi pagëzoheshin, detyroheshin që krahas emrit mysliman të mbanin edhe emrin e ri ortodoks sllav. Madje, u dha edhe urdhri më i hidhur, dhe më i pa pranuar nga popullata, se shqiptarët të cilët konvertoheshin duhet të martonin vajzat e tyre me malazezë.

Në këto rrethana, shumë prindër të cilët i kishin vajzat e rritura i kaploi një situatë e pa përshkruar dhe tepër e zorshme. Këtë situatë e kishte përjetuar edhe Zepe Bardhoshja, e cila në atë kohë kishte qenë vetëm trembëdhjetë (13) vjeç. Ajo, ndër të tjera, në dëshminë e saj tregonte se si burrat komunikonin në atë kohë: “O burrë bëma gati qatë rob, e tjetrit i thoshte, o burrë hajde mere qatë rob. Vajzat e reja shkonin nuse me herrka në krye”.⁷

Nga shumë dëshmitarë të cilët e kanë përjetuar kohën e ndërrimit me dhunë të fesë, kemi arritur që të marrim edhe disa përshkrime se çfarë kishte ndodhur brenda mureve të Manastirit të Deçanit.

Më tej po tregojmë një prej ngjarjeve të ndodhura në Deçan në këtë kohë. Në oborrin e Manastirit të Deçanit, u mblodh popullsia myslimane e fshatrave të Deçanit dhe rrethinës, ku përpara kishte monumentin e kishës dhe pas vetes ushtri të madhe në numër, të cilët ishin të armatosur me pushkë e bajoneta.

Para masës së tubuar në oborrin e Manastirit të Deçanit, ushtaraku famëkeq Sava Lazareviç, ndër të tjera deklaroi: “Ljudi-braço, vëllezër kemi qenë e do jemi për jetë, por na ndau kjo Turqi e mallkuar, na ndau tash e pesë qind vjet. Po tash e mundëm e dëbuam, morëm hak e ju çliruam edhe juve”.⁸

Ky imponim i dhunshëm i detyroi shqiptarët që para syve të tyre të pohojnë një pranim si memecë, të verbër të urdhrave të tyre, ngase kjo formë e pranimit ishte shpëtimi i tyre i vetëm. Përndryshe, nëse nuk pranonin që të konvertoheshin në ortodoks, ata i priste varja në litar, i prisnin edhe bajonetat e plumbat si dhe i priste shuarja nga kjo botë. Disa nga burrat të cilët kishin

autoritet në popull i ndanin nga të tjerët dhe më pas iu prinin popullit për pagëzime. Në mesin e tyre ishte dhe Idriz Beka nga Ratishi i Deçanit dhe Isuf Xhema nga Bardhaniqi.

Idriz Beka, pasi nuk pranoi të konvertohet në ortodoks, e lidhin në trupin e pemës së dardhës në oborrin e Manastirit të Deçanit. Ashtu, e mbajtën të lidhur një javë. Atij i kishin vendosur si kusht ose të hynte në manastir e të puthte kryqin e të pagëzohej, ose e priste vdekja.

Një ditë, Idrizit i sjellin nënën e tij, e cila kishte qenë bijë e familjes së Niman Kuçit të Rakocit. Nëna, pasi e takon djalin, ashtu para vdekjes, iu drejtua Idrizit me këto fjalë: “Idriz loke, pse po të mbajnë kështu të lidhur. Idrizi ia ktheu, oj nënë, po më thonë me hy në këtë kishë e me puth kryqin e me ia puth dorën popit e me ndërrue fenë e me ndërrue emrin, në vend të këtij kapuçi të bardhë me vuc kopicën e Cernagorës. Ani, iu drejtua nëna. Idrizi shtoi se, ma e vogël po më duket dera e kishës se sa bira e gjylpanës.⁹ Jo loke jo, i raftë gurit e drunit, mos koftë thanë prej gojës tanë. Në dorë të Zotit loke. Ajo më pas i vendosi dy duart e veta në gjinjët e saj dhe ju drejtua Idrizit, nëse do me ndrru fenë tanen, hajde pshty këta dy gjinjë të cilët i ke thithë, dhe më pas ajo ia kthen shpinën Idrizit, i cili qëndronte i lidhur për dardhe në oborrin e Manastirit të Deçanit”.¹⁰

Aksioni i ushtrisë malazeze për konvertimin me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë, kishte ngjallur reagimin e shteteve të huaja, pra të Fuqive të Mëdha, dhe kështu pas shumë e shumë presioneve, Mbreti i Malit të Zi, urdhëron ndaljen e kësaj fushate të paprecedentë në histori.

Pas ndaljes së kësaj fushate të egër dhe gjenocidiale, shumë shqiptarë arritën që të kthehen në shtëpitë e tyre.

Si përfundim, duhet theksuar se në Manastirin e Deçanit, u përdorën forma nga më të ndryshme gjenocidiale për të detyruar njerëzit që të konvertoheshin në ortodoksë, që të puthnin kryqin, dhe ngritja e kryqit në tokën e Kosovës, ishte për të

treguar përfundimin e islamit në këto vise.

Kështu, lind pyetja se pse u bë e tërë kjo tragjedi, gjakderdhje e konvertim me dhunë?

Më së miri përgjigjen e kësaj pyetjeje e ka dhënë studiuesja angleze Miranda Viscers, e cila përfundimin e këtyre krimeve e argumenton: “Në të vërtetë popullsia shqiptare po paguante çmimin e rreshtimit të Portës së Lartë kundër Beogradit. Sipas Ivo Banacit, kur mbreti fitimtar Peter viziton Deçanin, pak më vonë, ai ndezi qiriun e stërmadh që duhej ndezur vetëm kur të merrej hak për Betejën e Kosovës. Serbët ishin aq të verbuar, e flakërimin e tokës së ri-gjetur sa që nuk vunë re se shumë pak serb kishin mbetur në “Serbinë e vjetër”, shumica dërmuese e popullsisë tashmë ishte shqiptare”.¹¹

Po ashtu, antropologia e njohur Edith Durham, pas kthimit në Londër nga qëndrimi në tokat shqiptare, do të shkruante:

“Kur arrita në Londër, paketova Medaljen e Artë që ma kishte dhënë Knjaz Nikolla dhe ia ktheva duke i thënë se shpeshherë jam habitur nga disa persona që kanë pranuar dekorata nga Abdyl Hamidi, dhe tani që e di fare mirë se ai dhe njerëzit e tij ishin shumë më barbarë se turqit, kisha arsye të forta të mos e mbaja në dorë dekoratën e tij të lyer me gjak. Këtë ia komunikova edhe shtypit anglez dhe atij austriak”.¹²

1. Ndreca, 97 vjet....f.31. 2. Bicaj, Marrëdhëniet..., f.175. 3. Deklaratë e Murtez (Hazir) Lulajt nga Deçani dhënë autorit, më 1 dhjetor 2005. 4. Po aty. 5. Deklaratë e Ismail (Demush) Ahmetajt nga Duboviku dhënë autorit, më 10 dhjetor 2005. 6. Edith Durham, Brenga..., f.272. 7. Deklaratë e Zepe Bardhoshja - Binakaj (1900-2003) nga Drenoci dhënë autorit, më 15 maj 2001. 8. Adem Istrefi, Lëshoma hisen e diellit, Tiranë: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1984, f.90. 9. Deklaratë e Avdyll Ademajt nga Ratishi dhënë autorit, më 28 mars 2009. 10. Istrefi, Lëshoma..., f.90. Duhet theksuar një fakt: disa gra të cilat ishin shtatzëna, kanë lindur brenda mureve të Manastirit të Deçanit. Rast konkret është gruaja e Mehmet Aliut nga Belleja e Deçanit, Shaha, e cila kishte lindur djalin e saj Ali Mehmetin. – Deklaratë e Murtez Lulajt nga Belleja dhënë autorit, më 2 dhjetor 2005. 11. Viscers, Midis..., f.108. 12. Durham, Brengat, f.399.

PhD (C) Melihate Zeqiri

Bilinguizmi gjuhësor në Ballkan (2)

Maqedonia që është vendi me pasurinë më të madhe të gjuhëve në Evropë, paradoksisht është vendi me shkëlqim më të madhe të të drejtave të përdorimit zyrtar të gjuhës së tjetrit. Kjo politikë gjuhësore në kushtet e sotme në një shtet me jo më pak se 23 gjuhë është anakronike dhe e dëmshme.

Gjuhët – pasuria më e madhe e Ballkanit

Gadishulli ballkanik u ka bërë gjithmonë përshtypje vëzhguesve me morinë e popujve që e banojnë. Gjuhët janë pasuria më e madhe e Ballkanit. Edhe Maqedonia më ballkanike e Ballkanit ku fliten të gjitha gjuhët që mund të merren me mend, - siç thoshte Ferdinand de Sossy, - me asgjë nuk mund të krenohet më shumë se sa me pasurinë më të madhe të gjuhëve që fliten në këtë territor prej shekujsh e mijëvjeçarësh. Këto gjuhë që fliten në arealin e Maqedonisë popujt duhet të dinë t'i çmojnë e t'i vlerësojnë. “Gjuha e vet gjithkujt i duket më e ëmbël se gjuha e huaj” - thotë një fjalë e urtë popullore e Kosovës. Por kjo nuk nënkupton aspak se gjuha e tjetrit nuk është e mirë dhe se nuk duhet të akceptohet nga të tjerët. Mospranimi i gjuhës së tjetrit shpie në racizëm dhe fashizëm të papranueshëm. Ta vlerësojmë gjuhën tonë, pa i urryer të tjerat – kjo do të ishte formula e qytetërimit lingvistik dhe mbijetesës etnike edhe në Maqedoni.

Në Spanjën shumëgjuhëshe, pas fitores së fashizmit në luftën qytetare spanjolle, diktatori gjeneral Franko e shpalli jolegale komunikimin në çfarëdo gjuhe tjetër përveç kastilianishtes spanjolle, kurse baskëve, katalonasve dhe galëve rregullisht u urdhërohej “të pushonin së lehuri si qen” dhe “të flisnin me gjuhën e krishterë”.

Kjo ideologji për gjuhën, kuptohet, i përket kohës së fashizmit në Evropë. Me fitoren e botës kundër asaj murtaje të zezë, fashizmi si i tillë ishte i dënuar të

pësonte debakël dhe ideologjia e tij për gjuhën gjithashtu.

Mirëpo, forma recidive të fashizmit lingvistik nuk është se nuk hasim edhe sot sidomos në disa shtete të vogla ballkanike, si p.sh. në Maqedoni, ku vetëm gjuha maqedonase është shpallur me kushtetutë të jetë gjuhë zyrtare e rendit të parë në gjithë territorin e republikës, kurse gjuhët e tjera, e edhe shqipja e një popullsie shumicë, si gjuhë të rendit të dytë e të tretë.

Duke iu referuar statusit që kanë gjuhët e pakicave në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe politikave gjuhësore në shtete shumëgjuhëshe, si Zvicra, Finlanda etj., madje edhe ish-Jugosllavia, ku gjuha zyrtare shihej si kod i barabarësisë, mund të konstatohet se në Maqedoni gjuha zyrtare shihet si kod për dominim, prej nga buron edhe modeli i centralizimit gjuhësor-politik që zbatohet në praktikë. Dhe, kësaj: Maqedonia që është vendi me pasurinë më të madhe të gjuhëve në Evropë, paradoksisht është vendi me shkëlqim më të madhe të të drejtave të përdorimit zyrtar të gjuhës së tjetrit. Kjo politikë gjuhësore në kushtet e sotme në një shtet me jo më pak se 23 gjuhë është anakronike dhe e dëmshme.

Në këto rrethana, ‘shqipja zyrtare’ “është vetëm një eksperimentim dhe simulim dhe se deri në zyrtarizimin e saj nevojitet edhe shumë kohë dhe një politikë më këmbëngulëse shqiptare” dhe se, pas amnistisë politike të vitit 2001, “nevojitet edhe amnistim i gjuhës shqipe”. Po kjo kërkon që klasa politike shqiptare në Maqedoni të luftojnë me këmbëngulje për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kushtetuta, marrëveshja e Ohrit dhe legjislacioni i

vendit për gjuhën, duke kërkuar edhe përmirësime e plotësime të këtij legjislacioni.

Branko Horvat, një intelektual i shquar kroat dhe njohës i problematikës së Kosovës, në veprën e tij “Kosovsko pitanje” (1988), i sillet edhe problemit të gjuhës në hapësirat jugosllave, si dhe situatës lingvistike në Maqedoni. Si një sferë shumë delikate në marrëdhëniet njerëzore, ai vëren se për afirmimin e gjuhës maqedonase klasa politike maqedonase shkon edhe përtej mase në kufizimin e gjuhës shqipe. Duke iu referuar situatës lingvistike: serbokroatistja (ose kroatoserbishtja), sllovenishtja, shqipja, maqedonishtja dhe hungarishtja, nga të cilat vetëm e para ishte lingua franca, Horvat shprehet se nuk ishte e mjaftueshme që sllovenët, shqiptarët, maqedonasit dhe hungarezët të flisnin ose të kuptonin serbokroatisht. Ishte e domosdoshme që edhe serbët, kroatët, boshnjakët dhe malaziasit të flisnin ose së paku të kuptonin edhe njëri nga të katër gjuhët e tjera, sidomos atë gjuhë që e flasin njerëzit me të cilët bashkëjetohet.

Në fund Horvat shtron dilemën: “A është e mundur të realizohet dygjuhësia? Kjo ka mundur të realizohet në periodën e mesjetës. Është realizuar në Zvicër. Është e mundur të realizohet edhe në Jugosllavinë socialiste”.

Të flasësh gjuhën e tjetrit nuk është mallkim, por është bazë për çdo bashkëpunim. E se është kështu mund të sillet dhe ky fakt: 58 për qind e gjermanëve dhe 60 për qind e francezëve e konsiderojnë të rëndësishme të mësojnë gjuhën e fqinjit. Françoise Retif nga Instituti Français thotë: “Gjuha përcjell një kulturë. Kur flet gjuhën e

tjetrit, njeh mënyrën e tij të të menduarit dhe të të jetuarit”.

Modele kushtetuese të disa vendeve evropian për përdorimin e gjuhës

Në kontinentin plakë të Evropës, e drejta e pakicave për përdorimin zyrtar të gjuhës amtare njeh praktika të ndryshme. Në Evropën Veriore dhe Perëndimore kjo e drejtë u njihet pakicave dhe është e realizueshme, e prekshme; në Ballkan – siç do të thoshte Ismail Kadare – tragjedia e gjuhës ka vazhduar deri në ditët tona. Në qytetërimin tonë ballkanik, racizmi fillestar rrjedh nga gjuha dhe jo nga ndryshimi i ngjyrës së lëkurës, as nga dallimet midis zakoneve, as nga mizoritë.

Në visoren linguistike të Evropës, si p.sh. në Finlandë, ku suedezët nuk përbëjnë as 6 për qind të popullsisë, gjuhë zyrtare, krahas finlandishtes, është dhe suedishtja. Madje edhe vetë emri zyrtar i shtetit është në dy trajta: Suomi dhe Finlandë. Të gjitha dokumentet e parlamentit, të qeverisë, të ekonomisë, të enteve etj., janë në të dyja gjuhët. Në komunat thjesht finlandeze ose thjesht suedeze, gjuhë zyrtare është përkatësisht vetëm finlandishtja ose vetëm suedishtja. Në komunat që kanë mbi 10 për qind finlandezë ose suedeze, janë të barabarta të dyja gjuhët. Në universitetet e Finlandës studenti mund të përgjigjet në provim në cilën gjuhë të dëshirojë: në

finlandisht ose suedisht. Në shenjat e sinjalistikës në rrugët e Helsinkit gjithkund aplikohet dygjuhësia: finlandisht dhe suedisht. Po kështu, edhe në Suedi gjuhë zyrtare është dhe finlandishtja për 3 për qind të popullsisë.

Në Zvicër gjuhë zyrtare, përveç gjermanishtes, frëngjishtes dhe italishtes, është edhe gjuha e retoromanëve, që përbëjnë vetëm 1 për qind të popullsisë. Në Zvicër, më pak se 100 mijë romanë vendës kanë të drejtën e barazisë gjuhësore me frëngjishten, gjermanishten dhe italishten.

Në Itali, në fillim të vitit 2001, Parlamenti (Senati) Italian miratoi një ligj me të cilin 90 mijë slovenëve etnikë, që nuk përbëjnë as 1 për qind të popullsisë së këtij shteti, u siguron të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës së tyre amtare slovene dhe u garanton një shkollë autonome në sistemin arsimor; në zyrat e qeverisjes së tyre vendore do të fliten të dyja gjuhët dhe në zona të caktuara do të ketë tabela rrugore dhe mbishkrime të tjera në të dyja gjuhët.

Në Spanjë, krahas spanjishtes, janë në bashkëpërdorim zyrtar edhe gjuhët e pakicave.

Në Moldavi, pakica gagauze realizon të drejtën e përdorimit zyrtar të gagauzishtes në shkollën më të lartë: në universitet, në akademi, në parlament, në qeveri, në presidencën e shtetit etj.. Modelet kushtetuese të disa vendeve evropiane për përdorimin e gjuhës, si ai i Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Sllovenisë, Estonisë, Lituanisë, Spanjës etj., që merren për krahasim me situatën gjuhësore në Maqedoni, janë të pakrahasueshme, sepse tek ato shtete situata e

homogjenitetit të etnive shtetformuese është në një shkollë shumë më të lartë sesa ajo e Maqedonisë. Po edhe atje, si p.sh. në Slloveni, me mbi 98 për qind popullsi slovene, gjuhë zyrtare, përveç slovenishtes, janë edhe italishtja e hungarishtja – në rajonet ku fliten këto gjuhë.

Në Shqipëri, një shtet me mbi 95 për qind popullsi shqiptare, pakicat kanë të drejtë ta realizojnë gjuhën e tyre në arsimin fillor e të mesëm, në administratën shtetërore etj.

Në Kosovë me 90 për qind popullsi shqiptare, gjuhë zyrtare janë dhe serbishtja dhe turqishtja.

Edhe përtej kontinentit tonë evropian, njëgjuhësia dhe shumëgjuhësia, nevoja për të mësuar një gjuhë apo shumë gjuhë, shikohet me konceptet moderne. Filologu e filozofi indian Anil Bhatti, njëgjuhësinë e sheh si një të metë të njeriut modern. “Në Indi gjuhë zyrtare ka plot 22, ndërkohë që fliten mbi 350”. Bhatti nuk e pranon fare as dhe konceptin e gjuhës së huaj. “Duhet të flasim për gjuhën tjetër, jo për gjuhën e huaj”. Nuk është kompetenca gjuhësore ajo që na drejton dhe orienton në jetë, por kompetenca kulturore, apo ndryshe, fleksibiliteti kulturor. Shumëgjuhësia vetëm si pjesë e shumëkulturësisë e jo ndonjë qëllim në vetvetë.

“Gjendja natyrore e njeriut është shumëgjuhësia dhe jo njëgjuhësia”, thotë Bhatti. Edhe vende si India e Kina nuk kanë frikë nga numri i madh i gjuhëve në vendet e tyre, përkundrazi, krenohen me këtë pasuri.



Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e radhës

Më 1 mars, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti sot mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i Kryesisë, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kryesia në rend të ditës pati diskutime mbi organizimin e aktiviteteve gjatë muajit të bekuar Ramazan, shqyrtimin e lëndëve dhe marrjen e vendimeve nga kompetencat e Kryesisë, si dhe pika të ndryshme.

Pas diskutimeve dhe shqyrtimeve për rendin e ditës, Kryesia në parim miratoi planin e aktiviteteve dhe organizimeve të muajit Ramazan. (R.S.)



Myftiu Tërnavë: "T'i themi fuqishëm Jo luftës"

Me vëmendje e shqetësim kam përcjellë eskalimin e situatës në Ukrainë. Maktin dhe terrorin që po e përjeton populli i Ukrainës nën kërcënimin e makinerisë ushtarake ruse, është ogur i zi që paralajmëron ditë të rënda për njerëzimin, para së gjithash për qytetarët e paarmatosur ukrainas.

Pamjet e granatimeve të qyteteve e të vendbanimeve me popullatë civile, radhët e gjata të qytetarëve duke u larguar nga shtëpitë dhe vatrën e tyre, si dhe viktimat e pafajshme në radhët e civilëve, për ne janë të papranueshme, ngase vetëm para dy dekadash, kemi kaluar nëpër një situatë të tillë.

Lutem dhe apeloj tek të gjithë faktorët ndërkombëtarë, që para luftës e gjakderdhjes të zgjedhin paqen, para konfliktit të zgjedhin mirëkuptimin e



tolerancën, para vuajtjeve e shkatërrimit të zgjedhin qetësinë e stabilitetin.

Lusim Zotin që situata e tanishme në Ukrainë të zgjidhet me mjetet politike e paqësore dhe bota e njerëzimi të jenë më të qetë e më të sigurt.

Paqe e qetësi për popullin e Ukrainës, të shmangin gjakderdhjen, shkatërrimet dhe trazirat, t'i themi fuqishëm JO luftës.

*Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj

Më 3 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj.



Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi z. Ramosajn për mandatin e ri në krye të Komunës së Deçanit, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai tha se udhëheqja e Komunës para së gjithash duhet të shihet si një përgjegjësi karshi qytetarëve të saj. Myftiu Tërnavë më pas e njohu kryetarin Ramosaj edhe

me mbarëvajtjen e aktiviteteve fetare në Kosovë në përgjithësi, e në veçanti në Komunën e Deçanit.

Nga ana e tij, kryetari Ramosaj falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm me Bashkësinë Islame në

përgjithësi, e në veçanti me Këshillin e Bashkësisë Islame të Deçanit. Gjatë vizitës në Deçan, Myftiu Tërnavë mori pjesë në promovimin e librit “Shekuj drite në Deçan”, të autorit, imamit Harun ef. Shabanajt, ku mbajti edhe një fjalë përshëndetëse.

Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin e BI-së së Ferizajt

Më 4 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Ferizajt, në të cilin u prit nga kryetari Fehmi ef. Mehmeti dhe administrata e KBI-së. Në këtë takim, prezentë ishin disa nga afaristët ferizajas, të cilët janë kontribuues të rregullt në nismat e ndërmarra nga KBI-Ferizaj.

Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi afaristët për kontributin e tyre dhe çmoi lart angazhimin e tyre që të bashkëpunojnë me institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai vlerësoi gatishmërinë e tyre që asnjëherë nuk hezitojnë t’u përgjigjen thirrjeve për ndihmë sa herë dhe kudo që ka nevojë.



Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e Dijanetit të Turqisë, Ali ef. Erbash

Më 8 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Turqisë (Dijaneti), prof. dr. Ali ef. Erbash. Myftiu Tërnavë e falënderoi kryetarin Erbash dhe nëpërmes tij tërë Dijanetin për ndihmën dhënë Kosovës.

“Kemi një bashkëpunim shumë të mirë me shoqatat turke që veprojnë në Kosovë, me zyrтарin për çështje fetare në Ambasadën Turke, si dhe me ambasadorin. Andaj shpreh falënderim të veçantë për Qeverinë dhe popullin turk, të cilët vazhdimisht kanë mbështetur Kosovën në situatat më të vështira, e po vazhdojnë edhe më tej që të mbështesin dhe të ndihmojnë për integrimin e Kosovës në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtare. Një falënderim të veçantë dua ta shpreh për Dijanetin që po mundëson ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, si dhe për gjithë përkrahjen që ka dhënë deri më tani” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.



Nga ana e tij, kryetari i Dijanetit, prof. Ali ef. Erbash, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe shprehu kënaqësinë e tij që sot gjendet për vizitë në Kosovë. “Fillimisht, përcjell për ju përshëndetjet e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Edhe pse kemi ndarje gjeografike, ne nuk kemi ndarje të kufijve shpirtëror, andaj të ndihmohemi ndërmjet vete me devotshmëri

e me bamirësi. Jemi të impresionuar me të arriturat e BIK-ut, si dhe me jetën fetare dhe kulturore në Kosovë” – tha ndër tjera z. Erbash. Ai edhe njëherë premtoi përkrahjen e shtetit të Turqisë dhe të Dijanetit për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për Kosovën në realizimin e projekteve të trashëgimisë kulturore-historike, që do të jenë në të mirë të qytetarëve të saj. (R.S.)

Myftiu Tërnavë dhe kryetari i Dijanetit z. Erbash vizituan vendin e caktuar për ndërtimin e Xhamisë Qendrore

Më 8 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Turqisë - Dijaneti, prof. dr. Ali ef. Erbash. Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje dr. Erbashit në Kosovë dhe e cilësoi këtë vizitë si shumë domethënëse për popullin e Kosovës, marrë parasysh të kaluarën historike të përbashkët ndërmjet dy popujve. Myftiu Tërnavë e falënderoi kryetarin z. Erbash për gjithë atë çfarë ka bërë Dijaneti për Kosovën.

Kryetari i Dijanetit, prof. dr. Ali ef. Erbash, tha se ndjehet i lumtur që ky projekt do të realizohet në bashkëpunim me Kryesinë e BIK-ut. Ai luti Zotin që



punimet të ecin mbarë dhe sipas planit të paraparë. Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë dhe kryetari Erbash, zhvilluan një bisedë telefonike me presidentin e

Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan, të cilin e njohën për së afërmi me mbarëvajtjen e punimeve të Xhamisë Qendrore në Prishtinë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë dhe Kryetari i Dijanetit, Ali ef. Erbash u pritën në takim nga Presidentja Osmani

Në kuadër të takimeve, kryetari i Dijanetit, prof. dr. Ali ef. Erbash dhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u pritën në takim nga presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani.

Në takim është diskutuar për rolin e BIK-ut dhe bashkësive të tjera në kultivimin e tolerancës fetare në Kosovë. Presidentja Osmani ka theksuar se toleranca ndër-fetare në Kosovë është vlerë e shquar e shoqërisë kosovare dhe ka nënvizuar rolin pozitiv të bashkësive fetare në këtë drejtim. Gjatë takimit, presidentja Osmani u njoh për projektet humanitare të mbështetura nga Dijaneti në Kosovë. (R.S.)



Myftiu Tërnavë vizitoi paralelen e Medresesë "Alauddin" në Prizren

Më 9 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga drejtori i Medresesë së Mesme "Alaudin", prof. Fadil ef.



Hasani, ka vizituar paralelen e Medresesë "Allaudin" në Prizren.

Këta u mirëpritën nga koordinatori i Medresesë, Almedin ef. Ejupi, i cili e njohu Myftiun Tërnavë me zhvillimin dhe me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Myftiu Tërnavë përgëzoi koor-

dinatorin Ejupi dhe gjithë mësimdhënësit për angazhimin e tyre për ecurinë sa më të mirë të procesit mësimor. Ai edhe një herë konfirmoi përkrahjen e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për mbarëvajtjen dhe organizimin më efikas të procesit

mësimor. Gjatë vizitës në Medresë, Myftiu Tërnavë, vizitoi edhe maturantët, të cilët i përgëzoi për përfundimin me sukses të Medresesë, duke iu dëshiruar shëndet dhe suksese në jetën akademike.

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Prizrenit, z. Shaqir Totaj

Më 9 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, u prit në takim nga kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj.

Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi z. Totajn për mandatin e ri në krye të Komunës së Prizrenit, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai tha se udhëheqja e Komunës para së gjithash duhet të shihet si një përgjegjësi karshi qytetarëve të saj. Myftiu Tërnavë më pas e njohu kryetarin Totaj edhe me mbarëvajtjen e aktiviteteve fetare në Kosovë në përgjithësi, e në veçanti në Komunën e Prizrenit.

Nga ana e tij, kryetari Totaj falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe shprehu mirënjohjen dhe falën-



derimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm me Bashkësinë Islame


në përgjithësi, e në veçanti me Këshillin e BI-së së Prizrenit.

Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin e BI-së së Prizrenit

Më 9 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit, në të cilin u prit nga kryetari i këtij Këshilli, Besim ef. Berisha.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin dhe nëpunësit fetarë për kontributin dhe përkushtimin e tyre dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në Prizren. Ai premtoi përkrahjen e vazhdueshme të Kryesisë dhënë për këshillat e BI-së në tërë Kosovën.

Kryetari Berisha e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Këshillin e Prizrenit. Gjatë këtij takimi u diskutua



edhe për arritjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky Këshill, si dhe për tema

të tjera me rëndësi për Këshillin e Prizrenit.

Myftiu Tërnavë mori pjesë në përrurimin e xhamisë së re te tregu në Prishtinë

Më 11 mars, me këndim të Kuranit dhe selavateve është përruruar xhamia e re te tregu në Prishtinë. Në këtë cere-

moni mori pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë,

përfaqësues të KBI-së së Prishtinës, hoxhallarë, e xhematlinjë të shumtë. Hytben e xhumasë e mbajti Myftiu

Tërnavë, i cili veç tjerash tha se vërtet xhami ndërtojnë vetëm ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Fundit. Xhamitë kanë reflektuar paqe, nder, respekt, harmoni dhe dritë për të gjithë, dinjitet të familjes dhe shoqërisë. Ai më pas nënvizoi se në këtë mënyrë besimtarët po i përkushtohen edhe më shumë Zotit, duke veçuar rolin e pazëvendësueshëm që xhamitë kanë pasur dhe kanë në Kosovë. “Kush ndërton një xhami në këtë botë, Zoti do t’ia ndërtojë atij në Ahiret një shtëpi prej shtëpive të xhenetit. Andaj lus Zotin që t’iu shpërblejë të gjithë juve që jeni bërë shkak për ndërtimin e kësaj xhamie madhështore në këtë kohë sfidash që ne si popull të unifikuar e të bashkuar kemi ditur të ia tejkalojmë sepse kështu na mëson feja dhe Kurani. Unë ju përgëzoj për këtë xhami kaq madhështore e domethënëse në këtë vend dhe kohë kaq domethënëse. Ne krahas xhamive ndërtojmë shkolla, spitale, biblioteka e gjithçka ka nevojë komuniteti ynë. Përmes kësaj xhamie dhe xhamive tjera ne mbrojmë fenë tonë. Xhamia është mbrojtje e besimtarit, familjes nga ato bajoneta të



cilat po hidhen në drejtim të shkatërrimit të familjes. Xhamia do të jetë ajo që do të na mbrojë nga këto sulme që synojnë prishjen e vlerave familjare që ka treguar heroizëm gjatë tërë të kaluarës sonë historike. “Shumë nga bijtë e bijat tona janë larguar nga Kosova prej dhunës, persekutimit, disa shumë prej tyre janë burgosur, vrarë e masakruar për këtë vend, ose më mirë të themi nuk ka rrugë as vend këtu në vendin tonë që nuk është ujitur me gjakun e dëshmorëve tanë që ranë për

të mos vdekur kurrë që ne sot të frymojmë lirshëm, të ndërtojmë xhami, shkolla, rrugë e infrastrukturë të nevojshme për qytetarët tanë që të arsyetojmë të qenët tonë njeri” - tha mes tjerash Myftiu Tërnavë. Namazit të xhumasë i priu kryeimami i Republikës së Kosovës, Vedat ef. Sahiti. Në fund besimtarët falënderuar Myftiun Tërnavë dhe BIK-un për ndihmën dhe përkrahjen që ka dhënë në ndërtimin e kësaj xhamie. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim drejtorin e Shoqatës Humanitare “El Xhuud el-Hajrijeh”, dr. Abdulaziz el-Zajid

Më 12 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim dr. Abdulaziz el-Zajid, drejtor i Shoqatës Humanitare “El Xhuud el-Hajrijeh” me seli në Kuvajt.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mysafirëve mirëseardhje në selinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas i njohu ata me historikun, sfidat dhe të arriturat e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai falënderoi dr.

Abdulazizin dhe nëpërmes tij, shtetin e Kuvajtit për ndihmat e dhëna për Kosovën në përgjithësi dhe për institucionin e BIK-ut në veçanti, si para, ashtu edhe pas luftës. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdojnë bashkëpunimin e mirëfillt që kanë pasur me këtë shoqatë.

Nga ana e tij, dr. Abdulazizi, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që

ka mbretëruar deri më tani ndërmjet shoqatës dhe BIK-ut. Ai shprehu interesimin e tij që edhe më tej të kontribuojë dhe të ndihmojë popullin e Kosovës, në të gjitha sferat pa dallim. Vlen të përmendet se Shoqata Humanitare “El Xhuud el-Hajrijeh” ka marrë përsipër rindërtimin e dy xhamive në Kosovë, asaj në fshatin Kishnarekë të Drenasit dhe asaj në Strellc të Deçanit.



Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni

Më 17 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni. Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi z. Hysenin për marrjen e detyrës si kryetar i Gjilanit, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai tha se udhëheqja e Komunës para së gjithash duhet të shihet si një përgjegjësi karshi qytetarëve, e më pas edhe si një privilegj i dhënë nga qytetarët e komunës. Më pas, Myftiu Tërnavë e njohu kryetarin Hyseni me mbarëvajtjen e jetës fetare në vendin tonë në përgjithësi, e në veçanti në komunën e Gjilanit. Ai shprehu falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Këshillit të BI-së së Gjilanit dhe Komunës së Gjilanit.



Nga ana e tij, kryetari Hyseni, falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për bashkëpunimin e ngushtë që ka mbretëruar deri më tani me Këshillin e BI-së së Gjilanit. Ai premtoi se ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe do të

intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë shoqërohej nga anëtari i Kryesisë, Ilmi ef. Krasniqi dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu.

Myftiu Tërnavë viziton paralelen e Medresesë "Alauddin" në Gjilan

Më 17 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga drejtori i Medresesë, Fadil ef. Hasani, vizituan paralelen e Medresesë "Alauddin" në Gjilan.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë u prit nga koordinatoreja e Medresesë, znj. Merita Boroci, të cilën Myftiu e uroi për marrjen e detyrës si koordinatore, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Koordinatorja Boroci e njohu Myftiun Tërnavë me ecurinë dhe

mbarëvajtjen e procesit mësimor në paralelen e Medresesë së Gjilanit, si dhe e falënderoi Myftiun Tërnavë për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme të tij dhe të Kryesisë së BI-së dhënë për nxënësit e Medresesë.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, takoi edhe nxënësit e Medresesë, për të cilët shprehu një konsideratë të lartë. Ai i motivoi nxënësit që të mësojnë sa më shumë dhe që të jenë në shërbim të Islamit dhe të vatanit, ngase e ardhmja është në duart e tyre. "Shfrytëzoj rastin që nga ky vend t'u porosisë që të mësoni sa më

shumë, gjithnjë duke pasur parasysh mësimet kuranore dhe hadithet profetike. Ne Medresesë i jemi borxhli, ngase në një mënyrë a tjetër, ne të gjithë jemi pjesë e saj. Ajo ka dhënë një kontribut të çmuar në të gjitha proceset në të cilat ka kaluar vendi ynë", - tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Një fjalë rasti para nxënësve mbajti edhe drejtori i Medresesë "Alaudin", Fadil ef. Hasani, i cili iu dëshiroi nxënësve suksese në procesin e tyre mësimor.



Myftiu Tërnavë vizitoi disa biznese në komunën e Gjilanit

Më 17 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, gjatë vizitës në Gjilan, ka vizituar edhe disa biznese që veprojnë në komunë. Ai fillimisht vizitoi kompaninë AE Holding L.L.C. - TELKOS, në të cilën u mirëprit nga drejtori i kësaj kompanie, Vedat Morina dhe më pas qëndroi në kompaninë Konsoni, në të cilën u mirëprit nga menaxheri i kësaj kompanie Agim Sahiti.

Myftiu Tërnavë falënderoi pronarët e këtyre kompanive për angazhimin e tyre dhe për gatishmërinë e treguar që të bashkëpunojnë me institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai luti Zotin që t'ua shtojë bereqetin dhe të mirat e Tij dhe që ndërmjet tyre të



mbretërojë uniteti, respekti dhe sinqeriteti.

Të dy nikoqirët, si z. Morina ashtu edhe z. Sahiti, falënderuan Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për angazhimin e tij dhe të institucionit

të BIK-ut për të gjitha proceset që ka kaluar vendi ynë. Ata edhe njëherë shprehën gatishmërinë e tyre që të bashkëpunojnë edhe më tutje me institucionin e BIK-ut.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi

Më 22 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij është prituri në takim nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi.

Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi kryetarin Idrizi për marrjen e detyrës së re në krye të Komunës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu kryetarin Idrizi me mbarëvajtjen e jetës fetare në vendin tonë në përgjithësi, si dhe në veçanti në komunën e Vushtrrisë. Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Këshillit të BI-së së Vushtrrisë dhe Komunës, duke shprehur gatishmërinë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Ndërkaq, kryetari Idrizi e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për kontributin që ai dhe Bashkësia Islame kanë dhënë në vazhdimësi për të mirën e qytetarëve të vendin. Ai tha

se jemi pajtuar që të vazhdojmë bashkëpunimin e mirëfilltë që ka ekzistuar deri më tani ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunës së Vushtrrisë. (R.S.)

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e radhës

Më 23 mars, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i Kryesisë, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Kryesia në rend të

ditës pati Shqyrtimi dhe miratimin e raportit të Kryesisë për vitin 2021, Shqyrtimi dhe miratimi i Pasqyrës financiare për vitin e kaluar, Shqyrtimi dhe miratimi i llogarive përfundimtare

të Këshillave të BI-së së Kosovës, si dhe shqyrtimin e lëndëve dhe marrjen e vendimeve nga kompetencat e Kryesisë, si dhe pika të ndryshme. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim kapelan Major Jeremy Taylor

Më 24 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë ka pritur në takim kapelan-major Jeremy Taylor Kapelan, kapiten Timothy Hadley dhe rreshterin e klasit të parë, Anthony Devick.

Myftiu Tërnavë i njohu mysafirët me punët dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat që ballafaqohet ky institucion.

Nga ana e tij, kapelan-major Jeremy Taylor, shprehu falënderime për pritjen dhe njëherësh përgëzoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e tyre që



në Kosovë të mbretërojë paqja, respekti e toleranca ndërmjet besimeve dhe etnive të ndryshme. Gjatë

takimit u diskutua edhe për një sërë temash me rëndësi për të qytetarët e Kosovës. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti një delegacion nga fondacioni “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”

Më 24 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga fondacioni “Revival of Islamic Heritage Society” e njohur si fondacionin “Ringjallja e Trashëgimisë Islame, të kryesuar nga Mahmud en-Nexhdi.

Myftiu Tërnavë së pari u shprehu mirëseardhje mysafirëve, pastaj i njohu me aktivitetin dhe organizimin e jetës fetare dhe edukative që bën Kryesia e BIK-ut në vend. Myftiu Tërnavë po ashtu falënderoi qeverinë dhe popullin e Kuvajtit që kanë kontribuar shumë për përmirësimin e infrastrukturës së BIK-ut dhe theksoi se Kuvajti vazhdimisht ka ofruar ndihmë dhe mbështetje për shtetin e Kosovës, si gjatë luftës, por edhe pas përfundimit të saj dhe për këtë popullin e Kosovës



asnjëherë nuk do ta harrojë këtë mirësi nga ta.

Nga ana e tij, z. Mahmud en-Nexhdi u shpreh se është shumë i lumtur që po viziton Kosovën dhe theksoi se populli i Kosovës është një popull shumë i dashur dhe Kuvajti ka kuptuar

nevojat që ka populli i Kosovës dhe është munduar që sado pak të ofrojë ndihmë vëllazërore në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Të dyja palët ranë dakord që të realizojnë projekte të përbashkëta në dobi të vendit tonë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim znj. Nona Zicherman

Më 24 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim znj. Nona Zicherman, shefe e zyrës së UNICEF-it në Kosovë.



Myftiu Tërnavë i dëshiroi mirëseardhje mysafires dhe e njohu me atë me funksionimin dhe rolin që ka BIK-u në vetëdijesimin e masës në aspektin fetar e kulturor islamë, si dhe projektet që i ka realizuar BIK-u në dobi të shoqërisë përgjatë viteve.

Ai po ashtu tha se BIK-u vazhdimisht ka kontribuar që Kosova të jetë një ambient i qetë, ku të gjithë qytetarët të jetojnë në paqe, liri e siguri duke respektuar diversitetin tonë fetarë e kulturorë.

Nga ana e saj znj. Zicherman, falënderoi Myftiun Tërnavë për

pritjen dhe theksoi se BIK-u është një institucion që ka peshë dhe rol në segmentet e zhvillimit të vendit tonë. Ajo më pas theksoi nevojën e thellimit të bashkëpunimit të dy anshëm dhe në realizimin e projekteve në dobi të qytetarëve tanë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Malishevës, z. Ekrem Kastratin

Më 24 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati.

Myftiu Tërnavë uroi kryetarin Kastrati për mandatin e ri në krye të Komunës, duke çmuar kështu gatishmërinë e tij dhe të Komunës së Malishevës për të bashkëpunuar me Këshillin e Bashkësisë Islame të Malishevës.

Nga ana e tij, kryetari Kastrati çmoi rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës që çdoherë të jenë në funksion të mirëqenies qytetare, kultivimit të harmonisë dhe tolerancës



ndërfetare, për çka ne gëzojmë respekt si komb shqiptar.

Myftiu Tërnavë dhe kryetari Kastrati diskutuan edhe për bashkëpunimin e mirë që ka mbretëruar ndërmjet Këshillit të BI-së së

Malishevës dhe Komunës, si dhe u pajtuan që të vazhdohet edhe më tej ky bashkëpunim, dhe që të iniciohen edhe projektet të reja, gjithnjë në interes të komunitetit tonë.

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini

Më 25 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini.

Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi kryetarin për marrjen e detyrës së re në krye të Dragashit, duke ia kujtuar

kështu se udhëheqja e Komunës, para se të jetë një privilegj, ajo duhet të shihet si një përgjegjësi karshi qytetarëve. Ai më pas e njohu kryetarin Xheladini me mbarëvajtjen e jetës fetare në vend, duke u fokusuar veçanërisht në Dragash. Myftiu falënderoi kryetarin për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet

Këshillit të BI-së së Dragashit dhe Komunës.

Nga ana e tij, kryetari Xheladini, shprehu falënderime për vizitën, duke premtuar kështu për një bashkëpunim edhe më të shtuar me Këshillin e Bashkësisë Islame të Dragashit, gjithnjë në të mirë të qytetarëve të kësaj ane.



Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës, z. Burim Berisha

Më 28 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, z. Burim Berisha.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Berisha për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunës së Fushë Kosovës.

Edhe kryetari Berisha është zotuar se bashkëpunimi i mirëfilltë ndërmjet dy institucioneve do të vazhdojë edhe në të ardhmen, gjithnjë në të mirë të qytetarëve.

Duke pa të nevojshme ndërtimin edhe të një Xhamie në Fushë-Kosovë, të dy bashkëbiseduesit u dakorduan që



shumë shpejtë të realizohet ky projekt i cili do të ju lehtëson besimtarëve islam kryerjen e obligimeve të tyre. Gjatë qëndrimit në komunë, Myftiu

Tërnavë takoi edhe kryesuesin e kuvendit të komunës z. Ali Ismaili, të cilit i uroi pozitën e kryesuesit të Kuvendit.

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi

Më 28 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi.

Myftiu Tërnavë e njohu nikoqirin me ecurinë e jetës fetare në vendin tonë, me theks të veçantë për Komunën e Obiliqit. Ai shprehu gatishmërinë e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet bashkëpunimi i mirëfilltë që ka ekzistuar ndërmjet dy institucioneve, gjithnjë në të mirë të qytetarëve tanë.



Kryetari Gashi e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe e falënderoi atë për gatishmërinë e reguar që të

kenë një bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve të ndryshme.

Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin e BI-së së Fushë Kosovës

Më 28 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica dhe zv.kryeimami Fatmir ef. Iljazi, vizituan Këshillin e Bashkësisë Islame në Fushë



Kosovë, ku u pritën nga kryetari i Këshillit Pajazit ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Myftiu Tërnavë u njoh me aktivitetet dhe gjendjen aktuale në KBI të Fushë

Kosovës, si dhe për jetën fetare dhe aktivitetet e tjera në këtë komunë.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë ndër të tjera foli për rolin dhe kontributin e rëndësishëm të BIK-ut

në shoqëri dhe falënderoi të gjithë imamët për kontributin e tyre, duke kërkuar angazhim maksimal në shërbim të qytetarëve.

Myftiu Tërnavë mori pjesë në manifestimin ku u certifikuan mbi 900 nxënës të Mektebit në Prizren



Më 29 mars, organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Prizrenit, në sallën sportive “Sezai Surroi” në Prizren, u certifikuan mbi 900 nxënës, të cilët ndoqën mësimet e nivelit të parë të Mektebit. Në këtë ceremoni morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, imamë dhe mualime, si dhe shumë të ftuar të tjerë. Nga një fjalë rasti para të pranishmëve, fillimisht mbajtën kryetari i KBI-së së Prizrenit, Besim ef. Berisha dhe kryeimami i KBI-së së Prizrenit, Orhan ef. Bislimaj, të cilët shpalosën sfidat dhe sukseset e këtij Mektebi. Ata thanë se pavarësisht problemeve me pandeminë, prapë se prapë, të nxënësit gjithmonë pati

gatishmëri dhe interesim që me sukses ta vazhdonin mësimin.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, i cili përgëzoi KBI-në e Prizrenit për këtë organizim. “Është tejet e rëndësishme që fëmijët tanë të mësohen dhe edukohen në Mekteb në frymën fetare dhe kombëtare, andaj ju përgëzoj dhe ju uroj për këtë organizim” – tha kryetari Totaj.

Ligjëratën kryesore për rëndësinë e Mektebit e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë. “Fillimisht më lejoni që të uroj Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit për këtë organizim, si dhe gjithë imamët dhe mualimet, por një urim të veçantë ua adresoj të gjithë nxënësve për këtë sukses të treguar. Zoti xh.sh. në shpalljen e

fundit, Kuranin fisnik, ajetin e parë drejtuar Pejgamberit Muhamed, ia shpalli urdhrin për lexim e mësim, ngase vetëm kështu arrihet që të kemi shoqëri të zhvilluar dhe me prosperitet të lartë. Sot, dukuritë negative në vendin tonë kanë shënuar rritje, andaj mësimi në Mekteb është rruga e vetme për shpëtimin nga këto dukuri. Edhe njëherë gjithë nxënësve ju dëshiroj jetë të gjatë dhe suksese në jetën e tyre, e gjithashtu i përgëzoj gjithë prindërit për këtë sukses të fëmijëve të tyre” – tha ndër tjera Myftiu Tërnavë.

Programi më pas u vazhdua me pikat artistike të përgatitura nga nxënësit e Mektebit. Krejt në fund, u shpërndanë edhe certifikatat për nxënësit dhe mësuesit e tyre.

Myftiu Tërnavë takoi kryetarët e këshillave vendor të BIK-ut

Më 30 mars, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka zhvilluar një takim me kryetarët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ky takim u organizua me qëllimin e vetëm, atë të koordinimit dhe organizimit sa më të mirë të aktiviteteve në terren të organizuara nga BIK-u.

Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi mirëseardhje kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të rajonit të Gorës, Miralem ef. Misini, si një Këshill i formuar së fundi nga Kuvendi i BIK-ut. Ai i dëshiroi punë të mbarë dhe të suksesshme në udhëheqjen e këtij Këshilli.

Më pas ai ua rikujtoi atyre përgjegjësinë që kanë për organizimin dhe udhëheqjen e jetës fetare në këshillat e BI-së. Në fokus të takimit ishin edhe organizimi dhe aktivitetet fetare gjatë muajit të bekuar të Ramazanit si dhe koordinimi sa më i mirë mes Kryesisë së BIK-ut dhe këshillave të BI-së nëpër terren, në



mënyrë që bashkërisht t'i bashkërendojnë punët gjatë këtij muaji si dhe të tejkalohen problemet dhe sfidat që po ballafaqohemi për çdo ditë. Myftiu Tërnavë po ashtu porositi kryetarët e këshillave të BI-së që të jenë më afër me xhematin.

Ai tha se gjatë këtij muaji kemi pasur takime të shumta me kryetarë komunalë ku kemi biseduar dhe i kemi falënderuar për bashkëpunimin shumë të mirë që kemi, si në nivel lokal ashtu edhe qendror, si dhe i kemi falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme që janë duke ua dhënë këshillave të BI-së nëpër komuna.

Po ashtu kemi pasur takime të shumta me xhemat, kryetar të këshillave, punonjës dhe kemi dëgjuar nga ata për çdo gjë që mund

të bëhet në të mirë të zhvillimit dhe prosperitetit të Islamit dhe ardhmërisë së tij në këto troje.

Myftiu Tërnavë ka shprehur mirënjohje për kontributin që kanë dhënë kryetarët e KBI-ve dhe të gjithë imamët për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Ai tha se BIK-u vazhdimisht ka punuar dhe është interesuar për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit publik të qytetarët. Në këtë mbledhje u tregua edhe njëherë përkushtimi i BIK-ut që të bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha institucionet shëndetësore, duke pasur parasysh se BIK-u ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie.

Myftiu Tërnavë tha se falë Zotit dhe angazhimi tonë në përgjithësi, në këto

vitet e fundit kemi shënuar rezultate të mira, sidomos në ndërtimin e infrastrukturës, si të xhamive ashtu edhe të objekteve të tjera, siç janë ndërtimi i selive nëpër këshillat e Bashkësisë Islame dhe ndërtimi i objekteve për vakëfe, të cilat janë një bazë e mirë për funksionimin e BIK-ut.

Myftiu Tërnavë u kërkoi që të bashkëpunojnë edhe më shumë ndërmjet vetë, të shkëmbejnë përvoja me njëri-tjetrin në mënyrë që aktivitetet të jenë në të mirë të xhematëve, si dhe porosia e tij ishte që të jemi unik në mendime e qëndrime përballë sfidave të kohës dhe jetës që kemi para nesh.

Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt

Më 31 mars, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt, në të cilën përpos anëtarëve të Kuvendit mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në rend dite ishte shqyrtimi dhe miratimi i raportit për punën e Kryesisë së BI-së të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021, raporti i komisionit financiar të Kuvendit të BIRK-ut, shqyrtimi dhe miratimi i pasqyrës për të hyrat dhe të dalat e Kryesisë (llogarisë përfundimtare) për vitin 2021, si dhe të ndryshme.

Mbledhjen e hapi kryetari i Kuvendit dr. Ajni Sinani, i cili fillimisht iu shprehu mirëseardhje anëtarëve të Kuvendit, si dhe i falënderoi ata për punën dhe angazhimin e tyre.

Më pas, një fjalë rasti para të pranishmëve e mbajti kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Ai fillimisht uroi të pranishmit për ardhjen e muajit Ramazan dhe kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të që japin kontributin e tyre për avancimin dhe shtyrjen e proceseve përpara, duke lutur Zotin xh.sh., që të na shpërblejë për punën dhe angazhimin tonë për forcimin dhe përhapjen e mesazhit të Allahut të xhemati ynë, ngase e kemi obligim mbi supet tona. "Ne jemi përgjegjës për jetën fetare brenda dhe jashtë Kosove ku kemi mërgatën tonë. Në kuadër të mundësive tona edhe gjatë vitit 2021 jemi munduar që me vetëmohim, maksimalisht të japim kontributin tonë në fuqizimin e institucionit tonë, duke filluar nga ngritja e kapaciteteve të kuadrit profesional përmes institucioneve tona

fetaro-arsimore, gjegjësisht medreseve e Fakultetit të Studimeve Islame, pastaj ngritjes së infrastrukturës së BI-së me theks të veçantë përmes zhvillimit të vakëfit, me qëllim të vetëm, që sa më mirë të organizojmë jetën fetare në çdo cep të vendit tonë, dhe që ibadetet t'i kryejmë në ambiente sa më të mira e të pastra" - shtoi Myftiu Tërnavë.

Ai po ashtu tha se ndjehet krenar me punën dhe angazhimin e anëtarëve të Kryesisë së BIK-ut, të cilët po japin një kontribut të jashtëzakonshëm në funksionimin e jetës fetare në vend dhe falënderojmë Zotin që sot BIK-u është Bashkësia Islame më stabile në rajon dhe kjo është një mirësi të cilën e kemi arritur me punë dhe angazhim. Ai më pas theksoi edhe projektet e shumta infrastrukturore, e sidomos vakëfeve që janë duke u ngritur gjithandej Kosovës. Në emër të



Kryesisë së BIK-ut, i shprehu falënderime të gjithë bashkëpunëtorëve, nëpunësve e drejtuesve të institucioneve për punën e tyre të palodhshme, duke i inkurajuar që edhe më tej të

vazhdojmë punën me zell dhe e me përkushtim.

Më pas kuvendarët diskutuan përkitazi me shqyrtimin dhe miratimin e raportit të punës së Kryesisë së BIK-ut për periudhën 1 janar – 31 dhjetor

2021, raportin e Komisionit Financiar të Kuvendit të BIK-ut, si dhe shqyrtimin dhe miratimin e Pasqyrës për të hyrat dhe të dalat e Kryesisë (llogaritë përfundimtare) për vitin 2021, si dhe pika të tjera të ndryshme.

Kryeimami Sahiti takoi mualimet e Departamentit të Gruas

Më 2 mars, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me koordinatorin e zyrës Dijanetit në Prishtinë, z. Bilal Coşkun, ka zhvilluar një takim pune me mualimet e Departamentit të Gruas së Bashkësisë Islame të Kosovës. Fillimisht, kryeimami Sahiti i përgëzoi mualimet për punën e deritanishme në xhamitë ku veprojnë, e më pas kërkoi nga to që edhe më tej ta vazhdojnë angazhimin e tyre për mbarëvajtjen sa më të mirë të mësim-besimit.

Ky takim, fokus kryesor kishte përgatitjet për muajin e bekuar Ramazan, për angazhimet dhe për



detyrat që do t'i kenë mualimet përgjatë këtij muaji mubarek. Projekti i angazhimit të mualimeve në kuadër

të Bashkësisë Islame të Kosovës, edhe këtë vit po mbështetet nga zyra e Dijanetit.

Shefi i zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadori Szunyok, vizitoi Xhaminë e Madhe në Prishtinë

Më 2 mars, shefi i zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadori Tomas Szunyok, vizitoi Xhaminë e Madhe në Prishtinë, në të cilën e priti kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti.



Kryeimami Sahiti e falënderoi për vizitën dhe e njohu ambasadorin Szunyok me historikun, vlerën dhe rëndësinë që ka xhamia “Sulltan Mehmet Fatih”, si një nga perlat e monumenteve për trashëgiminë tonë

kulturore e fetare, dhe theksoi përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në mbrojtjen e ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame në Kosovë. Nga ana e tij, shefi i zyrës së BE-së, ambasadori Tomas Szunyok,

falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen dhe theksoi përkrahjen që Zyra e BE-së po e ofron në mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kosovës.

Shoqata “Bereqeti” mbajti takimin e rregullt me koordinаторët e saj

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” ka mbajtur sot takimin e rregullt me koordinatorët e saj, për të diskutuar mbi përgatitjet për muajin Ramazan.

Drejtori i shoqatës “Bereqeti”, Behxhet ef. Ajvazi, fillimisht falënderoi të gjithë koordinatorët për punën dhe angazhimin e tyre, si dhe kërkoi nga ta që edhe më tej të kontribuojnë, në mënyrë që të jemi sa më afër familjeve nevojtare.

Ai e cilësoi vitin 2021 si vit tejet të suksesshëm në funksionimin e shoqatës, e si ndër suksesin më të madh e përmendi hapjen e dyqanit humanitar në Prizren dhe në Pejë. Drejtori Ajvazi përmendi edhe bashkëpunimin e shkëlqyer që kanë pasur me donatorët vendorë dhe nga jashtë vendi, të cilët i falënderoi për kontributin e tyre.

Gjatë këtij takimi, i pranishëm ishte edhe z. Bashkim Mehani, tajner në



fushën e organizimit, i cili foli për rëndësinë e punës së organizuar në fushën humanitare, dhe përparsitë që ka ajo ndaj punës humanitare, si veprimtari individuale.

Po ashtu u theksua nevoja për trajnime në këtë fushë, e cila do ta avanconte edhe më tej produktivitetin

e punës dhe do të siguronte vazhdimësinë e saj.

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” edhe këtë vit do të fillojë organizimin e aksionit tashmë tradicional “Sofra e Ramazanit”, i cili për qëllim ka ndihmën e familjeve nevojtare gjatë muajit Ramazan.

U mbajt tryeza shkencore “Sfidat bashkëkohore të periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës”

Më 10 mars, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, gjegjësisht nga Drejtoria për Kulturë dhe Veprimtari botuese, u mbajt tryeza shkencore “Sfidat bashkëkohore të periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës”.

Në këtë tryezë morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryeredaktorë, redaktorë, publicistë e kontribuues të ndryshëm në faqet e periodikut fetar islam. Të pranishmëve mirëseardhje iu dëshiroi drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, i cili foli për sfidat dhe etapat që ka kaluar shtypi fetar islam në Kosovë, duke veçuar se ne jemi dalluar, sepse kemi qenë shtyp me vlera konservatore dhe se ka nevojë që periodiku fetar të ri profilizohet dhe secila revistë të ketë



stilin e trajtimit të temave dhe mos të jenë të njëjta, duke bërë me dije se BIK-u është e vetmja në rajon që ka tre revista fetare më jetëgjata.

Më pas, një fjalë rasti mbajti Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij falënderoi të gjithë ata që dhanë

kontribut që periodiku fetar të arrij deri këtu ku është. Ai më pas potencoi vlerën dhe rëndësinë e fjalës së shkruar që nëpërmjet saj është përçarur mesazhi i fesë islame dhe vlerat islame deri te masa. Më pas, ai i inkurajoi të pranishmit që ta japin mundin e tyre

drejt objektivave të qarta dhe sukseseve që e presin periodikun e BIK-ut në kuadër të sfidave bashkëkohore me të cilat po ballafaqohet shtypi sot në botë, e që është në presion të jashtëzakonshëm të teknologjisë dhe digjitalizimit. “Ajet i parë kuranor është ombrellë dhe simbol identifikues i fesë sonë islame, sepse duhet të lexojmë, studiojmë, të ecim përpara duke na bërë me dije se injoranca është kundër asaj që na urdhëron Allahu. Ne duhet ta japim mundin tonë për ndërtimin e shoqërisë

në përgjithësi. Kurani i jep rëndësi të madhe shkrimit dhe leximit edhe shpërblimin atij që shkruan e lexon. Zoti në Kuran betohet në lapsin dhe ne duhet ta përdorim atë në të mirë të njerëzimit. Në Kosovë, dihet se para 50 vjetëve s’kemi pasur asnjë revistë dhe kemi filluar në vitet shtatëdhjeta me revistën “Takvimi”, “Edukata Islame”, pastaj “Dituria Islame” dhe filluan ulematë tanë të japin kontribut edhe në fjalën e shkruar që të edukohet brezi i ri” - tha Myftiu Tërnavë, duke

nënvizuar se sot kemi literaturë të bollshme të shkruar, por nuk është mjaft asnjëherë dhe duhet të vazhdohet tutje me punë dhe angazhim të mëtejshëm për të kultivuar mesazhin islamë në fjalën e shkruar në periodikët tanë. Më pas të pranishmit dhanë kontributin dhe mendimet e tyre në lidhje se si duhet dukur periodiku fetar i BIK-ut në kohën tonë bashkëkohore duke ofruar edhe mendime konkrete në këtë rrafsh. (R.S.)

Një delegacion i BIK-ut qëndroi në Arabinë Saudite

Më 15 mars, në Arabinë Saudite ka qëndruar një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht Komisioni për Redaktimin e Përkthimit të Kuranit në Gjuhën Shqipe prej haxhi Sherif ef. Ahmetit. Kjo vizitë e Komisionit të BIK-ut po ndodh në kuadër të Marrëveshjes për bashkëpunim, e nënshkruar prej ministrit të Vakfit dhe Çështjeve Islame të Arabisë Saudite, Abdullatif Al Sheikh dhe myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

Me këtë rast Delegacioni kosovar në përbërje të Sabri Bajgorës-kryetar, Vedat Sahitit, Besim Mehmetit, Bashkim Mehanit dhe Besnik Jahësanëtarë, ka vizituar Kompleksin dhe shtypshkronjën e Kuranit në Medine, ku është pritur prej drejtuesve të saj, sekretarit të Përgjithshëm të Kom-



pleksit të Mbretit Fehd për Botimin e Kuranit, Talal bin Razan Er Ruhejli, si dhe ka zhvilluar takime konsultative pune me dy grupe punuese në kuadër të institucionit: grupin shkencor për çështje fetare dhe grupin për përgatitje

teknike. Në secilin nga takimet u nxorën përfundime konkrete të bashkëpunimit, e të cilat do të reflektojnë në projekte konkrete e në dobi të besimtarëve myslimanë shqiptarë gjithandej nëpër botë.

Hytbeja e xhumasë iu kushtua rëndësisë së konsumit të prodhimeve vendore

Më 18 mars, me rekomandim të kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, në të gjitha xhamitë e Kosovës, në pjesën e dytë të hytbes u bë thirrje që t’i kushtohet rëndësi ngritjes së nivelit të vetëdijes së qytetarëve për cilësinë, blerjen dhe konsumimin e prodhimeve vendore. Nëpërmes kësaj hytbeje, qytetarët u njoftuan se kemi produkte të bollshme në shumë sektorë, si në atë të ujit, qumështit, lëngjeve, përpunimit të perimeve, si dhe ushqimeve të llojllojshme.



Po ashtu pjesë e kësaj hytbeje që të mos blejnë produkte serbe. ishte edhe vetëdijesimi i qytetarëve

“Bereqeti” dhe Qendra e Mbretit Salman filluan shpërndarjen e mbi dy mijë pakove ushqimore

Më 25 mars, Shoqata Humanitare Bamiërëse “Bereqeti” që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën e Mbretit Salman të Mbretërisë së Arabisë Saudite, kanë filluar shpërndarjen e mbi dy mijë pakove me produkte ushqimore. Në Prishtinë dhe Fushë Kosovë u dhuruan 500 pako me produkte ushqimore, e që do të vazhdojë edhe në të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës. Përfaqësues i Ambasadës së Mbretërisë së Arabisë Saudite, Hamad A.A. Alsayarry, tha se është mjaft i lumtur për realizimin e këtij projekti, pas iniciativës së Myftiut të Kosovës Naim ef. Tërnavë. “Dëshiroj fillimisht që t’ua uroj muajin Ramazan, meqenëse jemi në prag. Në emër të ambasadorit të Arabisë Saudite në Shqipëri dhe Kosovë, ju falënderoi për bashkëpunimin në këtë projekt. Kjo punë e mirë vjen nga bashkëpunimi me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Qendrës së Mbretit Selman me ndihma humanitare, andaj sigurisht se një falënderim i veçantë shkon për Myftiun Tërnavë i cili ka iniciuar këtë projekt.”



Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se aktivitetet bamiërëse do të shtohen edhe më shumë gjatë muajit Ramazan, duke theksuar se “Bereqeti” do të jetë pranë secilës familje nevojtare.

Beshir Sherari, përfaqësues i Qendrës Mbreti Selam, tha se synimi i tyre gjatë muajit Ramazan është që asnjë familje të mos shqetësohet për produktet ushqimore. “Me këtë projekt synojmë t’i ndihmojmë mbi 10 mijë persona në gjithë Kosovën, duke synuar që t’i shpërndajmë mbi 2000 pako në gjithë territorin e Kosovës, së bashku me Bashkësinë

Islame. Synimi jonë është që me anë të këtyre pakove secila familje t’i ketë produktet elementare ushqimore përgjatë muajit të Ramazanit.”

E krejt në fund, drejtoresha për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës, Adelinë Sahiti, tha se ndihmat e tilla janë domethënëse për këto familje, në veçanti në këtë periudhë ku janë shtrenjtuar çmimet. Ky aksion do të shtrihet në 10 qytetet më të mëdha të Kosovës, ndërsa Bereqeti do të jetë pranë nevojtarëve gjatë muajit Ramazan, duke ndihmuar edhe me mbi 35 mijë pako ushqimore.

Përurohet xhamia e re në fshatin Miresh të Gjilanit

Më 25 mars, në prag të muajit të bekuar Ramazan, komunës së Gjilanit iu shtua edhe një xhami e re. Falë bamiërëve vullnetarë të fshatit dhe mërgimtarëve nga diaspora, sot, nën këndimin e tekbiereve dhe salavateve, në mënyrë solemne u hap xhamia e re në fshatin Miresh të Gjilanit. Ashtu siç e do rendi, kjo ceremoni filloi me leximin e ajeteve kuranore, të cilat i lexoi imami i kësaj xhamie Selim ef. Selimi. Më pas, një fjalë rasti mbajti edhe kryeimami i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjilanit, Iljaz ef. Mustafa, i cili foli rreth vlerës dhe rëndësisë që ka ndërtimi i xhamive në fenë islame. Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në emrin e Myftiut Tërnavë, të pranishmit i përshëndeti drejtori i Diasporës,



Ekrem ef. Simnica, i cili përcolli urimet e Myftiut Tërnavë për hapjen e kësaj xhamie. Ai në fjalën e tij, një theks të veçantë i kushtoi falënderimit të mërgimtarëve tanë, të cilët si çdoherë, edhe për këtë xhami kanë dhënë një

kontribut jashtëzakonisht të madh, duke ndihmuar për ndërtimin e xhamive sa herë që është kërkuar. Drejtori Simnica porositi banorët që këtë xhami mos ta shfrytëzojnë vetëm për falje të namazit, por që në këtë

xhami të jetësohet edhe një amanet që e kemi për brezat e rinj, atë të mësim-besimit. Ai në fund uroi edhe për fillimin e muajit Ramazan, duke iu dëshiruar që të kenë agjërim të pranuar dhe që edhe njëherë ta gëzojnë këtë muaj dhe këtë xhami. Kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, përmendi një fakt të rëndësishëm sa u përket ndërtimit të xhamive. Ai tha se nga tetëmbëdhjetë xhami sa

kishte Gjilani para luftës, kjo xhami të cilën po e përurojmë sot është e dyzetepesta. Andaj me këtë rast, unë nga ky vend shpreh falënderimet më të sinqerta për të gjithë banorët e Mireshit për këtë kontribut, duke lutur Zotin që t'ua pranojë në peshojën e veprave të tyre të mira. Në emër të banorëve të fshatit, një fjalë rasti e mbajti Selami Huruglica, i cili foli rreth aksionit dhe nismës për ndërtimin e kësaj xhamie.

Ai falënderoi me rend të gjithë ata që në çfarëdo forme kanë kontribuar që sot ne të falemi në këtë xhami. Hytben e parë në këtë xhami e mbajti sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, i cili përgëzoi dhe uroi banorët për këtë xhami. Ligjëratat e tij kryesisht u fokusua në vlerën dhe rëndësinë e ndërtimit të xhamive.

Bashkësia Islame dhe Dijaneti i Turqisë filluan shpërndarjen e dy mijë pakove ushqimore

Më 27 mars, Bashkësia Islame dhe Dijaneti i Turqisë filluan shpërndarjen e dy mijë pakove ushqimore. U shpërndanë 100 pako të tilla në Prishtinë për rastet sociale, për të vazhduar më pas edhe në komuna të tjera të Kosovës. Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, falënderoi Dijanetin e Turqisë për këtë bashkëpunim që edhe këtë vit, po ndihmojnë rastet sociale në prag të muajit Ramazan.

“Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, falënderoj Dijanetin e Turqisë, në këtë rast Ditubin nga Gjermania e cila edhe këtë vit, sikurse vitin e kaluar po ndihmon familjet në nevojë me pako ushqimore”, tha kryeimami Sahiti.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ambasadori i Turqisë në Prishtinë, Çağrı Sakar, i cili mes tjerash theksoi



bashkëpunimin e shkëlqyer mes Dijanetit dhe Bashkësisë Islame të Kosovës edhe në fushën humanitare.

“Falënderojmë Dijanetin e Turqisë dhe fondacionin e Dijanetit – Ditubin, që edhe këtë vit para fillimit të Ramazanit në bashkëpunim me Bashkësinë

Islame po i dalim në ndihmë qytetarëve të Kosovës dhe sot i dhuroam këto pako ushqimore familjeve në nevojë. Me këtë rast ua uroj muajin e bekuar Ramazan të gjithë kosovarëve”, përfundoi ambasadori i Turqisë në Prishtinë.

U përruaa renovimi i xhamisë së fshatit Softaj të Ferizajt

Më 28 mars, në mënyrë solemne, nën këndimin e tekbireve dhe ajeteve kuranore me praninë e përfaqësuesve nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësuesve të Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, përfaqësuesve të qeverisjes lokale, përfaqësuesve të këshillave të Bashkësisë Islame të qyteteve të tjera të Kosovës, imamëve, e shumë besimtarëve, u bë përrurimi i renovimit të xhamisë së fshatit Softaj në Ferizaj. Në emër të Myftiut të Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe në emër të BIK-ut, këtë tubim e përshëndeti kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili përcolli mesazhet e Myftiut Tërnavë për



banorët në lidhje me këtë përrurim. “Është kënaqësi që këtë gëzim ta

ndajmë së bashku me të gjithë ju, andaj uroj të gjithë ata që kanë

kontribuuar për renovimin e kësaj shtëpie të Zotit. Lus Zotin që atyre t'u japë shëndet e bereqet në punën e tyre. Ftoj që edhe xhamatët e tjera ta ndjekin këtë model të kësaj xhamie, që t'i avancojmë shërbimet dhe që të kemi vende më komode për kryerjen e faljeve, sepse xhamitë janë vetëm për Zotin dhe në to madhërohet vetëm Zoti. Më lejoni të përshëndes edhe imamin Ilir ef. Maliqin dhe të gjithë ata që kontribuuan që kjo xhami të duket sot kaq e bukur" – tha ndër tjera kryeimami Sahiti. Këtë manifestim e

përshëndeti edhe kryetari i Kuvendit të Ferizajt, Xhavit Zariqi, i cili uroi komunitetin për këtë xhami kaq të bukur dhe uroi që të gjithë kontributdhënësit në renovimin e kësaj xhamie. Kryetari i KBI-së së Ferizajt, Fehmi ef. Mehmeti, tha se kujdesi ndaj xhamive është ndër veprat shumë të mira dhe të dashura të Zoti xh.sh dhe ai që ndërton një xhami, Allahu atij do t'ia ndërtojë një shtëpi në xhenet, ashtu siç thotë edhe Muhamedi a.s.. Ai apeloj të xhamatit që të jenë aktivë edhe në shërbim të objekteve të tjera, që do

të mundësoj që jeta fetare të avancohet dhe të kemi kushte sa më komode në kryerjen e ibadeteve. Edhe imami i kësaj xhamie, Ilir ef. Maliqi, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë përrurim, si dhe luti Zotin që t'i shpërblejë të gjithë ata që kanë ndihmuar që kjo xhami të duket kështu. Në fund u ndanë disa mirënjohje për bamirësit dhe donatorët që kanë përkrahur këtë projekt. Më pas u lexuan disa ilahi nga hfz. Besir Musliu dhe Avdush ef. Kroza. (R.S.)

Drejtori Siminca priti në takim kryetarin e xhamisë "Sunnah" në Zvicër, z. Qamil Xhelilin

Më 28 mars, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Siminca, priti në takim kryetarin e xhamisë "Sunnah", në Zvicër, z. Qamil Xhelilin. Drejtori Siminca falënderoi z. Xhelilin dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishtërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Ndërkaq, z. Xhelili e



falënderoi drejtorin Siminca për pritjen dhe për gatishtërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të kenë një bashkëpunim

të mirëfilltë me qendrat shqiptare në diasporë. Ai po ashtu e njohu drejtorin Siminca për blerjen e qendrës për xhami në Cyrih të Zvicrës.

Kryeimami Sahiti takoi imamët e komunitetit boshnjak

Më 30 mars, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka takuar të mërkurën imamët e komunitetit boshnjak të rajonit të Gorës dhe të Prizrenit. Në këtë takim, i cili u mbajt në ambientet e paraleles së Medresesë "Alauddin" në Prizren, u diskutua për përgatitjet për muajin e bekuar Ramazan. Kryeimami Sahiti fillimisht uroi imamët për ardhjen e muajit Ramazan, duke porositur ata që të jenë sa më pranë xhamatit, gjatë këtij muaji të bekuar.



U mbajt dua ja e hatmes në fshatin Bresanë të Dragashit



Më 25 mars, në xhaminë "Myderriz Rexhep Ismaili" në Bresanë të Dragashit, në ditën e xhuma, 23 nxënës përfunduan me sukses leximin e Kuranit – hatmen, për të cilën u organizua edhe një program, me rastin e përfundimit të saj. Në këtë program morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, hoxhallarë dhe shumë të ftuar të tjerë.

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, uroi dhe

përgëzoi 23 nxënësit për sukseset e arritura, duke ua kujtuar kështu vlerën dhe rëndësinë e madhe që ka leximi i Kuranit. Ai përgëzoi edhe hoxhallarët, të cilët pareshtur punojnë për mësimin e brezave të rinj, duke ua kujtuar kështu edhe atyre që një gjë të tillë e kemi amanet karshi tyre.

Pjesë e këtij organizimi ishte edhe kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, i cili foli më tepër rreth bashkëpunimit të shkëlqyer që kanë me Këshillin e Bashkësisë Islame të Dragashit.

Imami i xhamisë, njëherësh edhe mësuesi i këtyre nxënësve, Kasam ef. Muhameti, tha se ndjehet tejet i lumtur që sot këta nxënës kanë arritur përfundimin e leximit të fjalës së Zotit, duke lutur Zotin që t'u japë shëndet e mbarësi dhe suksese në jetë. Ai foli edhe për sfidat që kanë kaluar përgjatë mësimin në kohë pandemie.

Në fund, për sukseset e arritura, nxënësit u pajisen me certifikata.

Në këtë xhami, Myftiu Tërnavë, mbajti edhe hytben e xhumasë, nga ku përçoi këshillat dhe mesazhet e rëndësishme dhe të vlefshme për ardhjen e muajit Ramazan.

Doktoroi Bejtullah Gashi

Më 25 janar, kandidati Bejtullah Ismajl Gashi, në "Universiteti Botëror të Shkencave Islame" në Aman të Jordanisë, mbrojti me sukses temën e doktoratës "Ligji i familjes dhe zakonet që ndërlidhet me të në shtetin e Kosovës në ekuilibrin e jurisprudencës islame studim (analitik) praktik", në lëmin e fikhut dhe usuli fikhut, para komisionit në përbërje nga prof. dr. Muhamed Halef Muhamed beni Selam, kryetar i komisionit, prof. dr. Musa Mustafa Musa Elkudah (mentor), dr. Enes Abdulvahid Salih Elxhabir, anëtar, dhe prof. dr. Ahmed Shahde Ali Ebu Serhanë, anëtar i jashtëm.

Tema shtjellon dhe jep një kontribut të madh dhe të mirëfilltë pasi që bën një komperacion të thuktë, në mes ligjit dhe legjislacionit islam, duke e



venduar atë në peshojën e jurisprudencës islame.

Bejtullahu lindi në Prishtinë, shkollën fillore e kreu në vendlindje në Mramor, për të vazhduar në medresenë e mesme "Alaudin" në Prishtinë, ku dhe mbaroi me sukses të shkëlqyeshëm. Ka përfunduar studimet në

"Universitetin islamik" të Medinës, në "Fakultetin e Sheriatit" dega Fikh dhe Usuli fikh. Ka përfunduar magistraturën në Universitetin "Hasan Prishtina" në Prishtinë, Fakulteti Juridik. Kandidati i dëshirojmë suksese të mëtejme në rrugën e dijes dhe shëndet në jetë.

Kaloi në Ahiret imami Mendim ef. Bahtijari

“Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Më 20 mars, pas një sëmundje të rënd ka ndërruar jetë imami i xhamisë së fshatit Bellobrad, Mendim ef. Bahtijari.

Biografi e shkurtër

Mendim ef. Bahtijari lindi më 1 shkurt 1969 në fshatin Bellobrad të Dragashit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen e përfundoi në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, të cilën e përfundoi në vitin

1989. Që nga 1 prilli 1993, filloi detyrën si imam, hatib dhe mualim në xhaminë e fshatit Bellobrad, detyrë të cilën e ushtroi me përgjegjësi dhe korrektësi të lartë. Mendim ef. vdiq më 20 mars 2022, pas një sëmundje të rëndë. Ai u varros në varrezat e fshatit Bellobrad, në kohën e namazit të ikindisë, të dielën më 20 mars 2022. Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!



Kaloi në Ahiret imami Adem ef. Ademi

“Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Më 21 mars 2022, pas një sëmundje të shkurtër ka ndërruar jetë imami i xhamisë së fshatit Jabllanicë, Adem ef. Ademi.

Biografi e shkurtër

Adem ef. Ademi lindi më 09.05. 1966 në fshatin Bradash të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen e përfundoi në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë,

në vitin 1985. Për një periudhë shtatë vjeçare shërbeu si imam pranë Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë, para luftës shërbeu në xhaminë e fshatit Skivjan, kurse nga viti 2017 shërbeu si imam në xhaminë e fshatit Jabllanicë. Varrimi i rahmetliut u bë më 21 mars 2022, e hënë, në varrezat e fshatit Bradash, komuna Podujevë, në orën 16:00. Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!



Prof. dr Fikret Karçiq (1955-2022)

Fikret Karčić, profesor në Fakultetin Juridik në Sarajevë dhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, ka vdekur në moshën 66-vjeçare.

Ka lindur në Vishegrad në vitin 1955. Arsimin e mesëm e kreu në Medresenë e Gazi Husrev-beut në Sarajevë. Në vitin 1978 u diplomua në Fakultetin Juridik në Sarajevë. Shkollën e magjistratit dhe doktorit të shkencave e fitoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit në vitin 1985, përkatësisht në vitin 1989.

Ishte profesor i historisë krahasuese juridike në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës. Ka ligjruar në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, në Universitetin Marmara në Stamboll, në Universitetin Islamik Ndërkombëtar të Malajzisë, në Universitetin e Oslos dhe në Universitetin Shtetëror Boise (SHBA).

Disa institucione të larta qeveritare në Evropë kanë kërkuar ndihmën shkencore të prof. dr. Fikret Karçiq në

aspektin e qasjeve moderne në studimin e të Drejtës së shariatit.

Fakulteti i Teologjisë Islame, gjegjësisht Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë do t'i mbetet në borxh të përhershëm prof. dr. Fikret Karçiqit për themelet moderne të studimeve fetaro-juridike. Interesi i tij kryesor akademik ishte historia e të drejtës së shariatit dhe institucioneve islame në Bosnje dhe Hercegovinë në periudhën post-osmane, lëvizjet reformiste në Islam, myslimanët e Ballkanit dhe kulturat juridike krahasuese.

Karçiq ka qenë kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Bashkësisë Islame në Bosnje e Hercegovinë për dy mandate. Ishte redaktor i Glasnik-ut dhe kolumnist shumëvjeçar për GII Preporod.

Në vitin 2018, së bashku me akademikun Enes Kariq ishte fituesi i çmimit prestigjioz për veprën e jetës, që ndahet nga Shoqata e Shkencëtarëve Shoqëror Myslimanë (MB).



Prof. dr. Fikret Karçiq është i njohur edhe për lexuesit shqipfolës përmes librit të tij të përkthyer në gjuhën shqipe “Historia e së drejtës së shariatit” të botuar në Prizren në vitin 1994, “Studime për të drejtën dhe institucionet botuar në Shkup Prishtinë Tiranë 2015 dhe punime tjera të tij të përkthyer në gjuhën shqipe. (Azmir Jusufi)

HADITHE PËR AGJËRIMIN

"Islami ndërtohet mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është rob dhe i Dërguari i Tij; falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në haxh."

"Kur të hyjë muaji Ramazan, hapen dyert e Xhenetit, mbyllet dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët."

"Agjëruesi ka dy gëzime: gëzohet kur ta çelë iftarin e tij dhe gëzohet kur ta takojë Zotin e tij."

"Me të vërtetë në Xhenet ekziston një derë që quhet Rejjan. Në të do të hyjnë vetëm agjëruesit dhe askush tjetër."

"Agjërimi është mburojë, andaj kush agjëron, le të mos flasë fjalë të ndyta. E nëse dikush e ofendon, le t'i thotë: "Unë jam agjërueshëm."

"Kush falet gjatë Ramazanit (namazin e teravive) me besim dhe shpresë, do t'i falen mëkatet e mëparshme."

"Sadakaja më e mirë është ajo që jepet në Ramazan."

"Kërkojeni Natën e Kadrit në netët teke të dhjetëshit të fundit të Ramazanit."

"Për çdo natë të Ramazanit, Allahu liron robër të tij nga zjarri i Xhehenemit."





"Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë,
e Ai t'ia shtojë atij shumëfish atë?"

(El Bekare, 245)

Pejgamberi, a.s., e bëri obligim
ZEKAT (SADAKATUL) FITRIN

si pastrim për agjëruesin për fjalët e këqija, dhe ushqim
për të varfrit. Prandaj, kush e jep para namazit (të Bajramit),
ajo është sadaka e pranuar, e kush e jep pas namazit, konsiderohet
sadaka e rëndomtë! (Muhamedi a.s.)

Bashkësia Islame
e Republikës së Kosovës

ZEKATI DHE SADAKATUL FITRI 2022

PAGESAT MUND T'I BËNI

1. Në zyrat e këshillave të BIK-ut
2. Në secilën xhami të Kosovës
3. Në adresën bankare:

Bashkësia Islame e Kosovës
NLB-Prishtina

Account no. & IBAN:

XK05 1700200100103672

SWIFT Code (BIC): NILPRXKPR



VLERAT NË TË CILAT MUND T'I BËNI PAGESAT

